

ME PARTINE NË KRYE, ME BESIM TË PATUNDUR NË FORCAT TONA, NE DO TË ECIM GJITHMONE PËRPARA

Letra e KQ të PPSH dhe e Qeverisë së RPSSH drejtuar KQ të PK të Kinës dhe Qeverisë kinezë, lidhur me vendimin e marrë nga ana e tyre për të ndërprerë ndihmën ekonomike dhe ushtarakë për Shqipërinë dhe për të tjerhequr specialistët e tyre ekonomikë dhe ushtarakë nga vendi ynjë, përbën një dokument historik me vlerë të madhe teorike e praktike, që i shtohet fondit të pasur të përvjoes së lëvizjes komuniste botërore.

Këtë letër, fund e krye si një fill i kuq, e përshkojnë idetë e pavdekshme marksiste-leniniste, fryma e internacionizmit proletar, guximi dhe parimia revolucionare, që kanë karakterizuar kurdoherë Partinë dhe Shkretëri tonë socialist në tërë veprimtarinë dhe qëndrimet konkrete ndaj çfarëdo problemi dhei ndaj kujdo qofte.

Në këtë dokument edhe një herë gjen shprehjen më të kristalizuar qëndrimi i patundur dhe konsekuent i Partisë dhe i popullit tonë ne pozitat e marksizëm-leninizmit, në të spikat vendosmëria e tyre e pa-përkultur për të mos u zëmpirasur përballë presioneve e kërcënimeve, por për të marshuar ballëlart e sypatrembur në rrugën e ndritur të socializmit e të komunizmit.

Dëshmia mië e qartë e unititetit monolit të popullit me Partinë dhe e bindjës së thelle që ai ka në drejtësinë e vijës së saj është mbështetja me tërë forcën që kjo letër gjeti në masat e gjëra punonjëse të qytetit dhe të fshatit. Dhe prova mië bindjëse e këtij miratimi unanim janë jo vetëm letrat e pamuajta, që me këtë rast iu janë dërguar Komitetit Qëndror të Partisë sone të dha Qeverisë nga ana e të gjithë kolektivave punonjëse, me të cilat ata shprehin njëzëri indinjatën e tyre të thelle për këtë akt të pakësë dhe kaq armiqësor të udhëheqjes kinezë ndaj popullit tonë, por është edhe atmosfera e paparë revolucionare, që ukrijua në të katër anët e vendit tonë pas botimit të letrës, është vrulli, që me një forcë të re, shpërtheu në çdo front pune dhe që përfshin të madh e të vogël në Republikën tonë.

Në përgjigje të këtij veprimi të hapët antimarksist dhe armiqësor të revisionisteve kinezë kundrejt Partisë dhe popullit tonë dhe si shprejtë e një zotimi solemn e betumi luftarak para Partisë dhe shokut Enver Hoxha, nga të gjitha kolektivat punonjëse të mbarë vendit po merrin zoturne dhei iniciativë për të vënë në jetë një për një vendimet e Kongresit të 7-të të Partisë sone, për të plotësuar dhei për ti shpenë më përparrë detyrat e plantit të shtetit në të gjithë sektorët e prodhimit dhe në të gjitha fushat e aktivitetit shtetëror e shoqëror të vendit.

Këtë përgjigje e kanë marrë kurdoherë armiqët e Partisë dhei të pulnit tone sa herë që ata kanë guxuar të ngrenë dorën kundër nesë dhei kanë dashur të na gjunjëzojnë para forcës dhe diktatit të tyre.

Veprimi i ulët i revizionistëve kinezë, i bërë nga pozitat e shtetit të madh si në përbaitje ashtu dhe në formë, na kujton metodat e egra dhre shoviniste, që disa vjet më parë patën përdorur kundër nesh titistët e hruškovianët për të larguar Partinë tonë nga rruga e saj marksiște-jeniste, për të sabotuar geshtjen e revolucionit e të ndërtimit socialist në Shqipëri dhe për të rivendosur, në këtë mënyrë, rendin borgjez.

Në mënyrë të vecantë indinjuese janë orvajtjet e udhëheqjes kinezë për të krijuar përshtypjen në opintonin publik të brendshëm e ndërkombëtar se gjaja sukseset e arritura, në zhvillimin ekonomik, Shqipëria është detyron ndihmës që ka pasur nga Kina, Propaganda kinezë, mbi bazën e llogaritjeve arbitare, të njëjshme e të shtrembejura, arrin deri atje sa ta quaje «ndihma» për Shqipërinë edhe ato mallra që ajo i ka importuar nga Kina në rrugë tregëtare e në bazë pagesash me klering.

Nga ana tjeter, udhëheqja kinezë, me paturpësinë që karakterizon revizionistët, le në heshtje të plotë faktin se edhe Shqipëria e ka ndihmuar Kinën. Gjithashtu «ajo nuk ze në gojë fare dëmet që i ka siellë ekonomisë sone duke zvarriuar e shtyrë për disa vjete aftet e ndërtimit, jé shumë objekteve të rendësishme si edhe dëmet e shkaktuara me rrugë të tjera.

Dikur Hrushovëi nuk pati lënë gjë pa kurdisur e pa përdorur përfshira në nenshtruar dhe për të na lidhur pas karvanit të tij revizionist. Ai e filloj me manovrat më djallëzore e puçiste dhe arriti deri tek presionet me brutale dhe kercënimet e hapura.

Fjala që mbajti shoku Enver në mbledhjen e Moskës në nëntor 1960 ja corri maskën Hrushovit dhe pasuesve të tij dhe nxorri sheshit para hoxes fytyrën e tyre të vërteti prej renegatësh të zhytur kokë e këmbë ne batlakun revizionist.

Partia jone, e ndriguar si gjithnjë nga idetë drithëdhënëse të marksim-ljeninizmit, e nga mësimet e shokut Enver Hoxha, nuk u frikësua nga kercënimet e shanazhet, por me qartësi largpamëse, me guxim e vendosmëri revolucionare, me besim, në shpirtin luftarak e vitalitetin e pashtershëm të popullit, vazhdoi pa asnjë ngurrim, dhe pa asnjë lë-kundje rrugën e saj të lavdishme dhe duke kapërcyer çdo pengesë e duke imposhtur çdo blokadë, udhëhoqi popullin nga fitore.

Nuk ka asnjë dyshim se fatin e hruškovianëve do ta kenë edhe revizionistët kinezë, autorët e teorisë së «tri botëve», që përbën thelbine oportunitzmit kinez.

Duke propaganduar me bujë këtë teori famëkeqe kundërrevolucionare e reakkcionare del e qartë se udhëheqja kinezë synon të vendosë hegemoninë e Kinës mbi të ashtuquajturën «botë të tretë» dhe të kthehet kështu në një superfuqi.

Dëshira e hegemonisë dhe e ekspansionit që ka molepsur udhëheqjen kinezë e goi atë deri aty sa të bashkohet me imperializmin amerikani dhe me monopolistët e Evropës, me fashistët e me racistët, me mbretërit e me feudalistët, me militaristët e me luftënxitësit më të çfrëngj, me revizionistët e të gjithë ngjyrave.

E gjithë strategjia dhe vija politike e udhëheqjes së Partisë komuniste të Kinës dhe qeverisë kinezë janë çreshkur fare nga parimet e marksim-ljeninizmit. Në tërë politikën e saj, udhëheqja kinezë udhëheqjet nga pozita e shtetit të madh, nga interesat konjunkturale, nga qytetare pragmatiste dhe interesa egoiste.

Duke nxjarrë në shesh rrënjët ideologjike, politike, ekonomiko-shoferore të teorisë së «tri botëve», duke çvreshur qëllimin dhe rrezikshmë-inë e kesaj teorie si dne duke zbuluar fitjet që e lidhi këtë teori me evizionizmin modern dne me kapitalizmin botëror, shoku Enver Hoxha buloi dne demaskoi botërisht edhe rrëzikun e revizionistit kinez.

Partia dne populli yne nuk janë zënë kurri në befasi. Duke qënë brumosur me ideologjinë marksiste-leniniste, Partia ka zbuluar qysh ië filim tradhëtinë e udhëheqjes kineze dne është përgatitur për beteja e ashpjra klasore.

Partia jonë nuk do të lejojë që të merren nëpër këmbë dini jiteti lhe të drejtat tona legjitime. Nuk do të lejojë asnjëherë që të bëhet trejeti me parimet e marksizëm-leninizmit, sepse këto parime përbëjnë hesarin më të shtrenjtë për ne, ashtu sikurse edhe për të gjithë revolucionarët dne marksistët leninistë e vërtetë në të gjithë botën.

Mbi këto parime është ndërtuar dne lulëzon qdo ditë e më shumë etë janë e re, është ngritur vepra madhështore e socializmit, themellet, së cilës janë mbrojtur me kag gjak e djersë.

Me këto parime lidhet ngushtë e sotmia dne e nesërmja e popullit tonë. Nuk ka dysnim se sukseset madhështore që kemi arritur në është gjitha fushat mbajnë vulën e punës dne të luftës vetëmohuuese e rëmbëngulëse të popullit tonë punëtor nën udhëheqjen e Partisë me hokur Enver Hoxha në krye, e cila i është përbabaitur kurdoherë paimit revolucionar marksist-leninist të mbështetjes në forcat e veta.

Këtij parimi, Partia dne populli yne do të vazhdojnë të përbahen ne besnikëri dne vendosmëri edhe në të ardhmen.

Eshtë pikërisht për këtë arsy që një vend i vogël, i rrethuar nga imperializmi e revizionizmi, siç është Shqipëria janë socialistë, u ka jëre balle si shkëmb graniti të gjitha fortunave e rrebeshevë që janë përplasur mbi të dne qëndron kurdoherë si kala e pamposhtur e socialistizmit dne e revolucionit, tribunë nga ku mësojnë dne frymëzohen forcat revolucionare dne popujt e bofës në luftën e tyre kundër imperializmit, reakzionit dne revizionizmit të çdo ngjyre.

Eshtë pikërisht rër këtë arsy që respekti dne prestigji i Shqipërisë socialistë sa vjen e po rritet kaq shumë në arenë botërore.

Numri i mique dne dashamirësve të singertë të vendit tonë në botë zo shtohet dita ditës. Për këtë dëshmojnje qartë letrat e shumta që kanë ardhur Partisë dhe Qeverisë sonë nga marksistë-leninistë dne jyerë përparimtarë, të cilët dënojnë rëndë qëndrimin armiqësor të dhëheqjes revizioniste kineze dne shprehin ndjenjat e respektit dne jashurisë për Partinë e popullin tonë; ata mbështesin me gjithë zemër jendrimin tonë në luftën parimore për mbrojtjen e të drejtave dne lirisë së popujve, për mbrojtjen e socializmit dne të marksizëm-leninizmit.

Por ashtu si na mësojnë Partia dne shoku Enver Hoxha, sukseset e arritura në vend që të na krijojnë vetëkënaqësi, duhet të na shërbë se si një stimul i fuqishëm për të shtuar përpjekjet tona dne për ta bëre ende më këmbëngulëse luftën tonë në drejtim të zbatimit sa më të plotë të vendimeve të Kongresit të 7-të të Partisë, të detyrave që shtrojnë para nesh vendimet e plenumeve të fundit të KQ të PPSH dne fjallimet shumë të rendësishme të shokut Enver Hoxha.

Partia na porosit që çdo komunist, kuadër e punonjës të jetojë aktivisht me situat e krijuara, t'i kuptoje thellësishët ato, gjendjen e rrëthimit dhe vështirësitet që na krijon ai dhe, me ndjenjën e lartë të përgjegjësisë për perballimin e kapërcimin e tyre, të mendojë, të punojë, të jetojë e të luftojë me të vërtetë si në rrëthim. Kjo porosi e përfunduar si gjithnjë nga direktivat e Partisë e të shkurt Partisë është ende më kuptumplotë sot kur vendit tonë iu shtua edhe një armik tjetër: revizionizmi kinez.

Edhe ne, kolektivi punonjës e studentë të Fakultetit të mjekësisë, të fyrmenzuar nga hovi i ri revolucionar që ka njallur Jehona e letresë se KQ të Partisë dhe Qeverisë drejtuar udhëheqjes kinez dhe, duke u ndriçuar si gjithnjë nga direktivat e Partisë e të shkurt Enver, nxorrëm një varg detyrash të rëndësishme që shtor: para nesh stadi i sotshëm i zhvillimit të revolucionit tonë socialist.

Në fushën e edukimit ideopolitik të intensifikojmë pa rrështrur luftëren për brumosjen tonë të vazhdueshme me ideologjinë e Partisë sonë, me tiparet e moralit proletar. Për këtë qëllim, në radhë të parë, duhet të përvetësojmë sa më mirë materialet e Partisë dhe veprat e shokut Enver Hoxha. Në planet dhe programet mësimore si dhe në leksionet tona të pasqyrohen sa më mirë sukseset e mjekësisë sonë dhe përvoja e grumbulluar në fushat e ndryshme të saj.

Në fushën e mësim-dhënes të luftojmë më shumë për harmonizimin sa më organik të tre përbërësve të shkollës sonë, duke vënë kurdonjerë në qender të trekëndshit revolucionar boshtin ideologjik marksist-leminist të Partisë sonë, tendeciozitetin klasor revolucionar, duke iu bërë një luftë të ashpër dhe parimore të gjitha teorive reaksionare, metafizike, idealiste, borgjezo-revizioniste.

Duke e konsideruar fushën e stërvitjes si fushë luftë, do të shtojmë përpjekjet për tu përgatitur sa më mirë ushtarakisht dhe për tu kalitur fizikisht që të bëhem i të zotët në kryerjen si duhet të çdo detyre lufta-rike që do të na besohet.

Do të luftojmë sistematikisht për të rrënjosur sa më thellë në masën e studentëve, pedagogëve dhe punonjësve fyrmen e disciplinës profesionale rreptarë dëshmorë e gjithanshme të fakultetit tonë. Do të luftojmë përfunduar gjithnjë nivelin ideoshkencor të mësim-dhënes dhe për të përsosur më tej mijetet audi vizive. Do të shtrijmë dhe do të përsosim leksionet e shkruara, duke ngritur nivelin e tyre ideopolitik dhe tekniko-shkencor. Do të ripunojmë tekstet mësimore duke i pasuruar më mirë -shkencor. Do të vendit tonë në bazë të programeve mësimore të rishikuar në fyrmen e porosive dhe vendimeve të Kongresit të 7-të të PPSH.

Duke e kuptuar mirë përbajtjen e gjithanshme të revolucioni tekniko-shkencor dhe duke e konsideruar fakultetin jo vetëm si shko llë për përgatitjen e mjekëve të rinj, por edhe si një qender e rëndësishme e mendimit dhe e kërkimit shkencor në lëmin e mjekësisë dhu si bazë e kualifikimit pasuniversitar të kuadrove mjekësore, na del së detyrë e dorës së parë që të nxism dhe të thellojmë punën kërkimore shkencore si në drejtim të eksperimentit, ashtu dhe në atë të vëzhgimeve e studimeve klinike në bazë të tematikave dhe metodikave të hartuar nga katedrat.

Tematika studimore duhet t'u përgjigjet kërkueseve të shërbimi me njekësor në vendin tonë dhe t'i shërbëjë kështu drejtëspërsërejtë zgjju

Ishjet së problemeve më shqetësuese të mjekësisë sonë në drejtim të lepjistikimit, diagnostikimit, mjekimit dhe parandalimit të sëmundjeve të ndryshme.

Brenja viti 1980 do të likuidohen provimet pasuniversitare të kualifikimit nga i gjithë kuadri pedagog.

Në periudhën 1978-1982 do të mbrohen 40 tema për shkallën e parë të kualifikimit. Gjatë kësaj kohe dhe në planet e punës së perspektivës kanë dale iniciativa të guximshme në drejtim të rritjes së nivelit të shërbimit shëndetësor ndaj masave punonjëse të qytetit dhe të fshatit. Metoda të reja ekzaminimi dhe mjekimi janë kryer dhe do të kryhen me forcat e veta dhe duke praktikuar kooperimin ndërmjet katedrave. Gjithashtu do të rritet bashkëpunimi i fakultetit me institucionet shëndetësore të kryeqyjetit dhe të rrtheve si në drejtim të bashkërendimit sa më të mirë të planeve dhe tematikave studimore, ashtu dhe në drejtim të shfrytëzimit sa më racional të bazës materialo-teknike ekzistuese dhe të përgatitjes së kuadrit të ri.

Instituti i Higjenës dhe i Epidemiologjisë, ai i mjekësisë popullore, Q S E, I K M U dhe laboratorët e qendrat kërkimore përbëjnë baza shumë të pasura për zhvillimin me sukses të veprimitarise kërkimore-shkencore per të gjithë mjekët e vendit tonë.

Laboratori eksperimental i fakultetit po zgjerohet dhe do të shfrytëzohet për studimet e planifikuara nga shumë katedra të disiplinave teoriko-eksperimentale dhe klinike në fushën e mjekësisë profilaktike e kurative.

Do të ritim më tepër numrin e artikujve dhe botimin e studimeve shkencore për problemet e ditës të mjekësisë sësonë.

Do të shtojmë numrin e sioneve dhe referimeve shkencore me karakter ideologjik e profesional në shkallë katedre, dege e fakulteti. Pranë çdo katedre do të aktivizohen më mirë rrethet shkencore të studentëve, duke u përfaqësuar në sionet shkencore me tema eksperimentale dhe kliniko-statistikore.

Kolektivi i punonjësve dhe studentëve të fakultetit të mjekësisë, të bashkuar si një trup i vetëm rrëth Partisë sonë të dashur me shokun Enver Hoxha në krye, do të luftojë me të gjitha forcat dhe energjitet që edhe në fushën e shëndetësisë sone socialistë të bëhen hi e pluhur planet djallëzore të imperialistëve, socialimperialistëve dhe revizioni-stëve kinezë.

Summary

UNDER THE LEADERSHIP OF THE PARTY AND WITH UNSHAKEN CONFIDENCE IN OUR FORCES, WE SHALL ALWAYS MARCH FORWARD

The employees and the students of the faculty of medicine of the Tirana University approved unanimously the letter addressed by the Central Committee of the Albanian Party of Labour and the Albanian Government to the Central committee of the Chinese Communist Party and the Chinese Government. They stand united as a single body around the Party with comrade Enver Hoxha at

their head for the full construction of our socialist society. That letter is an important historic document imbued with the immortal ideals of marxism-leninism, with the spirit of proletarian internationalism, the courage, the unshaken and consequential attitude of the Party and the people and their determination to stand firm against the pressure and blackmail of the Chinese revisionists, to march always forward on the illuminating road of socialism and communism.

The paper points out that the base act of the Chinese revisionists, committed from the position of a big power, recalls the savage chauvinistic methods used some years ago by the Yugoslav and Chrustevite revisionists, who attempted to lead astray the Party from the glorious road of marxism-leninism, to sabotage the revolution and the construction of socialism in our country.

By disclosing the ideological, political, and socio-economic roots of the counter-revolutionary theory of the «three worlds», by unveiling the links of that theory with modern revisionism and world capitalism, comrade Enver Hoxha unmasks and denounces to the eyes of the world the dangers of Chinese revisionism.

The collective body of the Faculty of Medicine, guided by the revolutionary principles of relying on our own forces, took a series of resolutions aimed at the intensification of the technical and scientific revolution as an integral part of the socialist revolution.

Résumé

AVEC LE PARTI EN TÊTE ET UNE CONFIANCE INÉBRANLABLE EN NOS FORCES, NOUS IRONS TOUJOURS DE L'AVANT

Les travailleurs et les étudiants de la faculté de Médecine près l'Université de Tirana ont unanimement approuvé la Lettre que le CC du PTA et le Gouvernement albanais ont adressée au Parti communiste et au Gouvernement chinois. Ils ont uni comme un seul homme autour du Parti, avec à sa tête le camarade Enver Hoxha, pour porter à terme l'édification de la société socialiste. Cette Lettre est un important document historique, imprégné des idées immortelles du marxisme-léninisme, de l'esprit d'internationalisme prolétarien, de l'audace, de leur détermination de ne pas flétrir face aux pressions et chantages des révisionnistes chinois, afin d'aller toujours de l'avant dans la voie lumineuse du socialisme et du communisme.

L'acte ignoble des révisionnistes chinois, accompli à partir des positions de grand Etat, rappelle les méthodes féroces chauvines entreprises il y a quelques années par les révisionnistes yougoslaves et soviétiques, qui se sont employés à écarter notre Parti de la voie glorieuse du marxisme-léninisme, à saper la révolution et l'édification du socialisme chez nous.

En découvrant les racines idéologiques, politiques, économiques et sociales de la théorie contre-révolutionnaire des «trois mondes», en dévoilant les fils qui rattachent cette théorie au révisionnisme moderne et au capitalisme mondial, le camarade Enver Hoxha a mis à nu et dénoncé publiquement le danger que représente le révisionnisme chinois.

Se guidant sur le principe révolutionnaire de l'appui sur ses propres forces, le collectif de la Faculté de Médecine a pris une série d'engagements afin d'ap- profondir la révolution technique et scientifique en tant que partie intégrante de la révolution socialiste.

KARAKTERISTIKAT KAPILAROSKOPIKE DHE OSHILOGRAFIKE NË DISA SËMUNDJE TË ENËVE TË GJAKUT DHE NË DIABET

— Doc. FIQRI BASHA —

(Katedra e Anatomisë — Histologjisë)

Kujdesi i vazhdueshëm i Partisë për shëndetësinë ka krijuar mundësitet për përmirësimin e metodave të diagnostikës me aparate të vlefishme, ndër të cilët hyjnë kapilaroskopia dhe oshilografia.

Sig dihet, kapilaroskopia është metoda e mikroskopimit të sipërqafeve epiteliale të epidermës, të endotelit, të mukozës së njerezve të gjallë, të kafshëve etj.

Metodika e ndricimit të epidermës u propozua në vitin 1911 (cituar nga 3), kur për herë të parë u panë kapilarët e lëkurës në llozhën e thosjit, pasi sheshohet fusha pamore, duke e lyer vendin me një pikë vajiparafine ose glicerine. Megjithëse kapilarët e lëkurës me anë të kapilaroskopisë zmadhohen 20, 70 ose 100 herë, ata duken shumë më mirë vetëm në palen e lëkurës pranë thoqit, sepse këtu shtrihen horizontalisht dhe paralelisht me lëkurën, e cila duhet të jetë e pa dëmtuar dhe e plotë.

Radha e parë e kapilarëve, menjëherë pas thoqit, duket qartë, kurse radhët e tjera, meqë kalojnë nën një kënd të pjetrë, nuk duken aq mirë edhe përfaktin se ato fillojnë tanimë të shtrihen pothuajse vertikalish ndaj sipërfaqes, këshu që ne shikojmë pika ose njolla që janë majat ose reliivi i kapilarëve.

Kapilarët e radhës së parë të llozhës së thoqit tek njeriu i shëndo-she duken si leqe të zgjatura, të kuqe të ndrișhme, në trajtë «karficash» të rreshtuara mirë, me një fund më të ngushtë (shtylla arteriale) dhe me fundin tjetër më të gjëri (shtylla venozë), ndërsa vendi i përkultur i bashkimit të dy shtyllave është maja e lakut kapilar (fig. 1).

Kur lëkura është e hollë, përvèç kapilarëve, nganjëherë duket edhe rrjeti venoz subpapilar. Gjatesia e shtyllës arteriale është 160 mikron, kurse e shtyllës venoze është 220 mikron. Edhe diametri i shtyllës arteriale është më i ngushtë, rreth 10 mikron, kurse i shtyllës venoze rreth 15 mikron. Numri i kapilarëve, në gjithë fushën pamore, arrin në 15-20 copë. Rryma e gjakut është e pandërprerë dhe e njërrajtshme, kurse sfondi, mbi të cilin duken kapilarët, është i verdhentë-trëndafil (fig. 2).

Ndryshimet e kapilarëve janë më të dukshme kur ka qregullime të qarkullimit të gjakut. Këto ndryshime shkaktohen nga ndikimi i të faktorëve me karakter funksional ose organik dhe, në radhë të parë, të eneve të gjakut, të gjymtyrëve të poshtme e të sipërmë.

Kështu në ūrozozt vaskulare, që janë zakonisht angjiliopati me qregullime funksionale, kapilarët kanë trajta të ndryshme, ndërojnë si numër, ndonëse më shpesh vërehet në fushën pamore se ato janë me

shumnicë, sepsë funksionojnë edhe rezervat, që në qetësi nuk punojnë përtë përballuar iskemi të indore. Prandaj kur punon ose ec, gjymtyra e ka të veshtrë t'i përshtatet iskemisë pa bërë disa ndalesa dhe pa e ulur diçka rrimin.

Shtimi i numrit të kapilarëve në angiopatitë është vënë re nga autorë të ndryshëm (3).

Gjatë vjetëve 1977-1978 ne kemi bërë 297 kapilaroskopi në persona me sëmundje të enëve të gjakut etj. sipas pasqyrës nr. 1.

Kapilaroskopia në disa sëmundje të enëve të gjakut etj.

Mosha vjeç	Reno		angio neuroz.		Arterit	Sëmundja hipertonike	Akroeri- trocianoz	Endarterit	Insuficiencë kardiovaskulare	
	F.	M.	F.	M.					F.	M.
Deri 20	11	3	5	4	7	11	—	—	1	—
21-30	6	13	6	9	9	15	1	1	3	—
31-40	10	2	2	6	4	13	2	2	—	1
41-50	6	2	5	11	1	11	3	2	1	—
51-60	—	1	—	5	—	3	2	4	4	—
61-70	—	—	2	2	—	4	7	6	3	—
Shuma	33	21	20	37	21	57	15	15	9	5
	54	57	78	30	14	35	35	35	9	20
										29

Në 57 angjioneurozat që ne pamë, kapilarët e gishtave të gjymtyrëve kishin prirje spastike, nuk mbusheshin mirë me gjak dhe pjesa venoze ishte më e trashë. Ato numëroheshin me vështrësi për shkak të ngjyrës së zbehtë, që nuk bënte kontrast me sfondin trëndafil të çelët të fu-shës pamore (fig. 3).

Në 35 të sëmurrë me endarterit obliterans (1), ne kemi vënë re kapilarë të deformuar me ansa të zgjeruara e të përdredhura, ndonëse në shtyllën venoze kish pjesë normale, herë të ngushtuara, por maja ishte e zgjeruar dhe kish hemorrhagi. Përvëç formave të shumëlojta edhe rrryma e gjakut nuk ishte konstante, herë ndërprijet ose ngadalësohej dhe herë shpejtohet (Fig. 4, 5, 6, 7, 8).

Në çregullimet angjiotrofike të tipit të sëmundjes Reno, në 54 të sëmurrë, tek të cilët procesi nuk kish arritur në ndryshime trofike, ne vumë re vetëm asfiski lokale nga iskemia indore vazomotore, por më shpesh kjo vihë re në duar sesa në gishtat e këmbëve. Ansat e kapilarëve

lluan tē zgjerohen aty fill pas mbarimt tē shptyllës arteriale, sidomos iaja dhe gjithë pjesa tjeter eferente kish stazë. Nganjëherë staza ishte përlapur edhe në shtyllen arteriale të kapilarit, por më shpesh këto fundit kishin ngushtica në sektorë të shumtë, ishin tē holla si tē tēr-qura nga mungesa e gjakut dhe nuk dukeshin mirë, sidomos kur tē imurët ishin në krije. (fig. 9).

Në fazat e mëvoneëshme të sëmundjes, kur fillojnë ndryshimet troke, mavjosja e gishtave, përsëritet shpesh, sidomos kur mjetësi është ftohtë dhe kur tē sëmurevë iu lagen gishtat. Përveç sektorëve spaastikë ë disa kapilarëve, këtu gjinden dhe kapilarë atonikë me përkulje dhe thesa të shunta zig-zake, me zgjerime të shptyllës venoze dhe arteriale he më rjetë mjaft tē dendur enësh, më mes tē tē cilave shihen fryrje neurizmatike dhe gjakrrijedje (ekstravazate) (2). Edhe më tē sëmuret anë me morbus Reno kemi konstatuar stazë kapilarësh dhe deformimë tyre (fig. 10).

Përgjithësisht kapilarët janë tē ndjeshëm ndaj ngacmimeve, pavarësish nga gjendja e mirë e arterieve dhe arteriolave.

Kështu, ndërsa më hiperemitë e indeve, kapilarët janë tē ngushtë, ë hollë e tē drejtë, 7-8 më 1 mm., dmth më një numër normal, sepse dhe arteriet me arteriolat janë më gjendje tē mirë, e kundërtë ndodh tē hipoksitë e indeve, ku ato janë edhe më shumë tē ndjeshëm. Kur ipoksitë e indeve pér shkak kresor kanë trombangjin obliterans, që a dëmtuar arteriet e mëdha deri më shumë, edhe këtu ka një fare kuqje tē gishtave, ndonëse disa herë, kur është ftohtë, ato zbehen. Në tēto raste skujja vjen nga mobilizimi i kapilarëve rezervë, që aktivizohen pér tē kompensuar mungesën e gjakut.

Këto kapilarë zgjerohen aty ku shtylla arteriale kalon më shptyllën renoze, aty ku gjaku lëviz me vështirësi ose shumë ngadalë.

Ky këmbim i reduktuar ndërmjet indeve pa gjak dhe kapilarëve varet jo vetëm nga çrrregullimet morfollogjike e funksionale, por edhe nga gjendja e ftohtë dhe e lagur e mjedisit, nga emocionet që shkaktojnë igacnimin e kapilarëve me lëndë simpatikomimetike.

Për këtë arsy, ekzaminimet ne i bëjmë vetëm më dhomë me temperaturë deri 20 gradë nxehësi e më kushte tē qeta.

Në 14 tē sëmuret me akroretirocianzoza, kapilarët ishin tē zgjerouar, por rryma e gjakut nuk ngadalësohej, kish ngjyrë blu-manushaqe ose jak më e kuqe dhe gjithë fusha pamore kish sfond tē zbehtë (fig. 11).

Në 78 tē sëmuret me angjipati tē llojit të arteritëve dhe tē arteriozave, që shkaktojnë prishjet kronike të qarkullimit të gjakut, tabloja kapilaroskopike varej nga forma dhe grada e sëmundjes. Në format e lehta, numri i kapilarëve shtohej, mbushja ishte pak a shumë e plotë, por rryma e gjakut ngadalësohej.

Në format e rënda tē arteriteve, kapilarët ishin me pakicë, kishin forme tē përthyer, tē deformuar me zig-zake dhe, shumë rrallë, gjetëm ndonjë kapilar tē plotë tē drejtë.

Në 29 tē sëmuret kardiorespiratorë me lezione tē zemrës më fazë, tē ndryshme të insuficiencës, kapilarët ishin tē shumtë, tē zgjeroar me maje tē shptyllës venozë tē trashë, rryma e gjakut e ngadalësuar, ngjyra ishte më e errët, sidomos më pjesën venozë dhe shptyllat arteriale mbusheshin fare pak me gjak. (Fig. 12).

TABLLOJA KAPILAROSKOPIKE NË TË SËMURËT ME DIABET NË GRADA TË NDRYSHME GLICEMIE SIPAS MOSHAVE

Pasqyra nr. 2

Mosha vjeç	Shuma Nr.	1 gr. Glicemë	2 gr. Glicemë	3 gr. Glicemi	1 Gr. glicemi	2 gr. Glic.	3 Gr Glicemi
deri 20	23	Zgjerim i gjurit kapilar Krahu arterial i hollë	9	Zgjerim i gjurit Kapilarë të hollë	2	Zgjerim i gjurit. Kapilarë të hollë	— Zgjerim i gjurit ven. Kapi- larë të hollë
21-30	21	Zgjerim i gjurit kapilar. Krahu arterial i hollë.	7	Zgjerim i gjurit. Kapilarë të hollë	1	Zgjerim i gjurit. Krahu arterial i hollë	3 Zgjerim i gjurit. Krahu arterial i hollë
31-40	25	Zgjerim i gjurit. 8-9 kapilarë me krahun art. të hollë	6	Zgjerim i kra- hut venoz Shumë kapi- larë arteri	1	Zgjerim i kra- hut ven. Shu- më kapilarë	10 Zgjerim i kra- hut venoz, shumë kapi- larë
41-50	24	Zgjerim i gjurit. Kapilarë të përthyer	3	Zgjerim i kra- hut venoz Shumë kapila- rë të përthyer	5	Zgjerimi i gju- rit, shumë kapi'larë të përthyer	2 Zgjerim i kra- hut venoz. Mbi 16 kapi- larë përm
51-60	12	Zgjerim i kra- hut venoz. Ka- pilare të përthyer	2	Zgjerim i kra- hut venoz. Kapilarë të cunguar	1	Zgjerim i kra- hut ven. Ka- pilare të zgje- ruar e të de- formuar	1 Zgjerim i kra- hut venoz. Shumë kapi- larë të për- thyer
61-70	1	Kapilarë të cop- tuar e të për- thyer	1	Kapilarë si presje në sfond të errët	— Kapilarë të coputar	— Kapilarë të shumtë si pikatë të kuqe të errëta	— Pika me njolla të shumta të kuqe të errëta

Në rastet më të rënda, numri i kapilarëve shtohej, shtylla venozë zjerohej pér së tepërmë dhe dukej pleksi venoz subpapilar me sfond ié tē errët.

Kur fillonte dekompenzioni, numri i kapilarëve pakësohej, tablloja nrbullohej shumë, konturet ishin tē paqartia, shtyllat ishin tē holla dhe arkullimi i gjakut ishte zakonisht shumë i ngadalte.

Në 30 të sëmurrë hipertonikë, ngushtimi i gjurit arterial tē kapilarëve vërejt si në formën e zbehtë, ashtu dhe në formën e kuqërremptë tē hypertonië.

Në tipin e zbehtë, kapilarët pakësoheshin dhe nuk mbusheshin ploësish, prandaq ishin tē holle, tē gjatë, polimorfë me zig-zake e ndërverje tē zbehta, ndërsa gjuri venoz e shtylla eferente zgjerohezin, rryma e gjakut ndërronte aty pér aty në sy, ose disa herë pakësohej lhe mund tē ndërpritej (fig. 13).

Kur hipertonia ishte e tipit tē kuqërremptë tē errët, numri i kapilarëve shtohej, ndonëse këto ishim tē gjatë e me shumë trajta, madje dhe tē zgjeraura, rryma e gjakut ishte e shpejtë dhe e qëndrueshme, ne mbushje tē madhe në pjesën venoze (fig. 14). Kur insuficiencia e pjesës së djathtë tē zemrës bashkohej edhe me hipertonië, rryma e gjakut ngadalohej shumë. Në sëmundjen hipertonike, që vjen si rrjeti i spazmës së arteriolave, tē cilat ngushtohen, në shtyllën venozë gjakut kalon drejt e në anastomozat arteriovenoze (fig. 15).

Kur duart janë tē zbehta, arteriolat zgjerohen dhe kapilarët ngushtoher, por kapilarët zgjerohen (4).

Sigështë paraqitur në pasqyrën nr. 2, në sëmundjen e diabetit tē sheqerit, kapilarët e lëkurës e kanë më tē zgjerauar majën e kalimit nga shtylla arteriale në shtyllën venoze, sepse, sig dihet, majës i takon më shumë punë në këmbimin ndermjet gjakut dhe indeve, prandaj shumica dërmuese e tē sëmurrëve tanë me glicemi tē lartë e kishin më tē zgjerauar majën dhe shtyllën venoze se ata me glicemi tē ulur.

Diabetikët e pamfekuar me insulinë etj. majën e kanë tē zgjerauar, kuruse shtyllën venoze nuk e kanë tē zgjerauar aq shumë, por pér shkak tē numrit tē madh tē kapilarëve, këmbëza venoze duket në trajtat më tē ndryshme (fig. 16).

Karakteristika kapilaroskopike në diabetikët e moshës mbi 70 vjeç eshtë dhënë në pasqyrën nr. 2 vetëm me një rast, pasi gjatë, vitit që bëjmë këtë studim nuk ka pasur tē tjerë përvëg 106 të sëmurrëve diabetikë. Por përparrë këtyre, ne kemi ekzaminuar të sëmurrë tē kësaj moshe diabet, ku kapilaroskopia tregon kapilarë tē coptuar, tē pakët nënumrit tē sfond tē errët nga eksravazat.

Miqjenëse gjendja e kapilarëve, përvëç faktorëve tē tjerë, varet kryesisht nga gjendja morfollogjike dhe funksionale e sistemit kardiovaskular, krahas kapilaroskopisë bëmë edhe oshilografinë, me qëllim që tē studojnë funksionimin e trungjeve tē mëdha arteriale.

Oshilografia arteriale na dha fakte bindëse pér ndryshimet funksionale tē arterieve tē kercirët dhe tē krahut, që u regjistruan në letren e osilografit, tē cilat tregojnë sa milimetra zhivë eshtë presioni i valës pulsive arteriale, gjë që jep një ide mbi regjimin e qarkullimit tē gjakut, i cili, sig dihet, rregullisht mbahet në shifra normale rrëth.

120 mmHg pér maksimalen dhe 60 mmHg pér minimalen.

Në oshilogramën arteriale i jepet rëndësi më shumë indeksit oshilator dhe, si i tillë, meret indeksi i amplitudës më të madhe. Ky varet nga kalibri i arterieve, nga gjendja e murit të tyre, nga madhësia e volumit sistolik, nga viskoziteti i gjakut etj.

Të gjithë këta faktorë ne i morrëm parasysh kur vlerësuam indeksin oshilator, i cili, më shumë se cdo ekzaminim tjeter, trëgon tonusin e murit arterial, që është më i madh në kërcinjt dhe më i vogël në krah. Duke shfrytëzuar oshilografinë e gjymtyrëve, ne patën parasysh të vërtetojmë me të dhëna objektive se sa marrin pjesë enët e mëdha të gjakut në procesin e disa sëmundjeve të sipërmëndura. Oshilograma e marrë nga arteria normale paraqet një varg dhëmbëzash, të clat në fillim janë të vogla, pastaj vijnë duke u zmadhuar 'ngadalë deri në një farë maksimumi e rishtas zvogëlohen shkallë-shkallë (fig. 17).

Kur arteria e gjymtyrës shtypet nga manzheta aq sa nuk kalon më lohen. Kur presioni në manshetë do të jetë baras ose më i ulët se tensioni maksimal, nën manshetë shpërndhen vala pulsive e pare, që regjistrohet si dhëmb i parë i madh. Në rastet kur presioni në manshetë do të jetë aq sa është tensioni mesatar dinamik, dhëmbëzat zmadhohen. Kur presioni në manshetë ulet, dhëmbëzat zvogëlohen.

Në rast se pulsi arterial është i dobët, dhëmbëzat janë të vogla (fig. 18), kur pulsi mungon, dhëmbëzat zhduken dhe del e regjistruar një vijë e drejtë (fig. 19, 20). Për të gjuar mbi gjendjen e murit arterialis dhe të katushmërisë së arteries, fakte më të rëndësishme jep oshilografia e dyanshme, dëmtë e të dy kërcinjve apo e dy krahëve, sepse normalisht në një rjeri ato kanë të njëjtin kalibr arterial, dhe zakonisht janë oshilograma identike, përndryshe në qoftë se njëra anë dha oshilogramë me dhëmbëza më të vogla dhe tjetra më të mëdha, atëkere kemi të bëjmë me ndryshime funksionale ose organike të njëres anë.

Kështu në të sëmurët tanë me neuroza vaskulare funksionale, ne nuk kemi gjetur ndryshime oshilografike, ndërsa ndryshimet e kapilarëve pararaqisin polimorfizëm të theksuar dhe vërehej një numër mjaft i madh i tyre.

Në të sëmurët me endarterit obliterans, krahas ndryshimeve të kapiilarëve, që u përmëndën më hart (shih pasqyrën nr. 1), në 35 raste ne kemi gjetur zvoglim të dhëmbëzave të amplifikuara oshilografike, ndryshime më të vogla të formës trambangjiteke dhe dhëmbëza shumë të vogla, që, të gjitha së bashku, jepnë një vijë të drejtë në formën sklerotike. Po këto ndryshime janë aneurizmat, embolitë e trombozat, komprimimi i arterieve, ligaturat, shtypje të tjera të tertiorta nga eciemat pastlebitike, flebotrombozat dhe sindromat pastlebitike të përparuar.

Në 57 të sëmurë me angjioneuroza të njëanshme, ne kemi gjetur ndryshime oshilografike dhe i kemi konsideruar si angjipati spastike, që në oshilogramë janë indekse oshilatore paq më të vogla se gjymtyra tjeter; por pas ekzaminimësh të përsëritura, krahas përmirësimi neurologjik, indeksi është barazuar në të dy gjymtyrët. Po kështu edhe nga çrrëgullimet e njëanshme të sistemit nervor qëndror, nga traumat mekanikë të gjymtyrëve, nga nxemja ose ftosha e njërsë këmbë apo dorë, nga fizioterapia, nga puna me njëren këmbë ose dorë etj. shfa-

qen angjioneuroza vibrative funksionale, që vihen në dhukje në oshilogramë me indeks të vogël, por me karakter të përkohshëm.

Nga analiza e 54 rasteve me sëmundje Reno, asimetria fiziologjike shkaktohet nga reaksionet normale ndaj ngacmuesve të ndryshëm dhe ndikohet nga impulsset patologjike të vatrave të irritimit, që ndodhen në arterien karotide për rreth indeve të saj, në aparatet nervore të sistemet nervor qëndror e periferik, që rregullojnë qarkullimin e gjakut.

Në fazën e parë të sëmundjes Reno, siç u përmend, vëreheshin kapilarë spastikë të holle si fije dhe, në disa vende, me qata të ngushta si copa të shkëputura; rryma e gjakut ishte e shpejtë, por në disa raste ajo nuk dukej, sepse sistemi i përgjithshëm i kapilarëve ngushtohej, kështu që e shtonte pengesën për lëvizjen normale të gjakut, foni ishte i zbehtë. Në këtë fazë, edhe gjishtat ishin të ftotë, mavi dhe tabloja kapilaroskopike e sinkopësë përputhej plotësisht me simptomat klinike. Në këtë fazë, sohילacionet janë të mëdha nga 25-40 mm, tensioni arterial normal ose pank i ngritur 14/90 dhe gjymtyrët kanë asimetri ndërmjet tyre.

Në fazën e dytë të sëmundjes Reno në kapilaroskop vërehet stazë kapilarësh atonikë, në fon të zbehtë; nga edemat kapilarët ishin të zgjuar si qeska të mbushura njëloj si për këmbëzën arteriale ashtu dhe venozën. Rryma e gjakut ishte tepër e ngadaleuar, por më shpesh nga staza krijoreshin edhe njolla të kuge si presje të trasha që janë ekstravazate. Në shumë raste krijohej atoni kapilarësh nga shëimi i rrjetit të kapilarëve dhe nuk kish më pengesë për kalimin e gjakut të pakët, që e zgjelonte valën pulsive. Prandaj në oshilografi, sidomos gjymtyra e sipërme paraqiste oshilacione të vogla nga 5-16 mm dhe kish asimetri indeksesh në rreth 50% të rasteve ndërmjet dorës së majtë e të djathtë. Kjo tregonte lidhjen e çrrëgullimeve lokale me gjendjen e përgjithshme të organizmit.

Në eritralgjitet, ndonëse ka zgjermim kapilarësh, nuk vihen re ndryshime në amplitudën oshilografikë.

Në 78 angjipati me prishje kronike të qarkullimit të gjakut, kur në kapilaroskop vëreheshin shumë kapilarë (në fazat e para), në oshilografi, amplituditat e dhembëzat pakësosheshin dhe, në fazat kronike, indeksi binte në një vijë të drejtë, ndërsa kapilarët ishin të paktë e të deformat.

Në 29 të sëmurë kardioaskularë, oshilografia pasqyroj mirë jo vetem gjendjen e arteries, por edhe të zemrës nga pikëpamja fonksionale, duke regjistruar njëkohësisht valën pulsive, rümin e zemrës, tensioni e gjakut dhe shkallën e lezonave morfollogjike arteriale, që shpreheshin me dhëmbëzëa të vogla kur bashkohej edhe ateromatozoa. Përgjithësisht në të gjitha sëmundjet e enëve të gjakut, zmadhimi i amplitudës së indeksit oshilator dëshmonte për dobesi të murin enor (humbjë tonusi, humbjë elasticiteti, sklerozë etj.), kurse zgogrimi i amplitudës oshilografike (po qe se nuk ka ndryshime organike) flet për gjendje spastike. Vëtëm sëmundja Reno bën përiashkim, sepse spazma këtu kap kapilarët. Kështu ne kemi gjetur një amplitudë të madhe oshilografike në të gjithë të sëmurët me sëmundje hipertoniqe pa zënie arteriale. Në fazat e përparurara, kur bashkohen edhe fenomenet obliterative nga pilakat ateromatoze ose trombozat eventuale të ardhura nga çrrëgullimet kardiakë e të tjera faktorë hemoneurohumorale, amplituda e in-

dëksit oshilator zbriste deri në një vijë të drejtë ose kish dhëmbëza fare të vogla, kish asimetri ndërmjet amës së majtë e të djathtë, ndosmë më shpesh dëmtimet ishin të dyanshme. Por megjithëkëto ndryshime të enëve të gjakut, gjymtyra nuk kish fare ndryshime trofike nga iskemia kronike, sepse ndryshimet morfollogjike kanë ardhur gradualisht dhe kolateralet e enëve të vogla të gjakut kanë pasur kohë të zhvillohen. Ato nuk jepin valë pulsive të regjistrueshme në apparatin oshilografik, por një farë reliivi pak të dukshëm arteriografik (5).

Për të dhënë më të qartë karakteristikat e pamjeve kapilaroskopike dhe të indekseve oshilografike, ekzaminimet po i paraqesim në pasqyra të veganta, që përfshinë moshat e të dy gjinive, shkallën e dëmtimeve në format e ndryshme të sëmundjeve kardiovaskulare, tiparet mikro-angiopatike dhe makroangiopatike të të sëmurëve, të cilëve iu është bërë kapilaroskopia dhe oshilografia. Ndonëse vetëm me këto metoda nuk dihet diagnoza e përpiktë, prapë nëpërmjet tyre kërkohet të arrinhet në rje përvaktum më të diferençuar të diagnozës së sëmundjeve sistematike.

Të sëmuarët e ekzaminuar janë dërguar për të konfirmuar kryesisht angiopatitë (aterosklerozë, endarteritin, arteriosklerozë, tromboembolë, tromboangjiti), sindromat pasflebitike, sindromat neurovaskulare, spastike kalintare, morbus Reno, eritralgjië etj. sëmundje kardiovaskulare të kompensuara e të dekompenzuara, hipertoni, diabetikë pa gangrenë ose me gangrenë; më pak janë vizituar me sëmundje venoze të duksëme, me elefantazë, me ulcer trofike, me ulcer që nuk mbyllët për një kohë të gjatë, me neurit, artralgji, radikuolskalgji, parestezi, akroeritrocianozë, akridini, sklerodermi, kolagjenoza etj.

Indikacionet për ekzaminim kanë qënë të pakufishëm, sepse metodat e lehta dhe e padëmshme për të sëmuarët.

Tabloja kapilaroskopike ndryshonte kur kish përmirësim klinik:

rryra e gjakut shpejtohet, sfondi merri ngyrë trëndafili, numri i kapilarëve punonjës shtohej, elementet e atonisë dhe të spazmës pakësohen.

Të dhënat e oshilografisë gjithashtu ndryshonin kur kish përmirësim klinik, si p.sh. në disa prej tyre mund të vije re zhdukja e asimetrisë së indekseve oshilatore; raportet e oshilacioneve ndërmjet duarve dhe këmbëve afroreshin pak. Në të sëmuarë me tension të lartë, pas mijekimit, krahas rënjes së tensionit, zbutet dhe indeksi oshilator, i cili i atrohej më shumë normës. Kështu që afrohej edhe rapporti i indekseve ndërmjet duarve dhe këmbëve.

Nga viti 1962 deri në tremujorin e parë të vitit 1978 në spitalet dhe ambulancat tona janë ekzaminuar 1356 të sëmuarë meskuj dhe 208 femra (shih pasqyrën nr. 3). Për të diferençuar formën dhe shkallën e sëmundjes ose për të dalluar më se janë dëmtuar enët e imta apo të mëdha, janë bërë 1705 oshilografi të përsëritura. Kur enët e imta dëmtohen, indeksi bie më të tretën e poshtme dhe ruhet më të tretën e sipërme të gjymtyriës.

Si përfundim mund të themi se vrojtimet tona treguan se kapilaroskopia dhe oshilografia e njëkohshme janë metoda ekzaminimi fizike fare të parrezikshme dhe fiziologjike dhe, për më tepër, shumë të lehta dhe të shpejta për t'u aplikuar në spital, në poliklinikë e kudo

PASOYRA E EGZAMINIMEVE OSHILOGRAFIKE SIPAS
MOSHES DHE GRADES SE SEMUNDJES

Pasqyra Nr. 3

	GJYMTYRA												PERCENTI PER CENT.				
	E MAJTE GRADA			E DJATHTE GRADA			MAJTE			DJATHTE							
	I	II	III	I	II	III	M	F	M	F	M	E	M				
MEJNDA SHKË	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	E	PERCENTI PER CENT.			
DERI D	3	12	1	5	2	4	1	6	1	5	1	1	15	36	18	31	142
21-30	3	42	2	38	-	28	4	40	2	30	-	36	23	42	24	42	356
31-40	6	34	2	58	-	32	7	44	4	30	1	40	25	48	23	48	402
41-50	1	36	-	46	-	34	1	46	-	36	-	32	7	46	7	46	338
51-60	1	38	3	20	3	30	3	28	1	36	-	18	6	28	6	28	249
61-70	-	10	-	4	-	9	-	12	-	4	-	16	-	10	-	11	76
Shuma	14	172	8	171	5	137	16	176	8	141	2	143	76	210	78	206	1563

**TABELA E KARAKTERISTIKËS KAPILAROSKOPIKE DHE OSHILOGRAFIKE NË TË SËMURË ME ANGIOPATI
TË NDRYSHME DHE DIABET**

Diag. dërgimit	Gjendja e enëve të mëdha	Gjendja e enëve të vogla	Kapilaroskopia	Oshilografia
Neuroza vaskulare (akro-cianoza)	Normale	Pak atoni	Shumë kapilarë	Normale
Endarterit	Reduktim i fluksit arterial	Normale	Spazëm	Ind. i ulur
Angiopati spastike	Preket pulsi dobët, ka pakësim fluksi	Pak gjak arterial, zbeh-tësi	Spazëm	Ind. pak i ulur
Sëmundja Reno	Normale	Gjendje spastike atonike	Liqenj hematikë	Normale
Eritralgi	Normale	Lulëzim i kuq	Kapilare të zgjeruara të errët	Normale
Angiopati kronike	Pak gjak, pa puls,	Liqenj dhe lidhje intrakapilare	Reduktim i fluksit arterial dilatim venulash si qese	Ind. i ulur ose vijë e drejtë
Sëm. Hipertonike	Preket pulsi i fortë edhe në enë të vogla	Pa ndryshime të dukshme	Kapilar të përthyer	Ind. i lartë oshilografik
Sklerodermi e kolagenoza	Pak ndryshime të dukshme në enët e mëdha ose pa ndryshime	Pa ndryshime	Pa ndryshime	Ind. Normal
Diabeti	Normale, rrallë të obliteruara	Spastiko atonike	Zgj. i gjurit venoz	Ind. normal rrallë i ulur

jeri ne vizitat shtëpijake për të diagnostikuar të sëmurët me enë gjaku; prekura nga sëmundja Reno, nga akroeritrocanaza, nga arterietët gjitale, nga trombangjiti obliterans, nga ateroskleroza e enëve periferike të gjakut, nga endarteriti etj.

Kapilaroskopia dhe oshilografia vlefjnë shumë në të sëmurët diabetikë për dinamikën e procesit dhe progozoën e gjymtyrës së dëmtuar nga ndryshimet tifrike apo gangrena eventuale. Në shumicën e rasteve, këto metoda parandalojnë dhe e bëjnë të panojshme aplikimin e metodave të tjera, që janë të dëmshme për shëndetin e të sëmurit diabetik, i cili është i ndjeshëm ndaj traumës së pukcionit dhe vëganërisht ndaj presionit të lëndës jodike mbi endotelin e arteries gjatë arteriografsë.

Dorëzuar në Redaksi më 20 qershor 1978. —

B I B L I O G R A F I A

- 1) **Basha F.:** Diagnostika dhe mjekimi i endarteritit obliterans. Tiranë 1966, 34 (Monografi).
- 2) **Dei Poli G., Mastrodiani V., Mariani E.:** Immagini capillaroscopiche all'iponice d'interesse chirurgico. Minerva Medica 1977, 1, 67.
- 3) **Krog A.:** The anatomy and physiology of capillaries. New Haven 1927.
- 4) **Lewis T.:** Die Blutgefäße des Menschen in gesunden und kranken Tagen Bd 1-2, Stuttgart 1939.
- 5) **Ratschov M.:** Die peripheren Durchlängungsstörungen. Dresden 1953.

Summary

CAPILLAROSCOPIC AND OSCILLOGRAPHIC CHARACTERISTICS IN SOME AFFECTIONS OF THE BLOOD VESSELS AND IN DIABETES.

The capillaroscopic changes in some diseases of the blood vessels and in diabetes, as well as in some other affections, are analysed and confronted with the oscillographic findings.

An increase in the number of the capillaries is common in angiopathies in general. In angioneurosis the venous loops of the capillaries are deformed, thick and pale. In endarteritis obliterans the loops appeared deformed, sinuous and diminished in number. In the Raynaud disease the loops are swollen at the junction of the veins with the arterial segments and all the efferent part was in a state of stasis. The arterial branch presented contracted segments, particularly in the more advanced stages of the disease, in which more pronounced curling and a more developed network of anastomoses was observed, ensuing presumably from the extensive stasis, work of anastomoses and chronic atony. Occasional bulging aneurisms and extravasates were also present.

In severe cases of arteritis, the capillaries were reduced in number.

In diabetes the passage from the arterial to the venous loop presented pronounced dilatations.

In addition to the oscillographic examination of the capillaries, the pulse waves of the magistral arteries were measured and presented detectable changes, particularly in endarteritis obliterans and some other chronic affection of the vessels, while in the Raynaud's disease the oscillatory index was reduced only in the advanced stages of the disease.

Capillaroscopy and oscillography are valuable and safe methods for the diagnosis of vascular diseases, but they can also be used in other conditions, such as diabetes, collagenosis etc., since they allow to do without other more risky methods such as arteriography, which must be restricted only to cases requiring plastic surgery or amputation.

Résumé

CARACTÉRISTIQUES CAPILLAROSCOPIQUES ET OSCILLOGRAPHIQUES DANS CERTAINES MALADIES DES VAISSEAUX DU SANG ET DANS LE DIABÈTE

Les modifications capillaroscopiques relevées dans certaines maladies des vaisseaux sanguins et dans le diabète, ainsi que d'autres affections, sont analysées et confrontées aux données oscillographiques.

Une augmentation du nombre des capillaires est habituel dans les angiopathies. Dans les angioneuroses les anses veineuses des capillaires sont plus larges et semblent déformées, simuueuses et peu nombreuses. Dans la maladie de Raynaud, les anses veineuses des capillaires s'élargissent au point de passage de la zone artérielle à celle veineuse et toute la partie éfferente présente une stase. La branche artérielle montre des segments contractés, notamment dans les phases avancées de la maladie, au cours desquelles l'on observe des flexions marquées et un réseau d'anastomoses plus développé, dus probablement à la stase, aux spasmes et à l'atrophie chromique. Dans les cas d'artérites graves, on relève une diminution numérique des capillaires.

Dans la maladie du diabète, le passage antérieille à celle veineuse se dilate sensiblement.

A part l'examen oscillographique des capillaires, il a été procédé au mesurage des ondes de pulsation des artères principales qui ont montré des modifications, particulièrement dans les cas d'endartérites oblitérantes et d'autres affections chroniques des vaisseaux; dans la maladie de Raynaud, par contre, l'indice d'oscillation ne diminue que dans la phase avancée de la maladie.

La capillaroscopie et l'oscillographie sont des méthodes efficaces et non dangereuses dans le diagnostic des affections vasculaires, mais elles sont indiquées aussi dans le cas d'autres maladies comme le diabète, les affections du collagène etc., du fait qu'elles évitent l'usage d'autres méthodes plus ou moins dangereuses pour le malade telle que l'artériographie qui ne doit être employée qu'en cas de chirurgie plastique ou d'amputation.




FIG. 1

Kapilarët e palës së thojit të gishhtit të dorës së njeriut të shëndoshë.




FIG. 2

Kapilarët e lëkurës së shpinës së këmbës të njeriut të shëndoshë.




FIG. 3

Kapilarët e palës së thojit të gishhtit të madh të këmbës në angjioneurozat.




Fig. 5

Pamje kapilarësh në angjioneurozat endarteritike.



Fig. 6

Kapilarë polimorfë me edëma dhe aneurizma të ndryshueshme me kupa hemorragjish në endarteritin.




Fig. 7

Kapilarë të zgjeruar të palës së thojtë të gishtit të madh të këmbës dhe pleksi venoz subpapilarë në endarteritin obliterans.



Fig. 9

Kapilarë miaft të zgjeruar të paliarët së thojt të gishtit, të dorës me rrymë gjaku të ngadalësuar, me trombe në morbus Reno. Përmes ka edemë dhe hemorragji me rjetë të zhvilluar kompensatorë.




Fig. 10

Kapilarët në mikroangiopatië e avancuara me rekanalizim në sëmundjen Reno.




Fig. 12

Kapilarët e palës së thojt të gishtit të dorës në gjendje atonie në alkroeritrocitozat.

Fig. 11

Kapilarët e palës së thojt të gishtit të dorës në gjendje atonie në alkroeritrocitozat.




Fig. 13

Kapilarët e thojt në hipertoni-
ninë e zbehtë.




Fig. 14

Kapilarët e pales së thojt në hi-
pertoninë e kuqëremë.



Fig. 15

Kapilarë në gjendje spastike dhe
rekanalizime të tyre në hipertoni-
në.





Fig. 16

Numur i madh kapilarësh në traj-
ta të ndryshme me gjurin e zgj-
ruar në diabetin.



Oshilogramë në të sëmurrë me insufficiencë vaskulare të gradës së parë.

Fig 19
OSHILOGRAME
INSUFICIENCIE
GRADE E DYTE





Fig 20
OSHILOGRAME
INSUFICIENCIE
GRADE E TRETE



Oshilogramë e regjistruar në të së-murin me insuficiencë vaskulare të gradës së dytë.

Oshilogramë e regjistruar në të së-murin me insuficiencë vaskulare të gradës së dytë.

VLERA E PROVËS ME BETA-BLOKUES NË DIFERENCIMIN E RREGULLIMEVE ELEKTROKARDIOGRAFIKE TË REPOLARIZIMIT VENTRIKULAR

PANDELI ÇINA – SPIRO QIRKO – LIJESH RROKU, – AFËRDITA SHELLA – ASILIKA KARAJANI, ME BASHKËPUNIMIN TEKNIK TË POLIKSENI MARKUT DHE MUAZEZ MYDERIZIT –

Reparti i sëmundjeve të brendshme të spitalit të rrëthit Berat, reparti i kardiologjisë Poliklinikës Qendrore – Tiranë, Klinika e kardiologjisë e spitalit klinik nr. 1 – Tiranë

Krahas përdorimit sa vjen e më të gjërë të betablllokuesve (bb) në jekimin e sëmundjeve të zemrës, janë kryer edhe mjaft punime për të tudiuar ndikimin e tyre në kurbën elektrokardiografike në persona të hëndoshë, në të sëmurrë me sëmundje organike të zemrës dhe në ata me rregullime funksionale të aparavit kardiovaskular (ap.k.v). Këto vjetët e rregullime funksionale të aparavit kardiovaskular (ap.k.v). Këto vjetët e rregullimet e repolarizimit venrikular, ato janë përdorur për të bërë diferençimin e këtyre ndryshimeve kqrafike, që shfaqen në të sëmurrë me sëmundje organike të zemrës nga to që hasen në persona me çrregullime funksionale të ap.k.v. (2, 3, 4, 7).

Sigurisht, në qoftë se do të vërtetohet vlera e një prove të tillë ajo lo të konsiderohet me të vërtetë e gjmuar, po të marrën parasysh vështirësitet që hasen te shumë të sëmurrë në interpretimin e përpiktë të ndryshimeve të segmentit ST dhe të valës T.

Në këtë punim, ne i kemi vënë vetes për detyrë të studojjmë ndjimin e bb në ndryshimet e segmentit ST dhe të valës T, që gjetëm në 71 persona me moshë nga 26 deri 70 vjeç.

Në grupin e parë u futën 20 të sëmurrë me sëmundje koronare të zemrës (SKZ), në grupin e dytë u përfshine 41 persona me simptoma ipike të astenise n. cirkulatorë (ANC); veç tyre u studjuar ndikimi i bb në raste me sindromin Wolff-Parkinson-White (grupi i III), në 3 raste me kardiomiopati idopatike (grupi i IV) dhe në 2 raste me hipertireozë (grupi i V). Kështu u morën në studim gjithsej 71 veta. Në grupin I kishte 4 meshkuj e 16 femra me moshë që luhatëj nga 30 deri 70 vjeç, ndërsa në grupin II u përfshinë 38 femra dhe 3 meshkuj me moshë 26 deri 54 vjeç (pasqyra 1).

METODIKA

Personave që u morën në studim iu krye një ekzaminim ekgrafik në qetësi, në mëngjes esell, në pozicion shtrirë dhe një tjetër, në të njëjtat kushte, dy orë pas marries të 40 mg propanolol ose oksprenolol (transitor). Në 16 persona me çrregullime funksionale të ap. k. v., ekzaminimi

elektrokardiografik, para dhe pas marries nga goja të bb, u krye edhe në pozicion ortostatik, ndërsa në 10 të tillë u krye edhe prova e Valsalves. Në 6 të sëmurrë me SKZ dhe në 5 persona me simptomatologji funksionale, ku të dhënët kliniko-ekgrafike ishin të diskutueshme, u krye edhe prova ekgrafike me ngarkesë (pasqyra nr. 2).

Pasqyra nr. 1
Përdorimi i betabollokueseve për diferencimin e rrregullimeve ekgrafike të repolarizimit ventrikular në 71 persona

Grupi	Patologjia	Raste	Seksi	Mosha
		F.	M.	
I	Angina pectoris Infarkt akut miokardî (transmural) Infarkt akut miokardî (subendokardial)	17 1 2	14 1 —	3 1 —
II	Simptoma të astenisë n. cirkulatorë ose ankesa Jotipike për angina pectoris	41	38	3
III	Sindroma Wolff-Parkinson-White	5	4	1
IV	Kardiomiopatia idiopatike kongestive	3	3	—
V	Hipertriœza	2	2	—
	Gjithsej	71	63	8

Mënyrat e ekzaminimit ekgrafik në 71 persona që iu nënshtruan provës me betabollokues

Pasqyra nr. 2

Lloji i ekzaminimit ekgrafik	Rastet
EKG (esell, në mëngjes) fill para dhënies së bb dhe 2 orë më vonë	71
EKG në pozicion ortostatik	Të sëmurrë me SKZ Personaj me simptomë të astenisë n. cirkulatorë
EKG gjatë provës së Valsalvës	Të sëmurrë me SKZ (angina pectoris) Personaj me simptomë të astenisë n. cirkulatorë
EKG me ngarkesë (prova me dy shkallare)	Të sëmurrë me SKZ (angina pectoris) Personaj me simptomë të astenisë n. cirkulatorë

R E Z U L T A T E T

1) Në grupin e të sëmurrëve me SKZ (20 raste), pas marrjes së bb, në repertin ekgrafik ndryshime të duksme u vunë re vetëm në frekuencën e zemrës, ku pati një ulje të saj, ndërsa segmenti ST dhe vala T në 15 raste nuk ndryshuan fare, (Fig. 1 dhe 2), ose, siç u vu re në dy raste, pësuan pak ndryshime (pasqyra nr. 3).

Pasqyra nr. 3

Ndikimi i betabollokuesëve në frekuencën e zemrës, segmentin ST dhe valen T në 20 të sëmurrë me sëmundje koronare të zemrës

Frekuencia mesatare e zemrës/min.	Para bb	pas bb
73	73	62
<hr/>		
<i>Segmenti ST i deniveluar</i>	15	pa ndryshim
		kthim në vijën bazë plotësishët
i supraniveluar	3	pa ndryshim
në vijën bazë <i>Vala T</i>	2	pa ndryshim
negative	8	pa ndryshim
		thëllim i negativitetit
e sheshitë		1
pozitive	3	1
pozitive	3	3
e ulur ose e sheshitë	8	5
bifazike (— +)		3
bifazike (— +)	5	3
negative		1
normalizim		1

SHTRIRE NE KEME
Poreč Asto. Kostel. Rosič. Prati. Rovinj.

MELALVA

NE KEME
VILJALVA

Prati. Rovinj.




FIG. 1

Te kjo e sémurë, vjeç 43, me angina pectoris, gjë që u vërtetua me anën e provës me ngarkesë, segmenti ST dhe vala T nuk pësuan pothuaj fare ndryshime pas marrjes së betablibloksit.




Fig. 2

Te kjo e sëmure, vjet e 43, me simptomatologji jotipike për **angina pectoris**, ku prova me ngarkesë rezultoi pozitive (denivelim i tipit iskemik i segmentit ST - i pjerret nga hart poshtë - me pikën «J» të deniveluar), betablibloqueti nuk ndikoi aspak në ndryshimet e segmentit ST dhe në valën T.

Këshu në shëmnicën dërmuese të të sëmurëve të grupit të I me SKZ, çrrregullimet e repolarizimit ose nuk u ndikuan fare nga përdorimi i bb ose, në ato pak raste ku u vu re një gjë e tillë, ndryshoi vetëm pjesa e tij fundore, pra vala T (fig. 3).




FIG. 3

Te kjo e sëmuri, vjet 46, me ngarkesë të theksuar dhënhëgimore për sëmundje koronare dhe provën elektrokardiogramike me ngarkesë pozitive (dienvelim vijëdejtë i segmentit ST në V_5 , nga 2' e 15'' deri në 7' e 15''), pas marrës se betablokuesit, vala T u normalizua plotësisht. Vjen të shënohet se ky rezultat u përfshi në mënyrë të partë gjate provës se Valsalvës, e cila para bë kishte rezultuar pozitive, ashtu siç ndodh te persona me asteni neurocirculatorë. (Shih tekstin).

Eshtë për tu shënuar se betablokuesit nuk ndikuan aspak në traktin ST-T gjatë fazës akute në 3 të sëmuri me infarkt akut miokardi (një ditën e 21 të infarktit transmural të miokardit dhe dy të tjera në javën e dyte të infarktit subendokardial).

2) *Në grupin e personave me çrrregullime funksionale të arik. vascular* (41 persona) nga përdorimi i bb u vu re jo vetëm një ndikim i

theksuar në frekuencën e zemrës, por edhe në segmentin ST dhe valën T në 41 persona T (pasqyra nr. 4).

Pasqyra nr. 4

Nëkimi i betablibloquesëve në frekuencën e zemrës, segmentin ST dhe valën T në 41 persona me simptoma të astenise n. cirkulatorë		Vlera e provës me betablibloques	
Frekuencia mesatare e zemrës /min.		Para bb	Pas bb
Segmenti ST interesuar	31 raste	normalizuar plotësisht ose pjesërisht në 27 raste	
deniveluar	29 raste	kthim në vijën bazë plotësisht	23 pjesërisht
			4
në vijën bazë	— pa ndryshim		2
tendosur	raste 10	pa ndryshim	10
	raste	zbutet	
Vala T e ndryshuar	36 raste	pa ndryshim	1
negative	5	Normalizuar plotësisht ose pjesërisht 30 raste (45 lidhje)	
		normalizuar plotësisht	2
cilur	24	normalizuar pjesërisht	2
		bitazike (— +)	1
cheshtë	14	Normalizuar plotësisht Normalizuar pjesërisht pa ndryshim	19 3
pozitive	4	normalizuar plotësisht pa ndryshim (ose rritle e lëtë e amplitudës)	12 2
bifazike (— +)	8	normalizuar plotësisht pa ndryshim	7 1

Nga pasqyra nr. 4 del qartë se në të gjithë personat me çrrëgullime funksionale, që u morën në studim, vihet re një ndikim pozitiv i qartë në kuadrin ekgrafik pas përdorimit të bb, si përsa i përkët segmentit ST ashtu dhe valës T (fig. 4, 5, 6, 7).

Po të krahasonjmë rezultatet e përtuara nga ndikimi i bb në çrrëgullimet e repolarizimit të persona që kishin patologji funksionale me ato




Fig. 4

Ky rezultat spektakular pas marries se betabollokuesit u përf tua tek një grua 46 vjeqe me simptomatologjinë e ashtenisë neurocirculatorë, e cila në EKG paraqiste ndryshime të segmentit ST dhe të valës T sugjestionuese për sëmundjen iskemike të zemrës.

që u përf tua në të sëmurrë me SKZ, ndryshimi i rezultateve midis këtyre dy grupave eshtë i përkshëm.

3) Në grupin e personave me sindromën *Wolf-Parkinson-White* (5 raste) vetëm në një rast me ANC, pas përdorimit të bb, u vu re kthimi në vijën bazzë i segmentit ST më parë të deniveluar, ndërsa në katër rastet e tjera këta agentë nuk e ndikuan fare denivelimin e këtij segmenti.

4) Në grupin e të sëmurrëve me *kardiomiopati idiopatike konsistive* (3 raste) bb nuk indikuon në asnjë rast ndryshimet e segmentit ST dhe të valës T.

5) Në dy të sëmurrë me *hipertireozë* denivelimi i segmentit ST dhe ndryshimet e valës T u ndikuan në mënyrë të dukshme pas marries se bb. Te personat që morën stobetinë, ajo ndikoi pozitivisht në segmentin ST në 60% të rasteve dhe në valën T në 69%, ndërsa te ata që morën trasikor, ndikimi pozitiv u vu re në 55% të rasteve si në segmentin ST ashtu dhe në valën T. Pra, me gjithë kufizimin që ka ky tregues për

arsye të numrit të vogël të personave që morën trasitor, del se nuk ka ndonjë ndryshim të vëgantë midis tyre përsa i përket ndikimit në segmentin ST dhe në valen T.




Fig. 5

Në këtë rast (ë sëmura 50 vjeç) me asteni n. cirkulatorë dhe provë me ngarkesë negativë, betabliblokuesi nuk ndikoi në repertin elektrokardiografik, që paraqiste ndryshime të dyshimta të traktit ST-T.




FIG. 6

Te kjo e sëmuri e me simptomatologjinë e distonisë neuroveglativë, që për një kohë ishte dyshuar për sëmundje koronare të zemrës, betabollokuesi solli normalizimin e valës T. Prova elektrokardiografike me ngarkesë tregoi repertin karakteristik të tipit të «ST së bashkimit» («Junction S-T»).




FIG. 7

Betabollokuesi ndikoi pozitivisht në normalizimin e valës T dhe në kthimin e segmentit ST në vijën bazë, te kjo e sëmuri 43 vjetëre me simptomat e astenisë n. cirkulatorë.

DISKUTIM

Dihet se ndikimi i bb në receptorët beta të zemrës konsiston në mbrojtjen e miokardit nga veprimi i shkarkimit katekolaminik dhe përdisa bb (oksiprenolli), kjo varet nga niveli i tonusit simpatik (veprim intrinsek simpatomimetik): kur ai është i ulët bb ka veprim stimulues, ndërsa kur tonusi është i lartë betablibkues (1,8). Si rrjedhim, ulet frekuencia e zemrës, pakësohen fuqia t'kurrëse, vëlimi në minutë, puna e zemrës dhe konsumi i oksigjenit. Katekolaminat risin rrjedhën koronare dhe shtojnë furnizimin e miokardit me oksigen. Veprimi kompleks i katekolaminave zhvillohet në dy rruge: nëpërmjet vazokonstriksionit nga stimulimi i alfa-receptorëve, që maskohet nga vazodilatazioni, i cili është më i qëndrueshëm. Ky veprim i fundit kushtëzohet nga stimulimi i beta-receptorëve të shtratit vazal koronar dhe, në një fazë të dyte, nga stimulimi i betareceptorëve të nückardit, që bën të rritet fuqia e tij t'kurrëse dhe të shtohet rrjedha koronare. Duke frenuar betareceptorët me anën e bb, vegenërisht ata të miokardit, rrjedha koronare ulet. Megjithëse si rrjedhim i veprimit të bb, që pakëson punën e zemrës, furnizimi i miokardit ulet, pakësohen edhe nevojat e tij për O_2 , kështu që në totale, bilanci i O_2 mbetet pozitiv.

Të persona me gregullime funksionale të ap.k. vaskular nga mbizosht në shtrimin e frekuencës së zemrës, si rrjedhim gregullohet repolarizimi ventrikular. Kjo gjë karakterizonet me ndryshim t'ë segmentit ST dhe të valës T. Në persona të tillë, duke frenuar betareceptorët kardioblo ndikojnë pozitivisht në procesin e repolarizimit dhe, si rrjedhim, bëjnë që të rikthehen ndryshimet e segmentit ST dhe të valës T(3). Këtu janë bazuar një sërë punimesh, që nxorrën në pah ndikimin e favorshëm të bb në gregullimet e repolarizimit në persona me asteni n. cirkulatorë osse gjatë një stresi emocional (2, 3, 4, 5, 6, 7).

Në punimin tonë, ky veprim i bb u vërtetua në individë të tillë me asteni neurocirkulatorë (ANC). Në 41 persona me simptoma tipike të ANC, segmenti ST ishte i deniveluar në 29 persona; nga këta në 27 veta ky segment u normalizua pas bb si në pozicionin shtrirë ashtu dhe në atë ortostatik. Vala T, e cila para përdorimit të bb u gjend e ndryshuar në 36 raste, ishte negative në 5 lidhje, e ulur në 25 lidhje, e shesitë në 14 lidhje dhe bifazikë në 8 lidhje, pra ishte ndryshuar në 52 lidhje. Pas marries së bb u normalizua si në pozicionin shtrirë ashtu edhe në atë ortostatik, në 30 raste (46 lidhje). Pra, shohim se ndikimi i bb në fazën e repolarizimit ventrikular te persona me simptomatologji funksionale, në shumicën dërmuese të rastev, ishte i favorshëm (Fig. 4, 5, 6, 7).

Është treguar se në pozicionin ortostatik te persona me ANC, sfondi ndryshime të segmentit ST (denivelim) dhe të valës T (negativizm). Ky marjen e bb, gjë që e vurmë re në të 16 rastet tona me ANC dhe vetëm në dy nga shtatë raste me *angina pectoris*.

Në të sëmurët tanë me SKZ, ndikimi i bb në segmentin ST pothuajse vluar në 15 dhe e supranieluar në 3), vetëm në një rast u vu re kthimi

i plotë në vijën bazë i këtij segmenti. Po ashtu nuk u vu re ndonjë ndikim i dukshem i bb në valën T të ndryshuar (në 21 lidhje): vetëm në dy prej tyre, vala T u normalizua pas marrjes së bb.

Ne provuam të studojmë ndikimin e bb në segmentin ST në tre

të sëmurë me infarkt akut miokardi. Në asnjë prej tyre nuk u vu re ndryshimi i segmentit ST pas marrjes së bb. Kjo është e kuptueshme, sepse ndryshimet e këtij segmenti nuk i detyrohen simpatikotomisë, por komponentës inflamatatore të miokardit.

Në dy të sëmurë me *angina pectoris* ne vumë re se ndryshimet e segmentit ST dhe të valës T, që u shkaktuan nga ndryshimi i pozicionit të trupit nga shtirë në atë ortostatik – pasqyrimi i veprimit adrenergjik – parandaloheshin me marjen e bb (fig. 3). Në këtë rast, ndikimi i favorshëm i bb, që shpjetohet gjilë këtu me veprimin e tyre blokues në betareceptorët, ngjan me atë që përfshohet te persona me ANC. Duke qënë se ky kriter diferençimi midis dy grupeve ka kufizimet e veta, ai duhet vlerësuar kurdoherë me kujdes.

Fig. 8




Fig. 8
Ndiqimi pozitiv i betablokuesit, që shpreshet në normalizimin e ndryshimeve të segmentit ST dhe të valës T, te kjo e sëmurë 25 vjetësare me hipertireozë, është i dukshëm.

Ne i përdorëm betablikueset edhe në 5 raste me sindromën Wolff-Parkinson-White si dhe në 3 të sëmurë me kardiomiatri, idiopatike, por në asnjë prej tyre nuk u përfwua rikthim i ndryshimeve të segmentit ST dhe të valës T pas marres së bb. Kjo flet në favor të konceptit të mësipërmë se bb ndikojnë në mënyrë të favorshme kryesisht gjegullimet e repolarizimit, që shfaqen si rrjedhim i veprimit adrenergjik.

Ky punim do të ishte më i përpiktë po të bëhej një koreacion me të dhënat e ikoronarografisë.

PËRFUNDIME:

Nga ky punim rezulton se përdorimi i bb për diferençimin e gjegullimeve të repolarizimit me natyrë funksionale nga ato organike, të shikaktuara nga sëmundja koronare e zemrës, vlen të provohet si një mënyrë e thjeshtë dhe praktike orientimi në këtë çështje.

Pavarësisht se, në tërësi, rezultatet tona në këtë drejtim duken të kënaqshme, shqyrtimi i rezultateve të përfwura me anën e kësaj prove duhet bërë me shumë kujdes dhe në mënyrë kritike, duke i bashkërenditur kurdoherë ato me të dhënat e tjera të ekzaminimit subjektiv, objektiv dhe laboratorik.

Dorëzuar në redaksi më 25 qershor 1978. —

B I B L I O G R A F I A

- 1) Boissier J., Giudicelli J.: Les bêta-bloquants, leurs variétés et leur action anti-arythmique. Në: «Pharmacologie clinique des troubles du rythme et de la contraction cardiaque», Paris, 1971, 171.
- 2) Friesinger G.: Objektive Beurteilung der angina pectoris. Das Medizinische Prisma, 1972, 3, 18.
- 3) Furberg C.: Adrenergic beta-blockade and electrocardiographical ST-T changes. Acta med. Scand. 1967, 21, 181.
- 4) Potak E.: Ein Beitrag zur Diagnostik der durch Betablockade Beeinflussten ST-T Veränderungen im Elektrokardiogramm. Z. Kardiol. 1974, 63, 818.
- 5) Somerville W., Taggart P., Carruthers M.: Cardiovascular responses to public speaking and their modification by oxprenolol. Në: Burley D. (red.) «New perspectives in betablockade». Denmark 1972, 275.
- 6) Taggart P., Carruthers M., Somerville W.: Intense emotional Stress: effect of oxprenolol on the electrocardiogram, plasma catecholamins and lipids. Në: Burley D. (red.): New perspectives in betablockade. Denmark 1972, 287.
- 7) Wiecko W., Szabelski R.: Blokada receptorow beta adrenergicznych rozpoznawaniu zmian zespolu ST-T elektrokardiogramm. Wiad. lek., 1974, 27, 1245.
- 8) Winchester J.: Drug profile: Trasitol. J. Int. Med. Res. 1974, 2, 448.

Summary**THE VALUE OF BETA-BLOCKERS IN THE DIFFERENTIATION OF THE ELECTROCARDIOGRAPHIC DISORDERS OF VENTRICULAR REPOLARIZATION**

The influence was studied of propanol and oxprenolol (trasicor) on the ST segments and T waves in 17 patients with angina pectoris and 3 with acute myocardial infarction (Group I), in 41 patients with symptoms of neurocirculatory asthenia or complaints not typical of angina pectoris (group II), in 5 cases with the Wolff-Parkinson-White syndrome (group III), in 3 patients with congestive myopathy (group IV) and in 2 cases with hyperthyroidism. In group II predominated the females (38) aged between 26 and 54.

ECG was performed in all the cases in the morning before meals, in recumbent position and 2 hour after administration of beta-blockers. On 23 patients (7 of group I and 16 of group II) it was also performed in upright position, on 16 patients (6 of group I and 10 of group II) the valsalva's maneuver was performed, and on 11 patients (6 of group I and 5 of group II) was performed the ECG exercise test (the two-step test).

In group I (20 cases) important detectable changes were observed only in regard to the frequency of the heartbeats, which was lowered, while the ST segment and the T wave remained unchanged in 15 cases and slightly altered in 2 cases.

In group II (41 cases) a pronounced reduction of the frequency was noted in all the cases. In addition, in 27 out of 29 cases with depressed ST segment, it returned to the normal level after administration of bb and in 30 out of 36 cases with altered T wave (depressed, levelled, bi-phasic or negative) it returned to normal.

In group III (5 cases) only in one case the altered ST segment returned to its base line.

In group IV bb had no effect on the altered ST segments and T waves. On the contrary, in two cases with hyperthyroidism the alterations of the T wave disappeared completely after administration of bb.

No particular difference of effect was noted between stobetin and trasicor on the ST segment and T wave in 41 patients with symptoms of neurocirculatory asthenia or with complaints not typical for angina pectoris.

This study shows that the use of bb for the differentiation of the disorders of repolarisation of a functional nature from those with organic changes due to a coronary heart disease deserve to be adopted as a simple way of assessment of these pathologic conditions.

Although in general the results obtained with this test appear satisfactory, their interpretation must be very careful and critical, by confronting them with the subjective, objective and laboratory findings.

Résumé**LA VALEUR DES BÉTA-BLOQUANTS DANS LA DIFFÉRENTIATION DES DESORDRES ELECTROCARDIOGRAPHIQUES DE LA REPOLARISATION VENTRICULAIRE**

Les auteurs ont étudié l'influence du propanol et de l'oxprenolol (trasicor) sur les segments ST et les ondes T chez 17 patients souffrant d'angine de poitrine et 3 autres d'infarctus du myocarde aigu (groupe I), chez 41 patients présentant des

symptômes d'asthénie neuro-circulation ou se plaignant de douleurs non typiques d'angine de poitrine (groupe II), chez cinq patients présentant le syndrome Wolff-Parkinson-White (groupe III), chez trois patients souffrant d'une myopathie congestive (groupe IV) et chez 2 patients présentant une hyperthyroïde. Dans le groupe II, on a relevé une prédominance du sexe féminin dont l'âge variait de 26 à 54 ans.

Dans tous les cas, l'ECG a été effectuée le matin avant le petit déjeuner, chez le sujet étendu et 2 heures après l'administration des bêta-bloquants. Chez 23 patients (7 du groupe I et 16 du groupe II), elle a été faite dans la position orthostatique; 16 patients (6 du groupe I et 10 du groupe II) ont subi l'épreuve de Valsalva et chez 11 autres (6 du groupe I et 5 du groupe II) a été effectuée l'ECG à charge (le test à deux échelons).

Dans le groupe I (20 patients) ont été observées des modifications importantes seulement dans la fréquence des battements du cœur, qui avait diminué, alors que le segment S-T et l'onde T ne présentaient pas des modifications chez 15 patients et quelques altérations chez 2 autres.

Dans le groupe II (41 cas) on a relevé une réduction marquée de la fréquence dans tous les cas. En plus, 27 patients sur un total de 29 présentaient un décalage au segment S-T, mais celui-ci retourna au niveau normal à la suite de l'administration des bb et 30 patients sur un total de 36 montraient une onde T altérée (abaisse, nivellée, biphasique ou négative) qui se normalisa.

Dans le groupe III (5 cas), on enregistra un seul cas de segment S-T altéré qui retourna à sa ligne de base.

Dans le groupe IV, les bb n'ont influé dans aucun cas sur les segments S-T et les ondes T altérés. Par contre, chez deux patients souffrant d'hyperthyroïdisme les altérations de l'onde T disparaissent complètement après l'administration des bb.

En ce qui concerne l'effet de la stobétidine et du trasicor, on n'a relevé aucune différence de relief quant à leur influence sur le segment S-T et l'onde T chez 41 patients présentant des symptômes d'asthénie neuro-circulation et des douleurs non typiques d'angine de poitrine.

Cette étude montre que l'emploi des bb pour la différenciation des troubles de repolarisation de nature fonctionnelle de celles organiques provoquées par le syndrome de Bland-White-Garland constitue une méthode simple et pratique qu'il convient d'adopter pour l'appréciation de ces conditions pathologiques.

Bien qu'en général les résultats obtenus par cette méthode semblent satisfaisants, leur interprétation doit être faite d'une manière très attentive et critique en les confrontant avec les résultats objectifs, subjectifs et de laboratoire.

ASPEKTI KRAHASUES DHE ECURIA NË SËMUNDJEN HIPERTONIKE

— NAMIK SHEHU —

(Spitali i rrështhit Berat)

Sëmundja hipertonike është një afekzion i përhapur i patologjisë njerëzore dhe përbën një problem të rëndësishëm për mjekësinë e sotme (1). Ajo ze një shpeshtësi përkrahësht të lartë nga 3,4% deri 20% (6, 9, 10, 17) të patologjisë së të rriturave dbe një sëmundshmëri 42% midis sëmundjeve të sistemit kardiovaskular (15). Kjo sëmundje prek mosnë e pjekurisë deri në 92% (cituar nga 8) dhe është një sëmundje kronike me ecuri në pëparim, shoqërohet me pasojë të renda, ka invaliditet të shpreshur nga 40%-43% të të sëmureve të sistemit kardiovaskular (8, 12, 14, 16) dhe bëhet shkak i një vdekshmërie të lartë deri në 30% të vdekshmërisë përgjithshme (cituar nga 3).

Nga pikëpamja klinike, sëmundja hipertonike paragjet vështirësi studimi dhe ndjekje si në drejtimin e përcaktimit të stadeve të sëmundjes, të vlerësimit të shifrave të presionit të gjakut të parë në dinamikë, të ndikimit në organet e brendshme si dhe të ecurisë të vetë sëmundjes.

Për këtë arsyë në këtë punim ne kemi bërë një studim krahasues të kritereve të stadeve të sëmundjes dhe të ecurisë së sajë, të parë në periudha të ndryshme.

Mетодика и приемы

Në këtë punim në studim janë marrë 285 të sëmure të sëmundje hipertonike gjatë një periudhe 7 vjeçare per vitet 1971-1977, të ndiekur në dinamikë, të ndarë në tre periudha të ndryshme me ndërpërje kohe 1-2 vjeçare. Për periudhën e parë u studjuan 105 të sëmure, për të dytën 95 dhe për të tretën 85. Për vlerësimin e studimit dhe për krahasim janë marrë si bazë katër kriterë kryesore (6): shifrat e presionit të gjakut sistolik dhe diastolik, ndryshimet elektrokardiografike dhe radiodiagnostike (për të vënë në pah hipertrofinë e ventrikulit të majtë) si dhe ndryshimet e konstatuara në fundin e syrit.

Të gjithë të sëmurët kanë kartela personale dhe janë të pajisur me të gjitha analizat plotësuese të nevojsme. Mesatarisht çdo i sëmure ka kaiuar në kontroll mjekësor 2-3 herë në vit, përuke u trajtuar me terapi përkatëse.

Hipertrofinë e ventrikulit të majtë elektrokardiografikshët e kemi bazuar në kriteret e voltažhit (3, 6). Si bazë është marrë indeksi Sokolow-Lyon dhe R^s R^d . Në percaktimin e ndryshimeve në fundin e syrit kemi pranuar ndarjen në 5 stade (3).

Në këtë punim do të përgjigjeni të shfaqim mendime mbi nxjerje e kritereve në përcaktimin e stadeve të sëmundjes hipertoneke si dhe t'vemi në dukje ecurinë e sëmundjes, t'ë parë këto në aspektin krahasue me t'ë katër kriteret e përmëndura.

I. – Për t'ë vlerësuar nxjerjen e kritereve në përcaktimin e stadeve të sëmundjes hipertoneke janë studjuar 137 të sémurë të stadeve të ndryshmë. Në stadin e parë u muarën 27 të sémurë, në të dytin 75, në të tretin 34 dhe në stadin e katërtë një i sémure. Rezultatet e ketij punimi jan paraqitur në pasqyrat nr. 1, 2 e 3. Për stadin e parë të sëmundjes vihet në dukje ndryshime në fundin e syrit të llojit të stadtit të parë në 74.3%. Në vlerësimin e presionit të gjakut kanë përparesi për maksimalin shifre nën 200 mmHg 59.2% dhe për minimalin mbi 101 mmHg në 92.5%. Për stadin e dytë u pane: hipertrofi e ventrikulit të majtë (H V S) në E K C 92%, H V S në radioskopji 77.3%; ndryshime në sy 97.3%. Në presionir e gjakut kanë përparesi për minimalin shifrat mbi 101 mmHg në 97.4%. Për stadin e tretë të sëmundjes u konstatua HVS në E K G në 94.1%. HVS në radioskopji 100%, ndryshime në fundin e syve 100% dhe dëmtimi në përparesi të sëmundjes koronare të zemrës në 100% të rasteve. Në stadin e katërtë ose forma malinje, ishin të pranishëm H V S në E K G dhe në radioskopji, stadi i katërtë në fundin e syrit dhe sëmundje koronare e zemrës me insuficiencë të ventrikulit të majtë.

II. – Në studimin tonë, ecuria e sëmundjes hipertoneke është bazuar dhe krahasuar në vlerësimin e rezultateve të ndara në tre periudha të mbështetura në katër kriteret e përmëndura.

Në periudhën e parë të studimit kanë qenë për stadin e parë t'ë sëmundjes 25.8% të rasteve, për stadin e dytë 71.5% dhe për stadin e tretë 2.7%. Në periudhën e dytë kanë mbetur në stadin e parë 3.2%, në stadin e dytë 67.3% dhe në stadin e tretë u arrit në 29.5% të rasteve. Në periudhën e tretë u konstatuan për stadin e parë 2.4%, për stadin e dytë 56.5%, për stadin e tretë 40% dhe për stadin e katërtë 1.1% (pasqyra nr. 2).

Si konstatime të përgjithshme mund të përmëndim këto të dhëna për secilin stadin për t'ë tre periudhat:

Për stadin e parë të periudhës së parë vihen në dukje ndryshime në fundin e syve të stadtit të parë në 74.3%, me mbizotërim të vlerave të shifrave të presionit të gjakut për maksimalen nën 200 mmHg, për minimalen mbi 101 mmHg. Për t'ë dy periudhat e tjera, të dhënat nuk paraqesin interes komentonimi. Për stadin e dytë të periudhës së parë H V S në E K G u konstatua 92%, në periudhën e dytë 84.4% dhe në periudhën e tretë 91.7%. H V S në radioskopji në periudhën e parë 77.3% në të dytën 89.1% dhe në të tretën 95.9%. Ndryshimet në sy në periudhën e parë kanë qenë 97.3%, në periudhën e dytë 100% dhe në periudhën e tretë 100%. Shifrat e presionit të gjakut për maksimalin në periudhën e parë kanë vlera të barabaria si nën dhe mbi 200 mmHg. Në periudhën e dytë kanë përparesi shifrat mbi 200 mmHg në 60.9%, kurse në periudhën e tretë këto arrijnë në 62.6%. Për minimalin, shifrat mbi 101 kanë përparesi për periudhën e parë në 97.4%, për t'ë dytën 90.5% dhe për t'ë tretën 87.4%. Për stadin e tretë të periudhës së parë janë të dhëna të pakta për t'ë interpretuar. Në periudhën e dytë, H V S në E K G është 100%, në radioskopji është 100% dhe ndryshimet në fundin e syrit janë 100% dhe prania e dëmtimit me përparesi të sëmundjes koronare

të zemrës është në 100% të rasteve. Në periudhën e tretë, H V S në E K G u vu re në 94.1%. H V S në radioskopinë në 100%, ndryshimet në fundin e syrit në 100% dhe pranina e dëmtimit me pëparësi të sëmundjes koronare të zemrës në 100%. Stadi i katërtë i sëmundjes u paraqit vetëm në periudhën e tretë me praninë e H V S në E K G dhe në radioskopinë, të stadtit të katërtë, në fundin e syrit dhe me sëmundje koronare të zemrës dhe insuficencë të ventrikulit të majtë.

III. — Raporti që zenë tri kriteret e marrura në studim në përpunim me njëra tjeterën, në vartësi nga stadtet e sëmundjes është paraqitur në pasqyren nr. 3. Duke i referuar këtyre të dhënave del se në stadin e dytë ka pëparësi kombinimi i H V S-në E K G dhe në radioskopinë, në stadin e dytë, në fundin e syrit në 54.6% dbe H V S-në E K G dhe stadi i dytë, në fundin e syrit në 22.7%, dmth H V S në stadin e tretë mbizotëron kombinët në fundin e syrit zenë 81.3%. Në stadin e tretë mbizotëron kombinimi i katër indekseve si i H V S-në E K G dhe në radioskopinë, stadi i tretë në fundin e syrit dbe sëmundja koronare e zemrës në 58.8%, ndërtretë në fundin e syrit dbe sëmundja koronare e zemrës në 35.3%, dmth H V S me lezon sa në stadin e dytë në fundin e syrit zenë 35.3%, dmth H V S me lezon sa në stadin e dytë në fundin e syrit zenë 94.1%.

KOMENTIMI I RASTEVË

Stadet dhe rëndimi i sëmundjes hipertonike nuk përcaktohen vetëm nga vlerat e shifrave të presionit të gjakut, por kryesisht nga shkalla e shritrës së dëmtimeve vaskulare dhe nga dëmtimi i organit dhe i sistemeve. Për këtë arsy, me qëllim që të kemi perfundimë sa më të përpikta duhet të merrin në studim për interpretim të përcaktimin e stadeve dhetë rëndimit të sëmundjes të katër kriteret e gërshtëwara së bashku.

Në stadin e parë të sëmundjes, vlerat e hipertensionit arterial, sidomos të minimalit në shifrat mbi 101 mmHg, nuk mund të qëndrojnë indiferentë ndaj sistemit vaskular, megjithëse këto kanë karakter funksional dhe gjelje shprehjen e tyre kryesish në ndryshimet në fundin e syrit të karakterit angjipatik, ndonjëherë edhe me ndryshime angjiosklerotike dhe madje retinopatike me prirje rikthyese, sikunder përshtatjet dhe nga disa autorë (2, 5) dhe siç del nga rastet tona (shih pasqyren nr. 2).

Dukuria e ndryshimeve në fundin e syrit të stadtit të parë është më rrallë të stadtit të dytë dhe të tretë në të sëmurët, tanë si dhe thellimi i ndryshimeve të mënjëshën në sy dhe në zemër dhe kalimi i shumicës së këtyre sëmuriëve në stadin e dytë dhe të tretë duhet t'i shpjegojmë më praninë e pëparësise së vlerave të presionit të gjakut minimal mbi shifrat 101 mmHg, pas një ndikimi të një periudhe kohë përkrahësht të gjatë, pa përiashtruar ndikimin e faktorit moshë, që është marrë në konsideratë edhe për stadtet dhe periudhat e tjera. Në stadin e dytë të sëmundjes, si regull, kishte ndikime në organet e ndryshme të organizmit sidomos në zemër dhe në sy, që viheshin në dukje nëpërmjet ekzaminimeve. Nga të dhënat e studimit tonë del se në këtë stadi, si dha në ecurinë e këtij stadi, në të tre periudhat e tij zotërojnë vlerat e larta të presionit të gjakut minimal mbi shifrat 101 mmHg për një kohë përkrahësht të gjatë dhe vazhdueshme si dhe H V S-në E K G dhe në radioskopinë dhe ndryshimet në fundin e syrit të stadtit të dytë. Duket mirë ekzistencë e një paralelizmi në avancin midis këtyre katër kritereve, duke sjellë si pasojë rëndimin e gjendjes së sëmundjes. Gjetja e ndryshimeve të stadtit të tretë

në fundin e syrit nuk përbën domosdoshmëri për të vënë sëmundjen hipertonike në stadin e tretë në se nuk shoqërohet edhe me dëmiimet e organit, ashtu siç nuk është thënë që në stadin e syve të sëmundjes të kemi pa tjetër ndryshime në fundin e syve të stadtit të dytë për të vlerësuar sëmundjen në këtë stad (2, cituar nga 4) (shih pasqyrën nr. 2). Duke u nisur nga këto rezultate mendohet se në përcaktimin e stadtit të dytë (tek një i sëmurrë me hipertoni) ti jepet rëndësi vlerësimt të paktën të dy kritereve, ndryshimeve në EKG me evidencim të HVS dhe të ndryshimeve në fundin e syrit të tipit angjiosklerotik, me përparsëi në EKG.

Ka autorë që venë në dukje se në stadin e tretë të sëmundjes mund të mos gjiejmë HV S në EKG (10), ose ndryshime të fundit të syrit të karakterit retinopati (cituar nga 4) (shih pasqyrën nr. 2). Gjetja e ndryshimeve në retinë paraqitet si patologji, që sugeron rolin e rëndësishëm që luan hipertensioni si shkak i saj pavarësish nga mosha (2). Në stadin e tretë të sëmundjes takohen ndryshime të dukshme në organ, të cilat shprehën në formë dëmtimi si në zemër me sëmundje koronare të zemrës, insufisience e ventrikult të majtë etj., në tru me insultë, në sy e tij vhatet në dukje më së miri krahasimi dhe qënia e një paralelizmi të drejtë midis të katër kritereve ku ekspozohet një theksim dhe përgjakut minimal në një periuadhë kohe të gjatë dhe të vazhdueshme, pa përashtuar dhe ndikimin e moshës. Në bazë të këtyre rezultateve mund hipertonike duhet të mbështetemi të paktën në tre kriteret kryesore, (në HVS të vënë në dukje në EKG dhe ose HVS në radioskop), në ndryshimet e fundit të syrit të stadtit të tretë dhe konstatimit të dëmtimit në një organ, që në rastin tonë ka përparsëi sëmundja koronare e zemrës.

P E R F U N D I M E

1) Në vlerësimin e sëmundjes hipertone duhet të mbështetemi në katër kriteret kryesore, të marrura në kompleks me njëri tjetrin.
2) Në përcaktimin e stadeve të sëmundjes hipertone, ne përfundojne:

- Në stadin e parë konstatohen ndryshime të stadtit të parë në fundin e syrit, që në punimin tonë zenë 74.3%.
- Fër vlerësimin e stadtit të dytë duhet, të kemi të pranishëm të paktën dy kriterë, HVS në EKG (në rastin tonë 92%) (dhe/ose HVS në radioskop) si tek ne në 95.9%) dhe ndryshimet në sy të stadtit të dytë ose të tretë nga 97.3% – 100%, me përparsëi të ndryshimeve në EKG.
- Në përcaktimin e stadtit të tretë, si rrugoll, duhet të jenë të pranishëm të paktën tre kriterë kryesore. Evidentimi i HVS në EKG, që tek ne u takua në 94.1% – 100% (dhe/ose HVS në radioskop) tek ne 100%), ndryshimet në fundin e syrit të stadtit të tretë ose të dytë, që tek ne u takua në 100% dhe dëmtimi i një organi, që në studimin tonë ka përparesi sëmundja koronare, që u takua në 94.2% dhe insulta cerebrale dhe dëmtimi në sy në 5.8%.

- 3) Nga studimi ynë del se sëmundja hipertoniike ka ecuri, që përparron dhe ka zhvillim përkrahësish të shpejtë, që shprehet me evolucionin e stadeve nga 25.8% të stadiit të parë, mbiqet në 2.7% në periudhën e tretë të po këtij stadi, kurse nga 2.4% e stadiit të tretë në periudhën e parë arrihet në 40% të stadiit të tretë në periudhën e trefë.
- 4) Të sëmuarët me sëmundje hipertoniike duhet të bëjnë kontolle të shpeshta mjekesore. Të vazhdojnë mjekumin në mënyrë sistematike dhe pandërprerje në vartësi nga gjendja e sëmundjes me porosi nga mijaku.

Dorëzuar në Redaksi më 5 prill 1978

B I B L I O G R A F I A

- 1) Hoxha F., Rusi H.: Aspekte klinike të sëmundjes hipertoniike. Buletini i UT – Seria shkencat mjekësore, 1976, 1, 9.
- 2) Hofman O., Komancova E., Kohai M. e coll.: Significance of the differences in the prevalence of certain ophthalmoscopic findings between normotensive and hypertensive subjects. Acta Universitatis Carolinae, 1973, Vol. 19, nr. 7/8, 635.
- 3) Fronten A., Fronten R.: L'hypertension artérielle permanente: données statistiques, évolution, complications et prognostic. Revue du praticien 1969, 207, 27.
- 4) Friedberg CH.: Diseases of the heart, 1966, 1475.
- 5) Mjasnikov A. LI.: Gjipertonicskaja boljez i ateroskleros. Medicina 1965.
- 6) O B SH.: Hypertension arterielle et cardiopathies ischémiques. Organisation mondiale de la santé – série de rapports techniques. Genève 1962, 231, 3.
- 7) O B SH: Prévenir et traiter les maladies cardio-vasculaires – 2 –, 1974, Vol. 28, 129.
- 8) Pickering G.: Essential hypertension clinical Features. High blood pressure 1968, 316.
- 9) Rusi H.: Të dhëna mbi hipertoniqe arteriale të punëtorëve, në disa qendra pune të mëtihet të Tiranës. Shëndetësia popullore 1975, 1, 67.
- 10) Rusi H., Selimaj E., Islami V.: Aspekte klinike elektrokardiografiqe të komplikacioneve kardiovaskulare në hipertoniqe esenciale. Punime mbi sëmundjet e brendshme, 1976, 1, 5.
- 11) Rusi H.: Gjendja e hipertensionit arterial në punëtorët e kombinatit të teksteve «Stalin». Shëndetësia popullore 1974, 1, 24.
- 12) Rusi H., Hasani R., Kacani T.: Të dhëna mbi afësine për punë dhe progoza në 341 invalidë me hipertension arterial. Punime mbi sëmundjet e brendshme, 1976, 1, 61.
- 13) Shehu N.: Vlerat normale të presionit arterial në 10.000 raste të depisuar në mëthimin e hipertensionit arterial në 1976, 2, 39.
- 14) Shehu N.: Boli i hipertensionit arterial në invaliditet dhe kriteret e përcaktimit të tij. Referuar në konferencën e parë mjekësore në mëthimin e Beratit. (Material i pa botuar).
- 15) Shehu N.: Sëmundshmëria e hipertensionit arterial në mëthimin e Beratit. Referuar në simpoziumin e V në mëthimin e Beratit – 1976 (material i pa botuar).
- 16) Vesho P.: Sëmundje, e zemrës, eksperimentale të drejtimit së përgjithshme të sigurimeve shqërore. Tiranë 1972 (material i pa botuar).
- 17) Wilber J. A., Barrow J.G.: Hypertension A Community problem. Hypertension Manual. J.H. Laragh. New York 1974, 711.

A COMPARATIVE STUDY OF THE STAGES OF THE HYPERTENSIVE DISEASE


Summary

A series of 285 patients with hypertension was studied over a period of seven years (1971-1977). The course of the illness and the criteria serving for dividing it into three stages of 1-2 years each were taken into consideration.

The first stage is characterized by changes in fundus oculi which occurred in 74.3% of the cases.

In the second stage, apart from the changes in fundus oculi, which the author has observed in 97% of the cases, VHS on ECG was characteristic. VHS on ECG was found in 92% and VHS on radioscopi was found in 95.9% of the cases.

For the third stage are characteristic three criteria: VHS on ECG (observed in 94.1 to 100%), changes in fundus oculi (in 100%), and changes on the organ (coronary lesions of the heart, found in 100% of the cases).



Résumé

ÉTUDE COMPARATIVE DES DIFFÉRENTES PHASES DE LA MALADIE DE L'HYPERTENSION


Une série de 285 patients souffrant d'hypertension a été examinée pendant une période de sept ans (1971-1977). C'est à cette fin qu'ont été pris en considération le décours de la maladie et les critères qui ont servi à sa répartition en trois phases de 1 à 2 ans.

La première phase est caractérisée par des modifications concernant le fundus oculi (74,3% des cas).

La seconde phase, à part les modifications du fundus oculi que l'auteur a relevées dans 97% des cas, se caractérise par le VHS dans l'ECG. Le VHS dans l'ECG a été relevé dans 92% des cas et dans la radioscopie dans 95,9% des cas.


En ce qui concerne la troisième phase, elle se caractérise par les trois critères suivants: le VHS dans l'ECG (de 94,1 à 100%), les modifications du fundus oculi (dans 100% des cas) et les modifications de l'organe concerné (lésions coronaires du cœur observées dans 100% des cas).

**KONSTATIMI I KARITEREVE SIMBAS SHADEVE
DNE PERIODUAVE NE SEMUNDJEN HIPERTONIKE.**



Tab. N° 2

Kombinir. Kriterie.
Simbas Stadeve
Hab. 3
Semundien Riperonile.



NDRYSHIMET RADIOLOGJIKE NË ARTRITIN REUMATOID

— KOÇO PORO, VANGJEL ANGJELI, KRISTAQ MORKA —

(Klinika e II e Sëmundjeve të brendshme)

Të dhënrat radiologjike gjatë artritit reumatoïd (A R) kanë një vlerë të rëndësishme në kriteret e diagnozës si dhe për të përcaktuar stadin dhe shkundjen e dëmtimeve që ka shkaktuar sëmundja.

Ndryshimet radiologjike në artritin reumatoïd hasen në të gjitha kyçet, por më shpesh gjenden në ato të duarve, si në kyjet metakarpofalanqeale, në interfalangjeale proksimale të duarve dhe të këmbëve, në karpot, radiokarpet, në kyjet e gjunjëve, bërryllit, temporo-mandibularin, talokruralin, koksofemoralin etj. Në shtrillën kurizore preket kryesisht pjesa cervikale, ndërsa sakroileti është i rrallë, me përjashtim të formës juvenile. Ndryshimet radiologjike të A R varen jo vetëm nga stadi i është forma e sëmundjes, por dhe nga lloji i kygit të prekur nga kjo sëmundje. Kështu në kyjet e duarve vërehen më shpesh: 1) osteoporose e epifizave artikulare, në vecanti në kyjet metakarpofalangjeale dhe interfalangjeale proksimale është shenjë e hershme e ndryshimeve radiologjike (fig. 1).

2) Gërryerjet kockore, erozionet subkondrale (fig. 2). Gërryerjet kockore të kyçeve të dorës ndahen në katër forma (1): a) gërryerje marginale; b) gërryerje apo erozione shtypëse. Këto gërryerje duken si copeza kocke të shkëputura nga ana e artikulacionit (si të kafshuarat e minut); c) geodet janë rezorbime apo thithje kockore të lokalizuara me përmasa të vogla, me kufi të paqartë; d) pseudokistet shfaqen si erozione marginale dhe nuk kanë lëshje me buzën artikulare. Ato duken si zbrzesira kockore, të rrethuara nga një reaksion i lehtë osteoskleroze.

3) Ngushtimi i hapësirës artikulare. Kjo i detyrohet shkatërrimit të kartilagos artikulare.

4) Dëmtime të vonëshme, por karakteristike, janë shmanget në drejtim ulnar. Kjo u detyrohet dëzaksimëve.

5) Shmangje boshlore të ndryshme. Gishtat marrin formën e qafës së mjelmës, të çekçit etj.

6) Liza e karpeve. Kjo ndodh kur dëmtimet e karpeve janë të thella. Kockat karpale duken si të shkrira. Hapësira artikulare ngushtohet shumë (fig. 3, 4).

7) Reakkioni periostal takohet në mjaft raste qysh në stadet e herësme krahas osteoporozës, vëganërisht, në artikulacionet interfalangjeale proksimale.

8) Ankiloza kockore është e rrallë, por mund të vërehet sidomos në artikulacionin interdigital proksimal.




Foto 1

Osteoporozë në formë shiritit




Foto 2

Erosione subkondrale



Foto 3

Geode të karpeve



Foto 4

Lizë e kockave të karpeve



Foto 5

Gërryerje anësore të tibias

Dëmtimet e këmbës janë të ngjashme me ato të dorës. Në gjunjë, ndryshimi i parë dhe që nuk mungon pothuajse kurri është osteoporozë periartrikulare. Mjaft herë ka theksim të indeve të buta dhe zgjerim të hapësirës artikulare (kur ka likujt). Shenja kryesore e artritit reumatoïd në gjurin është ngushtimi i hapësirës artikulare. Kjo bëhet në tre pëmasat mediale, laterale dhe retropatelare, (ngushtim i hapësirës dhe osteoporozat shfaqet më tepër në planin median). Erozionet subkondrale janë më të rralla, por mund të gjenden në pjesët marginale anash në pjesën e brendshme të tibias (fig. 5). Këto shenja ne i kemi hasur edhe në stadiet e herëshme (4).

Në artikulacionet kolksofemorale, ndryshimet e A.R cilësohen nga një ngushtim i njëtrajtshëm i hapësirës artikulare (3). Ndryshimet e artikulacionit sakroiliak janë të rralla më tepër të njëanëshme dhe vërehen më shpesh në artritin reumatoid juvenil.

Për të parë lidhjet e dëmtimeve artikulare dhe të dhënët radiologjike në të sëmurët tanë, kemi marrë në studim 100 raste me 279 artikulacione të flëmtuara dhe të radiografuara. Nga të 100 rastet, 70 kanë qenë femra, dhe 30 meshkuj. Zgjedhja e të sëmurëve është bërë e rastësishme dhe u takojnë këyre moshave: 15-25 vjeçare -30 raste, 26-35 vjeçare -5 raste, 36-45 vjeçare -24 raste dhe mbi 46 vjeç -41 raste. Radiografia e artikulacioneve për të 100 rastet kanë qënë: 80 karpe, 81 falange të dorës, 50 gjuri, 15 koksfemural, 16 talokrurali, 16 të këmbëve tarso-metatarsel, 8 të bërryllt, 3 skapulohumerale dhe 10 sakroiliaket.

Nga të 279 të marrura në studim, kemi hasur më tepër këto dëmtime: osteoporosis -254, reakSION periodal -97, ngushtim hapësire-189, geode -209, kiste kockore -114, gërryerje subkondrale -75, gërryerje anësore -78, dezzaksim -36, anklozë -51, liz e karpeve -21 dhe thëksim të ndeve -16. Nga kjo duket qartë se osteoporoza, geodet, dhe ngushtimi i hapsirës artikulare janë ndryshimet më të shpeshta, që shoqërojnë artritin reumatol dëmtim të gjithë securinë e tij. Osteoporozën e kemi hasur pothuaj në shumicën dërmuese të rasteve, më pak në koksofemoralët dhe bërrylet. Gërryerjet shpejtë artikulacionet e dorës në kockore (kistet apo godet) u gjelten më tepër në artikulacionet e talokrurale, shumicën dërmuese të rasteve, më pak në koksofemoralët dhe bërrylet. Gërryerjet ndërsa në gjunjët vjetëm gërryerje anësore. Reaksiioni periodal u gjend ndërsa më tepër në interdigitalet proksimalë dhe më pak në koksofemoralët. Dëzaksimet ishin kryesisht në kyget e duarve dhe të këmbëve, shumë pak mbi gjunjët dhe koksofemoralët.

Në studimin e lindhjes ndërmjet moshave të të sëmurëve dhe dëmtimeve radiologjike të dhënënat rezultojnë sig tregohet në pasqyrën nr. 1.

Sig duket nga kjo pasqyrë, dëmtimet radiologjike më të shumta dhen më të thella kane qenë në dy grup-moshat 15 deri 25 dhe 46 vjeçarë e lart. Nga këto të dhëna mund të konkludojmë se kur artriti reumatoïd fillojnë moshat e reja (forma juvenile), dëmtimet e kygeve bëhen më shpejt dhe janë të shprehura. Vënia në dukje e dëmtimeve në moshat mbi 46 vjeç do të thotë se në AR e të rriturit, dëmtimet bëhen mëngajdale dhe themelli i tyre kërkon disa vjet apo dekada. Vjetësh. Sigurisht që në këto të dhëna ndikon dhe numri i lartë i të sëmurëve në këto moshë, por jo kryesisht. Lindja e dëmtimeve të kygeve sipas sekave na ka rezultuar sic shihet në pasqyrën nr. 2, se në gratë mbizotërojnë dëmtimet më të shumta dhe më të renda. Këto të dhëna tejkalojnë ndikimin që ka shumica e rastive të marrura në gra. Kështu në rastet të marrura në studim nga ana e jone, sic përmëndën më sipër, ishin 30 burra dhe 70 gra, pra afersisht 1:2,5. Por po të marrim psh lizën e kockave karpale, ishin vetëm dy në burra dhe 15 në gra. Pra afersisht 1 në 7. Apo kistet 17 në burrat dhe 55 në gratë, më tepër se 1/3 gërryerjet anësore, 9 me 40 në gratë, pra afersisht 1 në 4,5. Të dhëna interesante kemi marrë në 40 lindje me dëmtimet radiologjike të AR dhe moshë e sëmundjes (shih pasqyra nr. 3).

Kjo pasqyrë ve në dukje se dëmtimet më të shumta janë në të sëmurët me stazh sëmundje 4 deri 7 vjet. Me kalimin e vjetëve, proceset destruktive zhduken dhe fillojnë rigjenerimi i artikulacionit apo mbishthonhen proceset e artrozes dhe këshlu në të sëmurrët me stazh sëmundje mbi 13 vjeç ka vetëm 8 raste me osteoporozë, njërsa në moshat e sëmundjes 4 deri 7 vjet ka 30 osteoporoza dhe 22 dëzaksim, që nuk justifikohen me incidentëm më të madhe të kësaj sëmundje në të sëmurrë me 4 deri 7 vjet ecuri.

Si përfundim, nga të dhënët tonë, paraprakisht mund të mendojmë se: 1) në vija të përgjithshme, ndryshimet radiologjike janë më të shprehura në gratë sesa në burrat.

2) Dëmtimet e kyçeve zhvillohet më shpejt dhe janë më të thella në artritet reumatoïde, që fillojnë në moshat e reja 15 deri 25 vjeçare.

3) Artriti reumatoid dëmton më tepër kyçet e karpeve, falangeve, gjurit, talokruralit, gishtave të këmbëve, koksifemoralit dhe pastaj kyçet e tjera.

4) Sipas stazhit të sëmundjes, dëmtimet më të shumta dhe më të shella janë rëndësishme, dëmton më tepër kyçet e karpeve, falangeve, gjurit, talokruralit, gishtave të këmbëve, koksifemoralit dhe pastaj kyçet e tjera.

BIBLIOGRAFIA

- 1) Boyle A : Clinical rheumatology. Edimburg 1971, 235.
 - 2) Greenfield G : Radiology of bone diseases. Philadelphia 1975.
 - 3) Murray R. : The radiology of skeletal disorders. London 1971.
 - 4) Poro K., Adhami I. : Reumatologia Praktische radiologie und

PASCOE 11

Shpeshtësia e dëmtimeve radiologjike në grup-moshat e pacientëve

	Ngushium hapsestre	Geode	kiste	gerryterje subbkon- diale	gerryterje anæsore	Deza- ksim	tankloz	liz e kar- peve	Shunia
15-25 vj	25	26	22	18	14	15	10	4	134
26-35	4	4	3	1	1	2	1	1	17
36-45	20	21	15	10	12	9	4	4	97
46 e lært	39	40	32	24	22	24	15	8	204
Shunia	88	91	72	53	49	50	32	17	

Siposhtësia e ndrvshime e radiologjike sines sekuji

Pasq'ya III, 2

Ngusutim hapesire	Geode	Kiste	Géryerie subkond- rale	Géryerie anésoire	Dezaksimé	Liz e kar- peve	Shuma
----------------------	-------	-------	------------------------------	----------------------	-----------	--------------------	-------

Dorëzuar në redaksi më 20 gershor 1978

Dëntimet radiologjike sipas kohës së fillimit të sëmundjes

Osteoporosis	Reaksioni periodontal	Nigushitum hapsejë	Geode	Kiste	Gërryerje Subkondrale	Gërryerje anësore	Dezaksim	Shuma
7-12 muaj	7	5	7	7	4	5	4	44
1-3 vjet	17	10	18	17	11	7	6	93
4-7 vjet	30	22	27	29	21	17	14	182
nbi 13 vjet	8	6	9	11	10	6	4	60

Summary

RADIOLOGICAL CHANGES IN RHEUMATOID ARTHRITIS

The value is assessed of the radiological findings for the diagnosis of rheumatoid arthritis and the prognosis of its evolution. The study of 100 cases of rheumatoid arthritis allows to draw the following conclusions:

- 1) Among patients of equal age and ancientness of the illness the radiological changes are more pronounced in females than in males.
2. The radiological changes in the articulations begin earlier and are more pronounced in the cases when rheumatoid arthritis appears at an early age, between 15 and 25 years.
3. Rheumatoid arthritis attacks more frequently the articulations of the carpus, the phalanges, the knees, the talocruralis and coxo-femoralis joints than the others.
4. The lesions are more pronounced and more numerous in the cases when the illness has been in course for over 4-7 years.

Résumé

MODIFICATIONS RADIOLOGIQUES DANS LES ARTHRITES RHUMATOÏDE

Les auteurs de cet article mettent en relief l'importance des données radiologiques dans le diagnostic de l'arthrite rhumatoïde et la prognose de l'évolution de celle-ci. Après avoir examiné 100 cas d'arthrite rhumatoïde, ils aboutissent aux conclusions suivantes:

- 1) Parmi les patients de même âge et avec la même durée de la maladie identique, les modifications radiologiques sont plus marquées chez les femmes que chez les hommes.
- 2) Les modifications radiologiques concernant les articulations se manifestent plus tôt et sont plus prononcées dans les cas où l'arthrite rhumatoïde apparaît pendant la jeunesse, entre les 15 et 25 ans.
- 3) L'arthrite rhumatoïde attaque plus fréquemment les articulations de la poignet, des phalanges, des genoux et des jointures talocruralis et coxo-femoralis que les autres articulations.
- 4) Les lésions sont plus prononcées et plus nombreuses dans les cas où la maladie existe depuis 4-7 ans.

PËRDORIMI I APLIKATOREËVE RADIOAKTIVË ME FOSFOR – 32 PER MJEKIMIN E DISA SËMUNDJEVE TË LËKUREËS

– SKYQRI BASHA – SKËNDER MALJA –

(Poliklinika Qëndrore – Tiranë, Institut i fizikës Bërthamore – Tiranë)

Përdorimi i rrezatimit beta për shërimin e shumë sëmundjeve të lëkurës, syve etj. sot është pranuar si metodë shumë e suksesshme dhe përdoret në shkallë të gjëre në shumë klinika.

Përdorimi i rrezatimit për qëllime kurimi, ose, siç thuhet në praktikë, beta-terapia kryhet në dy mënyra: nëpermjet përdorimit të rrezatimit brenda organizmit, duke futur izotopët radioaktivë në organizëm ose nga jashtë. Per rastin e dyte është e nevojshme të përgatiten burime radioaktive ose aparate të vecantë, që prodhojnë rrezatim beta këto të vithen në kontakt nga jashtë me pjesën e dëmtuar ose ta rrezatojmë atë në distancë.

Beta-terapia ka epërsi ndaj gama-terapisë në rastet kur kërkohet që rrezatimi i vatrës të bëhet nga jashtë dhe kur vatra është në spërfaqe sepe, në raste të tillë, është e mundur të rrezatohet vetëm vatra e sëmurë dhe të ruhen nga rrezatimi qelizat e shëndosha. Gjithashu për shkak të thellisë përkrahështë të vogël të depërtimit, indet e shëndoshë, që ndodhen nën vatrën e sëmurë, praktikisht nuk rrezatohen. Në pasqyren nr. 1 jepet doza që krijon në thelli të ndryshme burimi rrezatues me P-32, që përdoret gjërësisht dhe që prej vitesh ka gjetur zbatim në vendin tonë.

Pasqyra nr. 1

Thelesia e depertimit m/m	0	0.50	1.0	2.0	3.0	4.0	5.0
Doza që krijon në krahasin me si-përfaqen %	100	—	28	11.4	4.6	1.9	0.9

Përdorimi i rrezatimit beta për qëllime terapeutike bazohet në aftësinë e bashkëveprimit të rrezatimit me elementët e molekulave, që përbëjnë indet e gjalla. Në themel të këtij bashkëveprimi qëndron transmetimi i energjisë së grimcave në molekulat e atomet e mijësuar në të cilin ato depërtojnë. Rruja që përshtojnë grimcat beta është proporcionale me energjinë e tyre.

Mekanizmi i bashkëveprimit të grimcave beta me substancën (qelzë) shpjegohet me teorinë e «përplasieve joelastike». Si rezultat i këtij bashkëveprimi formohen jone, molekula e atome të eksituar, të cilat në krahasim me atomet e molekulat normale, kanë trupice energjë. Energjia e tepertë (e jonizimit dhe e eksitimt të molekulës) mund të kaloje në energji termike (skuet objekti që rezatohet), në energji rezatimi, që lëshonet nga molekulat e eksituara (luminisencë) dhe në energji të reaksioneve kimike, si rezultat i të cilëve formohen të ashtu ionizues, janë mjaft të ndodhin në qelizë, nën veprimin e rezatimit gjëra qeliza ka përbajtje të lartë uji, shpjegimet e sotme lidhen me radiolizën e ujit (6).

Veprimin e tij, rezatimi ionizues e shfaq si rezultat i bashkëveprimit të drejtëpërdrejtë osse të tërthortë. Në rastin e parë, ndryshimet në molekulë ndodhin për shkak të veprimit të drejtëpërdrejtë të rezatimit ionizues, ndërsa në rastin e dytë, si rezultat i manjës së energjisë nga një grimcë e dytë. Në objektet biologjikë, efekti i rezatimit lidhet me veprimin të tërthortë të tij, që kryhet nëpërmjet radikaleve të ndryshëm të radiolizës se ujit.

Si rezultat i veprimit të rezatimit në indet e gjalla mund të ndoprishja e një ose disa funksioneve të qelizës (p.sh. mungesë e aftisës përndarje etj), prishje e kromozomeve dhe prishje e strukturës qelizore, inaktivizimi i fermenteve e virusave, frenimi i sintezës së D R N e R N, polimerizimi i D R N etj. Ndryshimet që ndodhin në qelizë, nën veprimin e rezatimit, mund të jenë të kthyeshme ose të pakthyeshme.

Sic shihet edhe nga pasqyra 1, gjatë rezatimit me burim me P-32, ndodhen fundet e lira të nervave. Epiderni përban kryesisht substancë proteinike të pasura në cistein, tirozinë dhe histidinë. Shtresa e qelq të transparente përban eleidinë. Këto substanca, siç dihet, kanë veti të absorbojnë spektrin ultraviolet të drithës. Si rrjedhim, i gjithë rezatimi ultraviolet, që shkaktohet gjatë ionizimit, do të absorbohet me precedencë në shtresat e mësiperme. Gjatë veprimit të rezatimit mbi蛋白酸idet ndodhn kryesisht dearminimi e dekarboksilimi, duke formuar aldeide e disa produkte të tiera.

Rrezatimi mbi acidet nukleinik e nukleoproteinat vepron duke i depolimerizuar. Ky proces mund të vazhdojë edhe disa orë pas ndërrerjes së rezatimit.

Fermentet që gjenden të pastër janë shumë të ndjeshëm ndaj rezatimit, ndërsa duke u ndodhur në lëngun qelizor, atyre u rritet qëndrueshmëria ndaj rezatimit për shkak të efektit mbrojtës të substancave të tjera që gjenden aty.

PËRGATITJA E BURIMIT

Në beta-terapi sipërfaqësore rekombandohen shumë izotopë radioaktivë për përgatitjen e burimeve (aplikatorëve). Izotopë beta-rrezatues të pastër, që kanë hyrë në praktikën klinike janë: 90Y, 32P, 204Tl, 142Pm.

Nga të gjithë këto izotopë kemi preferuar si më të përshtatshëm ^{32}P për këto arsyen:

1) Në krahasim me izotopët e tjere, është izotop i lirë.

2) Ka energji rezatimi të madh.

$E_{\text{max}} = 1.707 \text{ MeV}$ dhe $E_{\text{mez}} = 0.69 \text{ Mev}$.

3) Ka periodë jo shumë të shkurtër $T^{1/2} = 14.3$ ditë.

4) Ka radiokoksicitet mesatar që mund të përpunohet përkrahësisht lehtë.

Metodika e përgatitjes është ajo e përshtkuar më parë (1). Në punën e mëvonëshme, si rezultat i perfeksionimit të teknikës së përgatitjes, është arritur të përgatiten burime me fuqi doze 3600 R/orë dhe me homogjenitet doze të kënaqshme.

Me qëllim që të rrisim fluturin e dozës dhe të shfojmë pjesën e rezatimit me energji të lartë kemi përdorur edhe reflektues.

Në pasqyrën nr. 2 jepen rezultatet e studimit të rritjes së intensitetit të rezatimit të burimit me $= 3 \text{ cm}^3$, duke përdorur reflektues nga xhami organik është plumbi me trashësi të ndryshme.

Pasqyra nr. 2

d,mg/cm ²	0	446.8 (xh.o)	446.8 (xh.o) + 2268 Pb	446.8 (xh.o) + 4536 Pb
I	50.500	56.500	57.500	59.500
Rritja e intensitetit të rezatimit (%)	0	11.8	13.8	16.8

Mjekimin me izotopë radioaktivë të fosforit e kemi filluar në vitin 1970 me disa dermatozë me karakter kronik si neurodermitë dhe ekzemë kronike (1). Sëmundjet në fjalë kanë si simptoma të jashinte të krojtarit të theksuar dhe, me mjetet e zakonshme të mjekimit, shërohen me vështirësi. Jo rrallë ndodh që nuk zhërrohen fare. Në të tilla raste, lëkurë ashpersohet, duke u likenifikuar dhe, çfarë është më e keqe, i jep shkas një dëshire të papërbajtur për tu krojtar. Ndjenja e të krojtarit e keqëson më tepër gjendjen e lëkurës, sepse i sëmuri, duke mos pasur shërim me mjetet e zakonshme të mjekimit, nuk e duron këtë ndjenje dhe kruhet me tërbim. Në të vërtetë ndiehet një farë qetësimi i përkohshëm me anë të të kruajturit, por pas pak kohe dëshira për tu krojtar bëhet më e forte dhe gjendja e lëkurës gjithnjë më e rendë. Duhet theksuar se me anë të të krojtarit shtohet mundësia e infektimit të dermatozës.

Raste të tilla jemi përpjekur t'i mijekojmë duke përdorur aplikatorë me fosfor radioaktiv, të cilët vendosen në vatrën e lëkurës së prekut për një kohë të caktuar, përkrahësish të vogël, e mjaftueshme për të arrijtur dozën 100 R çdo seancë gjatë gjashë diti të rrëndë. Po me këtë dozë kemi kuruar disa dermatozë të tjera me etiologji të panjohur.

Përvog dy grupeve të mësipërme, me aplikatorë me fosfor-32 kemi përdorur një dozë ditore prej 200 R gjatë dhjetë ditëve rradhazi, siç ndjejnë asnjë lloj shqetësimi. Vëtëm një i sëmure, nga 121 rastet që kemi mpirje të lehtë në dhëmbë. Ky rast duhet shpjeguar me ndonjë veçori psikologjike të të sëmurit ose me radiosibilitet të lartë të tij.

Rezultatet e arritura në kurimin e llojeve të mësipërme të dermatitmi, janë përbërëshur në pasqyrën nr. 3. Sic shtohet nga kjo pasqyre, gjatë kësaj periudhe janë kuruar 121 përbërësh, që mund të përbërëshin në tre grupe. Në grupin e parë gjinozë. Këta përfaqësojnë 104 patientë ose 85,9% të numrit të pacientëve dhe pothuase të gjithë janë të ritur, me përiashim të dy vëllazërve me moshën nën 10 vjeç. Meshkujt përfaqësojnë 58,6%, ndërsa femrat 41,4%.

Këta të sëmure përbërjenë numrin më të madh të tyre. Ndjejkja e kanë qënë të kënaqshme sepse pas 3-4 dhe deri 6 vjet mjetimi, eshtë konstatuar shërim në këtë mënyrë: në 86% të neurodermitave në 76% zulhatet e arritura mund të konsiderohen të kënaqshme, sepse në një përgindje të tillë shërimi (që duhet konsideruar e lartë), shqetësimi kryesor, të krojtur, eshtë zhdukur krejësish dhe indi eshtë kthyer në normë. (P. D.), të ardhur nga fshatari Lushnjës, me *eczema atopicum* dhe me moshë 7 dhe 8 vjeç. Dermatoza ishte shfaqur në regionet poplite, në krojtor të theksuar. Ishte një simptomë që i shqetësonë jashtë masës mësimive. Prindrit gjithashtu ishin të shqetësuar, sepse, pas shume mjeshtësive, fëmijët nuk patën përmirësimë. Pas një kurimi gjashëtë ditor me aplikatorë me fosfor-32, duke u dhënë dozë 100 R në çdo seancë, të krojturnit u zhduk së bashku me papulat që në vatrën e prekura, lëkura u kthye në gjendje normale.

Nga janari i vitit 1976 kemi filluar të mjejkojmë me aplikatorë me fosfor radioaktiv sëmundjet e kapilaritetit të gjakut, angiomat e shëstra ose pak të ngritura, që përfshihen në grupin e tretë. Këto, janë varet që shkojnë nga \varnothing 10-15 mm deri në më tepër se \varnothing 300 mm, të cilat varet paktë pas shfaqjes, por, në më të shumtentë e rasteve, qëndrojnë dhe vijnë duke u zmadhuar. Megjithëse nuk jepin ndonjë dhëmbë, ato shkaktojnë shqetësimë estetikë në pjesët e dukshtme të trupit, si në fytyrë dhe sidomos në vajza.

Rastet me angjoma janë 10, të gjithë të moshës së ritur, 2 meshkuj dhe 8 femra. Një i sëmure e ndëprenur kurën, kurse tjetri (A. P.) me angjionë të rrumbullakët, jo shumë të ngritur, në madhësi sa një bizele,

Pasqyra nr. 3

Nr.	Lloji i sëmundjes	Mosha	Mosha	Seks i		Doza e përdorur R	Shëruar	Përmirësuar	Pandryshim	Përqindja e shërimit
		1-10 vjeç	11 vjeç e lart	M	F					
1	Neurodermitis	—	29	19	10	600	25	4	—	86
2	Eczema chronicum pruriginosum	—	58	32	26	600	41	10	—	76
3	Eczema atopicum	2	9	7	4	600	8	2	—	72
4	Dermatitis papulo pruriginosa	—	6	3	3	600	4	2	—	60
5	Angioma	—	10	2	8	2000	2	8	—	20
6	Naevus linearis pruriginosus	1	—	—	1	600	—	1	—	—
7	Acne nuchae	—	3	3	—	600	2	—	—	66
8	Keloid	—	2	1	1	1500	—	—	—	—
9	Granuloma anulare	—	—	1	1	600	—	—	—	—
Gjithsej		5	116	68	53		82	28	11	

e vendosur në pjesën e sipërme e të mesme të buzës së poshtme, u shërua krejtësisht pas një kurimi dhetëritor rradhazi me nga 200 R në çdo seancë. Angjionma e zhdurur, pas dy vjetëve kontrolli të kohëpas koshume, nuk është rishfaqur dhe ky rast duhet konsideruar si një shërin i plotë.

Në rastet e femrave, njëra 20 vjeçare (A. Sh.), nga Fieri, kishte hemangjione të përrhapur nga gjysma proksimale e regjionit metakarpa skapular të po kësaj ane. Kjo angjionma shtrihet në të gjithë sipërfaqer mjekuar vetëm në një pjesë të sipërfaqes së krahut rrëth 15 cm. Brezitimi i gjithë sipërfaqes ka qënë i pamundur për shkak të sipërfaqes së madhe dhe kjo do të kryhej shkallë-shkallë. Pjesa e mrezatuar, pas një para të përfthara, në këtë rast të papërfunduar, duhet të konsiderohen kënaqshme dhe optimiste për të ardhmen.

Shtatë të sëmuarëve të tjierë, me moshë të rritur, angjionma iu është shfaqur pak muaj pas lindjes ose në dy vjetë; e para të jetës, në një rrumbullakët të parregulltë dhe me një diametër nga 5 deri në 10-15 cm. Karakteristikë e këtyre angjionave është se prekin pothuajse gjithnjë kapakun e poshtëm të syrit dhe janë të shfaqura vetëm në një anë.

Në këta shtatë të sëmuarë, vetëm një (A. N.), 23 vjeç, ka mbaruar kurimin, duke rrezatuar çdo vatrë dy herë (një herë në 6 muaj me 200 R në çdo seancë për 10 ditë rradhazi). Në këtë rast, eritema ishte zhdukur dhe indi ishte kthyer në ngjyrën normale të tij. Mendojmë se ky rast mund të vlerësohet me rezultat paraprak të mirë.

Gjashtë të sëmuarët e tjerë (kanë kryer rrezatimin e parië, duke u dhënë shprehur në palkësimin e eritemës. Mendojmë se edhe këto rezultate paraprake të njekinit të angjionave të sheshta mund të vlerësohen të mira.

Mund të konkluzohet se përdorimi i aplikatorëve radioaktivë të fosfotrit -32 me dozat e treguar, ka dhënë rezultate të kënaqshme në 76% të ekzemave, në 86% të neurodermiteve dhe në 72% të ekzemave atopike. Ne këlojdet dhe granuloma anulare nuk kemi pasur rezultate, ndërsa në angiomat e sheshta, rezultatet e arritura janë optimiste për të ardhmen.

Këto rezultata ndryshojnë pak nga ato të literaturës. Në literaturë, përqindja e shërimit për ekzemat jepej 85%, ndërsa në neurodermitet 75%.

Doza e përdorur nga ne, për kurimin e neurodermiteve është 20-30% më e vogël sesa ajo që rekombinohet në literaturë (3), ndërsa përqindja e shërimit e arritur tek ne është 11% më e lartë.

Mendojmë se rezultatet e arritura deri më sot duhen të pasurohen akoma me raste të tjera si për sëmundjet në fjalë, për të gjetur ligjshmërinë statistikore, ashtu dhe për t'u shtrirë në lloje të tjera sëmundjesh.

B I B L I O G R A F I A

- 1) Basha Sh. e bp. : Përgatitja e amplifikatorëve dhe rezultatet paraprake të pérdorimit të tyre në disa sëmundje të lëkurtës. Buletini i UT – Seria shkencat mjekësore 1971, 2, 89.
- 2) Dorothy V. Whipple : Dynamics of development. Enthemic pediatrics. 1968, 303.
- 3) Haissinsky M. : Jaternaja hinnja i jeje prilozhenija. 1961, 426.
- 4) Schoneid N. : Lehrbuch der Haut und Geschlechtes – Krankheiten, Stuttgart 1959, 386.
- 5) Sokolov V. A. : Istorički beta izluzenja v medicine. Atomizdat. 1966, 81.
- 6) Zahary M. El. : Text Book of common Skin diseases. Cairo 1971, 41.

S u m m a r y

THE USE OF PHOSPHORUS-32 RADIOACTIVE APPLICATORS IN THE TREATMENT OF SOME SKIN DISEASES

The use of phosphorus applicators (radioactive) has become a well established method of treatment of a number of skin diseases in which the usual methods fail to give satisfactory results.

For the treatment of various diseases of the skin and the blood capillaries P^{32} applicators were prepared in doses up to 3600 $r/cm^2/hour$. Beta-therapy has given good results in 86% of the neurodermitis, in 76% of the cases with chronic pruriginous eczema and in 60% of the cases with pruriginous dermatitis. In plane angioma the up to date results have proved satisfactory in the cases in which the treatment was completed. In Granuloma annulare and cheloids beta-therapy has proved ineffective, whereas in acne muchiae and pruriginous naevi the symptom of pruritus was relieved.

R é s u m é

USAGE DES APPLICATEURS RADIOACTIFS DU PHOSPHORE-32 DANS LE TRAITEMENT DE CERTAINES MALADIES DE LA PEAU

L'emploi des applicateurs radioactifs du phosphore s'est désormais affirmé comme une méthode efficace dans le traitement de beaucoup de maladies de la peau, du fait même que les méthodes habituelles ne donnent pas des résultats satisfaisants.

Pour le traitement de diverses maladies de la peau et des capillaires du sang ont été préparés des applicateurs P^{32} dans des doses allant jusqu'à 3600 $r/cm^2/heure$. La bêta-thérapie a donné de bons résultats dans 86% des cas de neurodermitis, dans 76% des cas d'eczéma prurigineux chronique et dans 60% des cas de dermatite prurigineux. Si le traitement est conduit à terme, les résultats sont satisfaisants même dans les angiomes plates. En ce qui concerne les granulomes annulaires et les chéloïdes, la bêta-thérapie s'est montré inefficace; dans les cas d'acne muchiae et de venus pruriginosum, au contraire, cette même thérapie a fait disparaître provisoirement le prurit.

PERCAKTIMI I KREATININËS ME MIKROMETODË NË GJAKUN KAPILAR

— Siri Leskoviku —

(Laboratori Qëndror biokimik – Spitali nr. 1 Tiranë)

Në vazhdim të studimit tonë për aplikimin e mikrometodave në gjakun kapilar, në këtë punim po paraqitim një mikrometodë për përcaktimin e kreatininës.

Kreatinina është një produkt endogen i metabolizmit muskular (cituar nga 10). Si organ i jashtëqitezës, veshka rregullon përqëndrimin e kreatininës në gjak. Nivel i kreatininës së serumit zakonisht është përkrahësish i qëndrueshëm për çdo individ dhe varet drejtpermëdhet nga masa muskulare e trupit.

Metoda që përdoret zakonisht për përcaktimin e kreatininës është ajo e reaksiionit Jaffé (4). Ky reaksiون nuk është specifik për kreatininën, në gjak dhe sidomos rrëruazat e kuge ka edhe substancë të tjera si trupat ketonikë, acidi askaribik, piruvati dhe glukoza, që janë reaksiون ngjyrues jo specifik (6, 7, 11). Për këtë arsy, përcaktimi duhet bërë në serum apo në plazmë.

Metoda me acidin dinitrobenzoik (cituar nga 6) jep vlera që afrohen shumë me përqëndrimin efektiv të kreatininës, por ka si të metë paqëndrueshmërinë e ngjyrës.

Krahas metodave të lartpërmëndura ekzistojnë edhe metoda kinetike që automatike të përcaktimit të kreatininës, që bazohen në reaksiونin Joffe (3, 5).

QELLIMI I PUNIMIT

Qellimi i këtij punimi është përcaktimi i kreatininës me mikrometodë në gjakun kapilar në çdo laborator me pajisje të zakonshtme, pa qenë nevoja për pajisje që mjete speciale.

Nga literatura e huaj që kemi mundur të konsultojmë nuk kemi gjetur ndonjë mikrometodë me gjak kapilar për kreatininën që kërkon pajisjet e zakonshtme të një laboratori biokimik. Kështu një autor (6) përdor 100 mikrolitra serum, por rekomanon dhe ultramikropajisje speciale.

Ne përshtatëm dhe aplikuan metodën që pëshkruan një autor tjetër (3), që kërkon 1 ml. plazmë ose serum. Si rezultat i këtij modifikimi duhen vetëm 200 mikrolitra placëm dhe sasi reagençiesh më të pakët.

Parimi i mikrometodës sonë bazohet në precipitimin e proteinave plazmatike sipas Folin – Wu dhe në reaksonin ngjyrues të kreatininës me pikrotn alkalin, si rezultat i të cilët formohet një bashkëdëzym me ngjyrë tulle që ka maksimumin e absorbimit në filtrin e 500 nm.

MATERIALI I STUDJUAR

Reaktivat

- 1) Tretësirë N/12 acid sulfurik
- 2) Tretësirë 10% volframot natrumi
- 3) Tretësirë 1.17% acid pikrik
- 4) Tretësirë 10% hidroksid natrumi
- 5) Pikrat alkalin : 1 vëllim tretësirë 10 % hidroksid natrumi + vëllime acid pikrik 1.17%. Përgatitet para analizës.

TEKNIKA

Nga gishti merret 0.5 – 0.6 ml. gjak dhe hidhet në një mikre epruvetë të heparinizuar me përmasa 35×8 mm. Heparinizimi është bër duke i shpëlarcë mikroepruvetat me një tretësirë që përbënban 1 ml. heparinë 5000 U.I. në 70 ml. ujë të distiluar; pastaj epruvetat janë tharë pë dy orë në dollap tharës në temperaturën rreth 100°C.

Përbajtja e mikroepruvetës përzihet që gjaku të mos koaguloj dhe centrifugohet në mikrocentrifuge. Merren 200 mikrolitra plazë me një mikropipetë të graduar tip Pasteur dhe hidhen në një epruve të zakonshme centrifuge. Shtohet 1.6 ml. tretësirë N/12 acid sulfurik 0.2 ml. tretësirë 10% volfram natrumi. Përzihet dhe centrifugohet Centrifugati që është rrëth 1.5 ml. derdhet në një epruvetë tjeter dëfay shtohet 1 ml. pikrat alkalin. Lihet 10 minuta në qetësi dhe fotometrohet në FEK me filtrin 500 nm me kyvetë 0.5 cm. kundrejt ujë të distilarur.

Blanku i reagentëve punohet një lloj si analiza, veçse në vend 200 mikrolitra plazëm merret 200 mikrolitra ujë i distiluar.

RESULTATET E EKSPERIMENTIT DHE DISKUTIMI I TYRE

1. — *Kalibrimi i analizës.* — U përgatit një tretësirë standart mën me përgjëndrim 100 mg%, duke tetur 100 mg. kreatininë në 100 ml tretësirë 0.1 N HCl. Prej kësaj tretësire u përgatiten 8 etalone me pë-

qëndrime 2; 4; 6; 8; 10; 12; 14; 16; 18 dhe 20 mg% kreatininë duke bërë hollimet me ujë të distiliuar.

Secili etalon u punua një lloj si analiza duke filluar nga faza e parë e saj, vëçse në vend të 200 mikrolitra plazëm merret 200 mikrolitra prej secilit etalon. Kurba e kalibrimit që u ndërtua me ekstinksionet e fitura rezultoi vije e drejtë deri në përqëndrimin 20 mg% kreatininë. Të dhënët e fituara janë paraqitur në pasqyrën nr. 1. Nga të dhënët e paragjitura, në këtë pasqyrë është zbritur vlera e blankut të reagentëve ($OD = 0.085$).

Pasqyra nr. 1

Etalon kreatininë në mg%	Ekstinkioni i secilit etalon
2	0.035
4	0.070
6	0.115
8	0.135
10	0.160
12	0.195
14	0.230
16	0.255
18	0.285
20	0.320

Në dozimet e përditshme për efekt llogaritjeje të përdoret vetëm etalonë 2 mg% dhe illogaritja e sasisë së kreatinemisë duhet bërë me formulen e mëposhtme:

$$\text{ng% kreatininë} = \frac{(\text{Ekstinksion i analizës} - \text{Ekstiksion i blankut})}{(\text{Ekstinksjon i standartit} - \text{Ekstinksion i blankut})} \times 2$$

Kufirin drejtvizor të kurbës të kalibrimit një autor (8) e ka gjetur deri në përqëndrimin 15 mg%, kurse një tjetër (3) deri në 20 mg% kreatininë.

2. — SPEKTRI MAKSIMAL I ABSORBIMIT — Kjo hallkë eksperimentale u provua për blankun e reagentëve dhe standartet me përqëndrim 2 dhe 4 mg% kreatininë. Rezultatet e këtij eksperimenti paraqiten në pasqyrën nr. 2.

Pasqyra nr. 2

Filtër	42	44	48	50	53	55	59
Mosta							
Blanku	1.5	0.97	0.155	0.095	0.015	0.040	0.000
2 mg%	1.8	1.05	0.195	0.130	0.030	0.060	0.000
4 mg%	1.8	1.10	0.220	0.155	0.050	0.060	0.000

Për të përcaktuar filtrin e përshtatshëm u gjykuas sëpas ndryshimit të ekstinksionit të dy etalonave me përqëndrime të ndryshme kreatinin dhe u pa se ky ndryshim ishte më i madh përfiltrim 48 dhe 50. Por me qenëse filtri 48 jep një blank më të lartë se filtri 50 (0.155 kundrej 0.095) ne preferuan filrin 50. Një autor (3) ka gjetur si absorbim maksimal gjatësinë e valës 490 nm, një tjeter (6) 550 nm, kurse një autor gjatësinë e valës së fotometrike është 555 nm. Kjo diferençë e vogël nijetë (5) e bën matjen fotometrike në 555 nm. Kjo rastështë përfiltrimi gjatësinë e valës së fotometritmit, midis të dhënave të autorëve të ndryshëm, shpjegohet me tipat e ndryshëm të fotokolorimetritave dhe spektrofotometritave, që janë përdorur për matje.

3) RIPRODHUESHMËRIA E METODËS. — Rezultatet e eksperimentimit të riproduheshmërisë së mikrometodës së kreatinemisë të provuav përfasat normale dhe patologjike janë paraqitur në pasqyrën nr. 3.

Pasqyra nr. 3

Riproduheshmëria e rezultateve në seri nr. 20		
	Për rastet	
	Normalë	Patologjikë
X (mg%)	1.95	4.77
S (mg%)	0.12	0.215
V	11.3	4.3

Nga të dhënat e paraqitura në pasqyrën nr. 3 rezulton se riproduheshmëria e rezultateve në seri përfasat patologjike është brenda kufirit të lejueshëm ($V = 4.3\%$), ndërsa përfasat normale ($V = 11.3\%$) kalon pak kufirin e lejueshëm. Mendojmë se kjo shpjegohet me faktin se një ekstinsion prej 0.01% i përkon 0.33 mg\% kreatinine, meqëse mostra e gjakut, të analizuar është përkrahësishët e vogël. Megjithatë këtu ul vlerën e metodës përfasat përfasim në praktikën e përditshme laboratorike.

4. REKOVERI I ANALİZËS. — Për të eksperimentuar rekoverin mikrometodës përdorëm standartin me përqëndrim 20 mg\% kreatinine. Shtuam 10 përqëndrime të ndryshme prej tij në të njëjën mostër plazmës së gjakut. Sasitë e kreatinines të shtuara, të zbuluara dhe pëqindja e rekovertit të fituar janë paraqitur në pasqyrën nr. 4.

Pasqyra nr. 4

ml. standart kreatininë 20 mg %.	Kreatininë e shuar në mg	Kreatininë zbuluar në mg	Rekoveri %
0.10	0.020	0.020	100
0.11	0.022	0.020	90
0.12	0.024	0.025	91
0.13	0.026	0.026	96
0.14	0.028	0.025	83
0.15	0.030	0.030	93
0.16	0.032	0.030	91
0.17	0.034	0.031	84
0.18	0.036	0.032	93
0.19	0.038	0.036	93
0.20	0.040	0.038	93

Rekoveri mesatar = $92 \pm 4.9\%$

Sikurse shihet edhe nga pasqyra nr. 4, rekoveri mesatar është $92 \pm 4.9\%$, d.m.th brenda kufirit të lejueshëm.

5. – KRAHASIMI I MIKROMETODËS ME METODË REFERENTE. – Mikrometodën e përcaktimit të kreatininës në gjakun kapilar e krahasuar me një metodë referente. Si të tillë përdoren metodën që është suam me një laboratoret kliniko-biohimike të vendit tonë (1, 9), e cila kërkon serum ose plazmë të fituar nga gjakut venoz.

Përpunimi statistikor i të dhënave krahasuese të dy metodave është bërë në Qendrën e Matematikës Llogaritëse të Akademisë së Shkencave të RPS të Shqipërisë. Si prag i pranueshmërisë se probabilitetit është marrë kuifiri $P = 0.05$.

Rezultatet e krahasimit të dy metodave janë paraqitur në pasqyrën nr. 5.

Pasqyra nr. 5

Metoda	N	t-testi	r
Mikrometoda	100	0.049	0.988
Metoda referente	100		>0.05
P			

Parametrat statistikore të paraqitur në pasqyrën nr. 5 tregojnë përmjë lidhje të ngushtë statistikore ndërmjet mikrometodës dhe metodës referente, gjë që duket nga koeficienti i koreacionit $r = 0.988$.

Analiza regresive e rezultateve paraqitet në figurën nr. 1. Ekuacioni i regresionit është $Y = 0.045 + 0.896 X$. Koeficienti i regresionit është 0.896.




Figura N. 1 ANALIZA REGRESSIVE E MIKROMETODES KREATININEMISE

x: REZULTATET E METODES REFERENTE
y: REZULTET E MIKROMETODES

Përgjithësisht duket iu referuar llogaritjeve statistikore që kemi paraqitur në këtë punim mund të themi se rezultatet e marrura me mikrometodë kanë vërtetësi shkencore.

6. – Vlerat normale të mikrometodës. — Përcaktimi i vlerave normale të mikrometodës së kreatininemisë në gjakun kapilar u bë duke bërë dozimin në 200 njerez të shëndoshë. Përpunimi statistikor tregoi per një shpërndarje normale të rezultateve. Si vlerë normale rezultoi $X \pm 2S = 0.35 - 1.81 \text{ mg\%}$. Të dhënët tonë, të krahasuara me ato të autorëve të tjere përputhen, me ndryshime pak a shumë të vogla, që mendojmë se i detyrohen mikrosasisë së gjakut, që përdorim ne. Kështu një autor (3) kreatininemë e ka gjetur normalisht në shifrat $0.8 - 1.5 \text{ mg\%}$.

Autorë të tjere e kanë gjetur prej $0.5-1.2$ (6), $0.9-1.4 \text{ mg\%}$ (4), $0.6-1.5 \text{ mg\%}$ (11).

7. – Dozimi i kreatininemisë me mikrometodë në rastet patologjike.

Mikrometodën e kreatininës e provuam për saktësi edhe përputhshmëri edhe me diagozën klinike. Për këtë bëmë dozimin e kreatininës në plazmën e gjakut kapilar në 39 të sëmurrë me insuficencë rënale.

Nga përpunimi statistikor rezultoi se vlera mesatare dhe devijimi standart i kreatininës për 39 të sëmurrë për insuficencë renale ishte $7.9 \pm 5.65 \text{ mg}^{0/0}$ kundrejt $1.084 \pm 0.365 \text{ mg}^{0/0}$, që ishte vlera e gjetur në njëzet e shëndoshë. Pra rezultatet e marrura për rezultatet patologjike i përgjigjen mirë klinikës.

PËRFUNDIME

- 1) Mikrometoda e kreatininës paraqet riprodhueshmëri të mire të rezultateve, rekover brenda kuifrit të lejesueshmërin dhe një kurbë kalibrimi, që është drejtvizore deri në përgjendrimin $20 \text{ mg}^{0/0}$ kreatininë.
- 2) Mikrometoda është e shpejtë, e përpiktë dhe jep rezultate të përfafërtë me metodën referente ($r = 0.988$; $P > 0.05$).
- 3) Analiza regressive tregon lidhje të ngushtë të mikrometodës me metodën referente.
- 4) Vlera normale e kreatininës me mikrometodë është $0.35\text{-}1.81 \text{ mg}^{0/0}$.

BIBLIOGRAFIA

- 1) Bylykhashi V., Leskoviku S. : Manual i ekzaminimeve kliniko-biokimike. Tiranë 1970, pjesa e dyte.
- 2) Fahiny D. L., Ernsinghausen G. : Autotestod reaction method for determination of serum creatinine with the centrifug - chem. Clinical Chemistry 1971, 17, 696.
- 3) Faulkner R., Willard, John W. King : Manual of clinical laboratory procedures. 1970, 38.
- 4) Henry R. : Clinical chemistry. New York 1964, 287.
- 5) Jack A. Lustgarten, Robert E. Wenk : Simple rapid kinetic method for serum creatinine measurement. Clinical hemistry 1975, 11, 1419.
- 6) Mattenheimer N. : Micrometodi biochimici e chimico clinici. Padova 1971, 72.
- 7) Merck E. : Clinical laboratory. 11-th edition of medico-chemical investigation method. Darmstadt 1970, 218.
- 8) Spordrio L. : Analisi biochimico-cliniche. Padova 1972, 68.
- 9) Shehu E. : Studim eksperimental për unifikimin në shkallë Republike të me-todave të kreatininës. Nentor 1976 (material i pa botuar).
- 10) Shieto K. : Biokimia në praktikën klinike. Tiranë 1975, 341.
- 11) Valente D. e bp. : Il laboratorio clinico Milano 1967, 144.

A MICROMETHOD FOR THE DETERMINATION OF CREATININ IN CAPILLARY BLOOD

Summary

A micromethod is presented for the determination of creatinin in capillary blood. It requires 200 microliters of blood plasma and is an adaptation of the classical Joffe method based on a colour reaction.

The micromethod gives a good reproducibility of the results and a recovery within the permissible limits, as well as a straight-line calibration curve up to a

concentration of 20 mg/100 ml. The micromethod is rapidly performed, precise and gives results comparable to those of the reference method used by the authors ($r = 0.988$; $P < 0.05$). The precision of the method was tested by a regressive analysis ($y = 0.045 + 0.896 x$). The micromethod was also tested on normal subjects and the values found ranged between 0.35 and 1.81 mg/100 ml.

Résumé

UNE MICROMÉTHODE POUR LA DÉTERMINATION DE LA CRÉATININE DANS LE SANG CAPILLAIRE

Cette méthode a été mise au point pour déterminer la créatinine dans le sang capillaire, et cela à partir de la méthode classique de Joffe, qui se fonde sur réaction de la couleur. A cette fin, il importe d'avoir 200 microlitres de plasma sanguin.

Elle garantit une bonne reproduction des résultats, une recover dans les limites permises et une courbe de calibrage allant du linéaire à une concentration de 20 mg/100 ml. Cette microméthode est appliquée rapidement, elle est précise et fournit des résultats comparables à ceux obtenus par la méthode de référence employée par l'auteur ($r = 0.988$; $P < 0.05$). Sa précision a été mise à l'épreuve par l'analyse régressive ($y = 0.045 + 0.896 x$).

Cette méthode a été également appliquée à des sujets normaux et les valeurs obtenues variaient de 0.35 à 1.81 mg/100 ml.

NJË STUDIM KLINIKO-HISTOPATOLOGJIK I LEUKOPLAKSE SË GOJËS

— XHAVIT ULQINI — GOJART CERGA — FLAMUR REXHA —

(Katedra e Terapisë stomatologjike, Katedra e patologjisë së përgjithshme,
Poliklinika Qendrore stomatologjike — Tiranë)

Leukoplakia është një sëmundje kronike, që prek kryesisht membranën mukoze të faqeve, të buzëve, të gjuhës etj.

Etiopatogeneza. — Etiopatogeneza është e paqartë, por ngacmimet kronike, qoftë këto lokale apo të përgjithshme, ndihmojnë lindjen e sëmundjes. Këtu mund të përmëndim duhanin, alkoolin, elektrogalvanizimin, sëmundjet e sistemit gastrointestinal, sëmundjet specifike, avitaminozat, qrrëgullimet hormonale, sëmundjet kronike të veshkave etj. Rëndësi ka dhe higjena e hapësirës së gojës (1, 2, 4, 6).

Sëmundja shfaqet me plakë të bardha me shkëlqimin e sidefit, të cilat mund të jenë të sheshta, të ulqinara, verrukoze. Nga ana histopatologjike, sëmundja paraqet një ntarashje të epitelit të membranes mukoze, e cila mund të paraqesë fenomenet e hiperkeratozës, parakeratozës, ekantozës etj. Në shtrresën subepiteliale vërehet infiltrim limfо-bukocitar (2, 3, 4, 11).

Në këtë material ne kemi bërë një studim kliniko-histopatologjik të 39 të sëmurëve me leukoplaki të ndjekur qysm nga viti 1972. Nga të sëmurët të paraqitur për mëjkin, këto raste përbëjnë 13%, gjë që pëputhet edhe me të dhënat e autorëve të tjere (1, 6, 7). Sëmundjen e kemi hasur më shpesh në meshkuj (33) sesa në femrat (6) (raporti meshkuj : feme 5,6 : 1). Kjo përpunhet me të dhënat e shumë autorëve (1, 4, 5, 7, 10).

Të ndarë sipas grup-moshave, të sëmurët tanë i paraqitim në pasqyrën nr. 1.

Pasqyra nr. 1.

Grup-mosha 20–29	Grup-mosha 30–39		Grup-mosha 40–49		Grup-mosha 50–59		Grup-mosha 60–69		Gjithsej
	M	F	M	F	M	F	M	F	
2	2	5	—	10	3	10	—	6	1
4	5	13	10	—	7	—	—	39	M+F

Mosha mesatare e të sëmurevë rezulton 45 vjeç, më i riu 23 vjeç, më i moshuari 70 vjeç.

Nga pasqyra nr. 2 rezulton se tek të sëmuret tanë, faktoret më të shpeshtë, që ndihmojnë lindjen e leukoplakisë janë: duhani, alkooli, traumati mekanike, hepatiti kronik, gastritet dhe ulçerat e stomakut, çregullimet nervore.

Pasqyra nr. 2

Faktoret favorizues të leukoplakisë	nr i të sëmureve
Pijne dhjan (20–50 cigare në ditë)	34
Pije alkool me shumicë	6
Me dëmtimine traumatike kronike të mukozës	5
Elektrogalvanizim 200 M A	1
Vujnë nga hepatiti kronik	6
Vujnë nga TBC i shogëruar me Cor pulmonar	1
Vujnë nga gastrit, kolit, ulçer	5
Distoni neurovegjetative, neurozë	6
Krezatin i tepërtë diellor	1
Kolesterolinemi e rritur	1

Lokalizimin më të shpeshtë të sëmundjes e kemi hasur në faqe, në burzë, në procesin alveolar. Në faqe ka qenë e dyanëshme në shtatë të sëmure. Siç shihet nga pasqyra nr. 3, forma më e perhapur e leukoplakisë, në rastet tona, ka qenë forma e sheshtë – 17 të sëmure, erozi-vò-ulçerative II, verrukoze 9 dhe Tappenier 2.

Pasqyra nr. 3

Lokalizimi	Gjithsej	E shtë shtë	Erozivo Ulcerative	Verrukoze
Në faqe (7 nga të cilët në këndin e burzës)	14	5	6	3
Në burzë	4	1	2	1
Në procesin alveolar	9	3	3	3
Në trigonum retromolare	2	—	—	2
E gjeneralizuar	3	kombinuar	—	—
Në palatum	2	—	—	2
Në gjuhë	3	3	—	—
Në gjinovë	1	1	—	—
Në harqet palatine	1	1	—	—

22 të sëmurevë u kemi bërë ekzaminim histopatologjik. Në shumicën e rasteve, diagnoza histopatologjike ka vërtetuar atë klinike.

Nga studimi histopatologjik i rasteve rezulton se leukoplakia është shoqëruar nga keratoza, hiperkeratoza, akantzoza, diskeratoza, parokeratoza. Në rastet e ekzaminuara kemi të shprehur njérën diku tjetren,

të dyja ose të tjerë së bashku. Gjatë ekzaminimit kemi hasur atipi qelizore si: polimorfiزم, vakuolizm, devijime strukturelle dhe kromatike të bërtëharmës si deformim, zmadhim, piknozë, hiperkromi. Kufiri i shtrësës bazale me subepitelin ka qënë i dukshëm dhe ndonjëherë kemi hasur bashkërendim jo të rregulltë të qelizave të keratinizuara në formacione koncentrike (perle corne), në formën e luspave të qepës, prirje proliferative të epitelit për në thellësi të submukozës (akantozë), shumëzim të theksuar të qelizave epiteliale në shtrësën bazale. Kjo përpunhet me të dhënët e shumë autorëve të tjere (1, 3, 4, 8, 9).

Mjekimi i shërbimit bërë pas një studimi të hollësishëm etiologjik, klinik, histopatologjik. Pasi janë mënjanuar faktorët lokale dhe pasi është bërë mjekimi i sëmundjes favorizuese, kemi përdorur këto mënyra kurimi. Mjekimi terapeutik: me vitamine A, 50.000 UI, 10 ampula një ditë po një ditë jo intramuskar, vitaminë B, një ampulë 2 ml. qdo 48 orë (10 ampula). C 0,1 gr. në ampulë 2 ml. (20 ampula). Me këtë terapi kemi pasur rezultate të mira në frenimin e procesit leukoplakik. Këtë terapi e kemi përdorur në format e gjenerilizuar të paoperueshme, në format e sheshita dhe të fisuruar të leukoplakisë. Terapia është përsëritur qdo tre muaj gjër në shërimin apo përmirësimin e të sëmurtit.

Mjekimi kirurgjikal me heqjen e plakës leukoplakike deri në fund të shëndoshë (në format e lokalizuarë të sëmundjes) në të gjitha rastet me leukoplaki verrukoze. Deri në punimin e këtij materiali kemi pasur vetëm një recidivë.

Mjekim me azot të lëngjet e përdorur në të sëmure me leukoplaki të formave irreversible (i pakthyeshëm). Rezultatet kanë qënë të mira. Mjekim i gërshtëuar terapeutiko-kirurgjikal, është përdorur në format e përgjithësuarë të leukoplakisë, ku gjështëohen format e sheshia, eroziyo-ulcerative dhe verrukoze dhe në leukoplakinë Tappenier, kur ka qënë e shqëruar me leukoplaki të fages apo të procesit alveolar.

Për formën irreversible kemi bërë ekcizion dhe pastaj kemi dhënë vit. A, vitamina të grupit B dhe vit. C me dozat e lartpermëndura përmjekimin e vatrave të tjera reversible (të gradës së I dhe të II).

Mjekimi rontgenoterapeutik e kemi aplikuar në ato raste kur ekzaminimi histopatologjik ka dhëmë fenomene atipie.

Mjekim të gërshtëuar kirurgjikal-rontgenoterapeutik nuk kemi përdorur.

Për ta bërë sa më të qartë sa më lart, po përkruajmë katër nga të sëmuret tanë.

Rasti i parë: i sëmuri M. P., vjeç 53, nr. kartele 1001, nr. i biopsisë 1338. Ankontë për djegje të qielzës ku herë pas here i formoheshin disa qeska të vogla të mbushura me lëng, që plasnin. Duhanin e pin qysht nga viti 1937, nga 50 cigare të dredhura ditë-natë.

Objektivisht në qielzë paraqet pilakëza në formë unazash të bardha mbi nivelin e mukozës, në mes të të cilave dalin duktuset e gjëndrave salivare palatinale. Herë pas here ato mbyllen duke dhënë mikrokiste retensionale (foto 1). Diagnоза klinike: Leukoplakia duhanike Tappenier. Diagnоза histopatologjike: seksione nga materiali i veshur me epitel placentular shumë shtresor. Shtresa bazale me prirje rititje akantotike në disa fusha. Në mjaft zona kjo fushë paraqitet hiperkromatike dhe me atipizëm të lejtë. Shpesh ka dhe ndonjë mitozë. Shtresa spinozë shumështresore me edernë të saj. Ndërmjet qelizave spinocelulare vërehen urat

protoplazmike. Në këtë shtresë ka qeliza paraatipike (bërthamë e nadhe nukleot proeminent). Shtresa granularë shumë e shprenjur me shpërndarje të kromatinës në mënyrë të crrégulltë. Hiperkeratoza shumë e shprenjur me trashësi, që ikalon atë të epitelit. Në këtë zonë vërehen fusha të vendosjes së keratinës, që të janin përshtypjen e luspave koncentrike si ato të qepës (foto 2).

Submukoza fibrotike me infiltrat rotundo-celularë të bollshëm. Në një fushë kemi një zhyrje të shtresës granularë në thellësi të shtresës këratinike.

Leukoplaki e gradës së tretë (foto, 1, 2, 3). Mjekimi është bërë i kombinuar terapeutiko-kirurgjikal. Të sëmurit i është dhënë Vit. A 50.000 UI, 10 ampula në injektione dy ditore, Vit. B₂ në tabletë 3x 1 në 24 orë. Vit. C. Pomadë prednizolon 0,5% për lyerjen e plakëzave leukoplakike para gjumit. Në menyre kirurgjikale iu hq pilakëza leukoplakike në procesin alveolar pa dhëmbët në norullën e sipërme (djathas). Filmisht të sëmurit iu ndërpri duhani, alkooli dhe iu rivendos higjena e gojës. Gjatë katër vjetëve, sëmundja paraqet një stabilizim të procesit leukoplazik.



Fig. 1.

Pamje klinike të të sëmurit makroskopike (njolla e bardhë)

Rasti i dytë: M.B. 40 vjeç, nr. i kartelës 105, nr. i biopsisë 1519. Diagnostikohet rastësishët. I sëmuri ankonte se proteza e pjesshme skeletike, me bazament qeliku të paoksilueshëm dhe e mbështetur me kroshe elastike, i lëvis. Nga ana e qjellzës, protëza kish gurza. Objektivisht i sëmuri paraqiste plakëza leukoplakike, që lokalzohen në mukozën e fagës (lhe) në mukozën e procesit alveolar, pikërisht aty ku vendoset plaka metalike e protezës së skeletuar. Përmasat e plakëzave leukoplakike në këndin e buzeve ishin 2 x 0,8 cm. Ngjyra e bardhë blu me shkallqimin e sederit. Në procesin alveolar paraqiste leukoplaki verrukoze me ngjyrë të bardhë si débora me përmasa 2 x 2 cm. I sëmuri vuante nga parodon-



Fig. 2

Pamje mikroskopike e të njejtit të sëmurië
1) Perle corne; 2) Kufiri i hiperkeratozës në ind të shëndoshe.



Fig. 3

Pamje mikroskopike e të njejtit të sëmurië:
1) Zhvjezda epiteliale në shëresën granulare.
2) Urëzat qelizore në shëresën granulare.

topathia mixta, kish shumë procese kariozë dhe guzra (foto nr. 4). *Diagnosa klinike*: leukoplakia oris. Diagnoza histopatologjike: material i veshur me epitel piano celular shumështresor njaft të trashë. Qelizat e shtresës bazale me vendosje të rregulltë. Shtresa spinocellulare shumë e trashë me



FIG. 4

Pamje makroskopike me ragade e këndit të buzës. Leukoplakia e gradës së II.

fenomene keratinizimi të shprehura. Shtresa granulare me degjenerim granular të bërtëhamës dhe vakuolizm të pjesshën të tyre. Paraqiten disa shtresash (foto 5, 6). Hiperkeratoza mjaft e shprehur. Paraqirjet si sintresë homogjene, ngjyrë rozë të kuqe. Shtresa subepiteliale edematoze me infiltrate të shumta rotundo celulare. Leukoplaki e gradës së II.

Mjekimi: në filim u bë sanitimi i gojës. U hoq proteza skeletike, u hqen rrënjet e mbeturra dhe u mjekuan proceset karioze. Pas eliminimit të shkaktarëve favorizues dhe rivendosjes së plotë të higjienës së gojës u bë mjejkimi i kombinuar terapeutiko-kirurgjikal. Për leukoplakinë e këndevë të buzëve iu dha Vit. A, dhe vitamina të grüpuit B, vitamina C (medozat e lartpermëndura). Në këtë terapi, leukoplaka e këndeve të buzëve u zhjruk plotësisht pas 3-5 vjetësh. Në mënyrë kirurgjikale u hoq vatra leukoplakike verrukoze në procesin alveolar pa dhembë dhe u vendos protezë totale me rezinë transparente. Deri në ditët e punimit të këtij materiali, i sëmuri nuk ka pasur recidivë.

Rasti i tretë: M. S. 65 vjec, nr. kartele 2767, nr. i biopsisë 2886. Vuani nga një TBC kronik qysh nga viti 1956, i shoqëruar me *cor pulmonar* dhe nefrit. I sëmuri merr gjithë gamën anti tuberkulare. Ankonte përmungesë shije dhe gojë të ashëpersuar. U diagnostiku rastësisht. Objekti-vist paraqiste plakëza leukoplakike, ngjyrë të bardhë në blu, që përfshinë pjesët bukale majtas dhe djathtas. Plakëzat vazhdonin në formë kset posteriore, kapnin harqet palatine dhe përfundonin në trigonum




FIG. 5

Famje mikroskopike e të njëjtit rast:
1) Shtresa hiperkeratofike. Leukoplaki e gr. II.

retromolare. Në gojë i sëmuri mbante protezë totale lart dhe poshtë me rezinë ngjyrë trëndafilë. *Diagnosa klinike*: leukoplaki e mukozës së gojës.

Nga ana histopatologjike paraqiste epitel planocellular shumështrresor. Shtresa bazale me kufi të prerë me shtresën subepiteliale. Në shtresën bazale vëreheshin 2-3 radhë qelizash bazale, vendosja e të cilave nuk ishte aq e irregullitë. Aty-këtu vërehesë ndonjë mitozë si dhe hiperkromazi e bërthamës. Në shtresën spinozë vëreheshin qeliza me keratinizim të protoplazmës (hë bërthamë piknotike (perl korne) (foto 7, 8, 9). Shtresa granulare pak e shprehur. Keratinizimi i shprehur. Vëreheshin qeliza që kishin ruajtje të bërthamës në shtresën supërficiale të epitelit (parakeratozë). Shtresa subepiteliale kish infiltratë të dendura elementesh limfoplazmocitarë si dhe reaksion fibroblastik të shprehur. Në këtë shtresë, në afersi me shtresën bazale, vëreheshin qeliza vezake me protoplazmë të ngarkuar me pigment ngjyrë kafe-floriri (melaninë). *Diagnozë histopatologjike*: Leukoplaki e gradës së II (foto 9, 10).

Mjekimi i të sëmurit u bë në bashkëpunim me ftiziatri. Megjë i sëmuri ishte tuberkuloz i dekompenzuar u përdor mënyra e heqjes ki-

rurgjikale të plakës leukoplazike të faqeve. Pas tre vjetësh, i sëmuri pati recidivë. Në bashkëpunim me ftiziatrin iu dha Vit. A, vitamina të grupeve B, vitamina C, iu zëvëndësuan disa nga medikamentet antituberkulare me pasojë në membranat mukozë. Gjatë kësaj periudhe, i sëmuri ka pasur një farë stabilitetë të sëmundjes. Ai u mjekua duke qënë i shtruar në spital.

Rasti i kthertë: L. H., vjeç 63, me nr. kartele 786, nr. i biopsisë 665. Paragjitet për mjekimin e dhëmbëve. Në buzen e poshtme në sektorin e dhëmbëve frontale poshtë (të cilët kishin shumë pigmentë duhani),




Fig. 6

Pamje mikroskopike e të njëjtët rast.

- 1) Shthesa korneale (hiperkeratotike); 1) Qeliza me granula të aletinës dhe keratinës;
- 3) Vakuolizim i gjesshëm i bërtanës dhe qelizë polimorfe.

që lëviznin dhe kishin shumë gurza, rastësisht u zbuluan plakëza leukoplakike me ngyrë të bardhë në gri, me përmasa 1 x 0.5 cm., dhe paksa mbi nivelin e mukozës. Formimi i plakëzave leukoplakike përkonte me vendin ku i sëmuri vendoshtë cigaren gjatë pirjes.



Fig. 7
Panje makroskopike e rastit. Leukoplaki e faqes e shqëruar me flura.



Fig. 8
Panje mikroskopike e të njëjtit rast. Leukoplakia e gr. II. 1) Perle korne; 2) Qeliza me protoplazmë të vakuolizuar.




Fig. 9

Pamje e të njëjtit rast. 1 dhe 2 Mitza; 3) Bërthamë e madhe dhe hiper-kromatike.
4) Zhvylle epiteliale në indin subepitelial me qeliza me vëndosje jo shumë
të rrugullit.




Fig. 10

I njëjti rast. 1) Qelizë me pigment melanik; 2) Vëndosje jo
ërrugulltë e qelizave të shtresës bazale; 3) Qeliza me bërthamë të madhe
dhe hiperkromatike; 4) Duken urëzat ndërqelizore.

Diagnoza klinike: leukoplakia duhanike e buzës.

Në ekzaminimin histopatologjik paraqiste material të veshur me epitel planocellular shumështrsor. Membrana bazale e ruajtur mirë. Qelizat barocellulare me vendosje të rregulltë 1-2 shtrresore. Shtresa spinocellularë njoftë e trashë, disashtresore. Në qelizat e kësaj shtrese vërejë vakuolizim fokal i protoplazmës. Shtresa granulare e pakët me fenomene keratinizimi të shprehura, ndërsa ajo sipërfaqësore me keratinizim njoftë shprehur dhe vetëm në disa fusha kish hiperkeratozë. Leukoplakia e gradës së I (foto 11).

Pasi u pastruan gurzat, cipat duhanike të dhembëve, u rekomandua lënia e duhanit. Gjatë biopsisë u bë ekcizion kirurgjikal i pllakës sëmuri nuk ka pasur recidivë.

Leukoplaka është një sëmundje, që klinikisht shfaqet si njolla të bardha, të kufizuara mirë. Duhet theksuar se nuk është leukoplaki çdo njollë e bardhë në mukozën e gojës. Për mendimin tonë, (diagnoza e




Fig. 11
Pamje mikroskopike e rastit.

leukoplakisë është një diagnozë klinik-morfologjike, nga e cila varet dhe mijekimi.

Një faktor i rëndësishëm, për lindjen e leukoplakisë është sifilizi, që citohet gjithnjë e më shumë në studimet për leukoplakinë. Në sajë të masave që mori Partia dhe Qeveria, në sajë të punës këmbëngulësë të mijekësisë në përgjithësi dhe të dermatologjisë në veçanti, tek ne ky faktor ka mbetur dhe do të mbetet në arkivat mijekësore të vife të para të Çlirimit dhe të viteve të para pas Çlirimtit.

Leukoplakia mund të lokalizohet në çdo pjesë të membranës mukoze të hapësirës së gojës, por më shpesht haset në faqe, në këndin e buzëve dhe më rrallë në qielzë, gingivë etj. (foto 12).



Fig. 12

Leukoplakia verrukoze e trigonum retroromolare.

Që të bëhet një mijekim sa më efektiv i leukoplakisë, parapraktisht duhet të mënjanohen të gjithë faktoret favorizues të saj dhe pastaj të bëhet mijekimi. Kurimini në mënyrë të gërshtuar është më efektiv në leukoplakitë e gjeneralizuar.

PERUNDIME

1) Gjatë depistimeve të sëmundjeve të ndryshme, mijekët stomatologë, nje rendesi të vecantë, duhet t'i jepin leukoplakisë, sepse në fazat e para diagnostikohet rastësisht dhe nuk paraqet shenja subjektive.

2) Për vënien e diagozës dhe përcaktimin e mijekimit pa tjetëri duhet të bëhet ekzaminimi kliniko-morfologjik. Aspekti histopatologjik iu përgjigjet, deri diku, gradave të formave klinike.

BIBLIOGRAFIA

- 1) Asllani Xh. : Terapia stomatologjike. Tirane, 1974, 575.
- 2) Anderson W. A. D. : White lesions of mucosa. Pathology. Saint Louis, 1971, 1072.
- 3) Brusco G., Jonata J. e bp. : Le precancerosi della cavità orale. Saluzzo, 1962.
- 4) Baronecchia G., Questa L. : Il problema terapeutico delle leucoplasie del cavo orale. Rivista italiana di stomatologia 1965, vol. 20, 10, 1290.
- 5) Frey L., Ruppe Ch. : Pathologie de la bouche et des dents. Paris 1931, 485.
- 6) Kęgliku K. : Dermatologja dhe venerologjia. Tirane, 1973.
- 7) Lever F. W. : Leukoplakia, histopathology of the skin. Philadelphia - Toronto 1967, 500.
- 8) Labour L. : Kéatoses, hyperkéatoses, parakéatoses et dyskéatoses de la muqueuse buccale. Actualités odontostomatologiques 1964, 67, 273.
- 9) Lewin J. : Neoplasia. Internal medicine based on mechanism of disease. Saint Louis 1968.
- 10) Ored L. : Les kératoses et parakératoses buccales. Actualités odontostomatologiques 1964, 67, 281.
- 11) Subashi Sh. : Morfollojia patologjike. Tirane, 1975, 333.

Summary

A CLINICO-HISTOPATHOLOGICAL STUDY OF LEUKOPLAKIA OF THE MOUTH

The paper analyses the clinical and morphological aspects of mouth leukoplakia as observed in 39 cases. The number represents 1.3% of the patients applying for treatment during the same period.

The affection was more frequent among males than females (33 and 6 of the cases respectively). The average age of the patients was 47. The sites more frequently involved were the mouth mucosa, the lips and the gums. The histopathological study indicated that leukoplakia is often associated with hyperkeratosis, acanthosis, dyskeratosis and parakeratosis. The atypical changes of the cells observed during the examination included polymorphism, vacuolization and structural alterations of the nuclei and chromatin such as excessive growth, deformation, picnosis and hyperchromy.

Clinically, leukoplakia is characterized by the appearance of white, well delimited patches, but not all the white patches that appear on the mouth mucosa are leukoplakia. The diagnosis ought to take into account both the clinical signs and the morphological findings.

Résumé

ÉTUDE CLINIQUE-HISTOPATHOLOGIQUE DE LA LEUCOPLASIE DE LA BOUCHE

Les auteurs analysent les aspects cliniques et morphologiques de la leucoplasie de la bouche dans les 39 cas examinés. C'est là 1.3% des malades qui suivraient un traitement au cours de cette même période.

Cette affection est plus fréquente chez les hommes (33) que chez les femmes (6). L'âge moyen des malades est de 45 ans. La localisation plus fréquente de l'affection se situe dans la muqueuse buccale, les lèvres et les joues. L'étude histopathologique a montré que la leucoplasie s'associe fréquemment à la hyperkératose, à l'acanthose, à la dyskératose et à la parakératose. Les modifications atypiques de cellules observées pendant l'examen se rapportent au polymorphisme, à la vacuolisation ainsi qu'à des altérations structurales du noyau et de la chromatine telles que déformation, accroissement, ptose et hyperchromie.

Du point de vue clinique, la leucoplasie se caractérise par la manifestation de taches blanches bien délimitées; toutefois, non chaque tache blanche qui apparaît sur la muqueuse buccale est une leucoplasie. Le diagnostic de la leucoplasie, à l'avavis des auteurs, est un diagnostic clinique-morphologique.

DISA TË DHËNA STATISTIKORE MBI SËMUNDJET E APARATIT URINAR NË FËMIJËT E SHTRUAR

— MINELLA NINI —

(Spitali i rrëhit – Sarandë)

Në materialin që po paraqesim kemi nxjerrë disa të dhëna për sëmundjet e apparatit urinar në fëmijët, të kuruar në spitalin e Sarandës për periudhen qershori 1972 – qershori 1974. Gjatë kësaj periudhe janë kuruar 1.955 fëmijë me sëmundje të ndryshme të moshës gjëri në 14 vjeç. Nga këta 115 fëmijë në kartela figuronin me diagnozë kryesore për sëmundje renale, pra 5.8 për qind e të gjithë fëmijëve të shtruar. Përvec këtyre 115 fëmijëve me sëmundje kryesore renale, në kartela bëhej fjalë për patologji të apparatit urinar si diagnozë shoqëruuese edhe në 34 fëmijë të tjere. Kështu shifra e përgjithshme arrin në 149 (7.6 për qind) fëmijë të sëmurë.

Shumë herë po hohet se infeksionet e rrugëve urinare janë të shpejtë e të rëndësishme në patologjinë pediatrike (1,4). Ka autorë (5) që venë në dukje se 5 për qind të fëmijëve të sëmurë të shtruar në spital dhe poliklinikë vuajnë nga sëmundje renale. Po ashtu një autor tjetër (3) referon se në vitin 1962 nga gjithë fëmijët e shtruar 14 për qind vuanin nga sëmundje të sistemit urinar, ndërsa në vitin 1976 vuani 5.1 për qind e fëmijëve të shtruar.

Rastet sipas diagozave

Pasqyra nr. 1

Diagnоза	Pielocistit akut	Pielocistit kronik riaragjik	Cistit hemoragjik	Pielonefrit akut	Glomerulo nefrit akut	Glomerulo nefrit kro- nik riaku- tizuar	Kal- kulo- zë
Raste	66	22	2	3	4	1	17
%	57.4	19.1	1.8	2.6	3.4	0.8	14.9

Rastet me kalkula kanë qënë: vezikale – 3, ureterale të majtë – 2, të djathtë – 1, renale të majtë – 5, të djathtë – 6, kalkula të shoqëruara me hidronefrozë – 2.

Nga sa më sipër bie në sy se përqindjen më të madhe në sëmundjet renale të kuruar e zënë infekzionet e vijave urinare dhe sidomos infekzionet akute. Gjithashtu bie në sy se përgjithesishët është përdorur termi pielocistit, pa ndarë veg pilite, cistite e cistopielite. Kjo vjen nga vështirësia për t'i ndarë këto në klinikë, gjë që vihet në dukje edhe nga autorë të tjierë (1).

Nga të dhënët tonë, infekzionet renale të marra veg kanë zënë 4.6 për qind të sëmundjeve të fëmijëve.

Nga materiali ynë del se në një përqindje jo të vogël, e krahasuar me sëmundjet e aparatit urinar të kuruar, është hasur dhe uroilitaza, e cila është gjetur më e shprehur në veshkë sesa në vijat urinare apo vezikale. Duke nxjerë përqindjen në raport me gjithë fëmijët e shtruar në spital gjatë periudhës në studim (1.955 fëmijë) rezulton se 0.85 për qind të të gjithë të shtruarve në spital kanë rezultuar me uroilitazë. Një autor (ciuar nga 5) referon se në 22.000 fëmijë të sëmure, të vizituar në poliklinikë, si diagnozë primare, neutrilitaza është vendosur në 0.06 për qind të rasteve, në të njëjtën kohë nga 2010 autopsi u gjetën gurë në 7.9 për qind të rasteve, gjë që tregon për vështirësinë e diagnostikimit klinik të uroilitazës në fëmije edhe kur shoqërohet me radiografi direkte, sepse me një klishe mund të mos kapet kalkula (2).

Të ndarë sipas tremujorëve, të dhënët i paraqesim në pasqyrën nr. 2.

Fëmijë të kuruar sipas tremujorëve

Tremujori	I	II	III	IV
Raste	22	37	33	23
Përqindja	19.2	32.2	28.7	20.0

Pasqyra nr. 2

Nga kjo pasqyrë vërehet se sëmundjet renale kanë qënë më të shprehura në tremujorin e dytë dhe të tretë të viti. Në pasqyrën nr. 3 paraqesim të dhënat sipas moshave të fëmijëve me sëmundje renale.

Pasqyra nr. 3

Grup — moshat	0 – 1 vjeç	2 – 3	4 – 7	8 – 14
Raste	10	17	47	41
Përqindja	8.7	14.8	40.8	35.7

Në pasqyrën e mësipërme, fëmijët latantë paraqiten me përqindje të ulët. Por po të kemi parasysh 34 rastet e përmëndura me lart, tek të cilët patologjia renale është gjykuar si diagnozë shqeruese (shumica që cilëve i përkasin fëmijërisë së parë dhe infekzionit të vijave urinare) ka një përpunje të dhënaash me autorin që referon se «infekzionet e rrugëve urinare në fëmijët janë të shpeshta në mënyrë të vegantë në moshën e latantit» (1).

Sipas sëksit rezulttonin 33 meshkuj (28.7 për qind) dhe 82 femra (71.3 për qind), pra vërehet një mbizotërim i sëmundjeve renale e kryesishët i infeksioneve renale në femrat.

Fëmijët e kuruar kanë qenë 72 (62.6 për qind) qytetarë dhe 43 (37.4 përqind) fshatarë. Në përfundim të trajimit, fëmijët janë përshkruar me këtë dekurs: shërim 70, përmirësim 25 dhe gjendje e pandryshueshme 20 raste.

Përsa u përket klinikës dhe ekzaminimeve të bëra në fëmijë, në këtë punim ne nuk i vumë për detyrë vetes të thelohemit, por megjithatë ne nxorëm disa të dhëna, nga të cilat dalin edhe disa konkluzione, që na vlejnë në vijim të punës sonë.

Nga simptomat e vlerësuarë më shumë, në 115 kartelat përshtaktuhen fenomenet dizurike (polakiuri, djeqie gjatë urinimit etj.), dhermbjet e kokës, të vjellat, marje mëndish dhe epiemat siç paraqiten në pasqyrën nr. 4.

Pasqyra nr. 4

Simptomat në raport me 115 fëmijët me sëmundje të sistemit urinar

Simptomat	Fenomene dizurike	Dhembje kokë	Të vjella	Marje mëndish	Edëna
Raste	85	35	25	18	10
Përqindja	74.0	30.4	21.7	15.7	8.7

Pra tek fëmijët e shtruar me sëmundje të ndryshme urinare, simptomat më të shprehura kanë qenë fenomenet dizurike dhe dhembja e kokës,

Përsa u përket ekzaminimeve, që kanë lindje me aparatin urinar, nxorrem të dhëna për urinen komplet, provën e Addis dhe Zimnicki, Azotemi, urokulturen, kulturën nga gryka për kokë dhe ekzaminimet radiologjike. U vërejt se në të gjitha rastet rezultonte se urina komplet ishte bërë disa herë në çdo fëmijë dhe në sediment, përvet elementëve të bardhë, në 22 raste kishim të bënim me hematuri makro apo mikroskopike. Azotemia iu ishte marrë 34 fëmijëve dhe në dy raste rezultonte mbi shifrat normale.

Nga 90 rastet e kërkimit të kokeve në grykë, vetëm në tre raste përgjigja kishte ardhur pozitive (në dy raste statifikokë dhe në një rast streptokokë), ndërsa në rastet e tjera, përgjigja ishte negative.

Përsa i përket ekzaminimit radiologjik, në 72 fëmijë janë bërë radiografi direkte e sistemit urinar dhe në 17 prej tyre rezulton me kalkula. Rasteve që kanë rezultuar me kalkula renovezikaletë në radiografinë direkte u është bërë edhe pielografia dhe në dy raste është konstatuar hidronefrozë.

Trajtimi bazë, sipas diagnozave. — Përsa i përket trajtimit të fëmijëve me sëmundje renale u nxorren disa të dhëna për numrin e antibiotikëve të përdorur, për mënyrën jhe shpeshësinë e përdorimit të tyre dhe të dezinfektantëve urinare, të cilat paragjen në pasqyrën nr. 5.

Pasqyra nr. 5

Rastet sipas diagnozave								Numuri i përbashkët i rasteve.
Numri i anti-biotikëve të përdorur	Piellocistit akut	Piellocistit kronik riakutizuar	Cistit hemoragjik	Kalkuloza (infeksionet e tyre)	Piellonefrit kronik i riakutizuar	Glomerulo nefrit akut	Glomerulo nefrit kronik riakutizuar	
1	36	7	1	3	1	1	1	50
2	18	12	—	7	2	—	—	39
Mbi 2	12	3	—	7	—	3	—	25

Nga të dhënat e paraqitura në pasqyrën nr. 5 vërejmë se në 50 raste (për të gjitha diagnozat) është përdorur vetëm një antibiotik përrarrijen e përmirësimit apo shërimit të të sëmurit, ndërsa në të njëjtën kohë, në 64 raste është dashur të pëndoreshin dy o më shumë antibiotikë në mënyrë ciklike që të arruhej rezultati, megjithëse në vërejtëm nëpër korelat se në disa raste përdorimin e antibiotikëve të tjerë e kanë diktuar dhe infeksione të tjera që kanë shoqëruar fëmijën gjatë qëndrimit në spital. Megjithatë, edhe në këtë rast ne nixierim konkluzionin se duhet theluar më shumë në medikamentin që do të përdorim në filim, duke u udhëhequr sidomos nga kërkimet bakteriologjike.

Të dhënët rrëthi antibiotikëve kryesore të përdorur, të klasifikuar sipas diagnozave, paraqiten në pasqyrën nr. 6.

Pasqyra nr. 6

Medikamenti	Nuni i rasteve sipas diagnostikeve							
	Piellocistit akut	Piellocistit kronik ria-kutizuar	Cistit hemoragjik	Kalkuloza (infeksionet e tyre)	Piellonefrit kronik ria-kutizuar	Glomerulonefrit akut	Glomerulonefrit kronik ria-kutizuar	Nr. përbashkët i rasteve
a	1	2	3	4	5	6	8	9
Chloramfenikol	50	12	—	11	2	3	1	79
Tetracyclinë	13	5	—	4	—	1	—	23
Nitrofuradantinë	20	8	—	12	1	1	—	42
Streptomicinë	8	—	—	—	—	—	—	8
Bipenicilinë	10	5	1	4	—	4	—	24
Eritromicinë	9	3	—	2	—	2	—	16
Ceporeks	—	—	—	—	1	—	—	1
Negram	—	—	—	—	1	—	—	1

Nga të dhënat e paragitura në pasqyrën e mësپerme vërehet se jëndrim më të gjëre ka pasur kloramfenikoli me 79 raste, në vend të lytë eshtë përdorur nitrofuradantina, pastaj bipenicilina e tetrackolina. Në 64 raste të infeksioneve renale apo 56,7 për qind të tyre, trajtimi është illuar me kloramfenikol. Nga këto të dhëna, si dhe nga arritura e rezultave të mira nga përdorimi i vetëm një antibioticu mund të nxjerrin rastësive të mirë konkluzioni se në infekzionet e vijave urinare, kloramfenikoli ka efektin më të mirë.

PERFUNDIME

1) Patologjia urinare ze një vend të rëndësishëm në moshën pediatrike. Në spitalin tonë ajo përbën 5,8 për qind të rasteve. Vëtem infeksionet renale kanë zënë shifrën 4,6 për qind të rasteve.

2) Shtruar.

2) Sëmundjet e apparatit urinar kanë qënë më të shprehura në tre-njorin e dytë e të tretë të vitit si lhe në moshën 4-7 vjeç.

3) Fenomene dizurike në sëmundjet e apparatit urinar edhe në fëmijë janë të shprehura dhe zënë vendin e parë në shenjat kryesore 74,0 për qind të rasteve.

4) Në 56,7 për qind të rasteve ka qënë e nevojshme përdorimi i më shumë se një antibiotiku, kryesisht për sëmundjen e apparatit urinar në formë ciklike.

5) Antibiotiku më i preferuar ka qënë kloramfenikoli, si në përc
rimin total të tij, ashtu dhe në fillimin e kurimit të infeksioneve u
nare.

Dorëzuar: në redaksi më 15 maj 19

B I B L I O G R A F I A

- 1) Bekteshi S. : Pediatria. Tiranë, 1974, vëll. II.
- 2) Fattorusso V. : Vademekum mjekësor. Tiranë 1970, 261.
- 3) Ignatovo M. S., Vjettshev E. : Sovremenije prijedstovljenje o nozologji zabolev
nija poçejk u djetelj. Pediatria 1978, 3.
- 4) Kellc W., Wiskof A. : Trattato di pediatria. 1970, vëll. II. 1384.
- 5) Safigenko F.N. e bپ. : Zabolevanie poçejk u djetelj. 1972, 3.

S u m m a r y

STATISTICAL DATA ON URINARY AFFECTIONS IN HOSPITALIZED CHILDREN

Some statistical figures are presented of urinary diseases in children admitted
to the hospital of Saranda during the period between 1972 and 1974. The affection
occurred in 5.8 to 7.6 percent of all the children aged from 0 to 14 years, while the
urinary infections constituted 4.8 percent of the cases.

Females and town children predominated.

Chloramphenicol gave the best therapeutic results in the infection of the urinary
system.

Most of the children with urinary infections were aged between 4 and 7 year

R é s u m é

DONNÉES STATISTIQUES SUR LES MALADIES DE L'APPAREIL URINAIRE CHEZ DES ENFANTS HOSPITALISÉS

L'auteur de cet article présente des données statistiques relatives aux affection
observées chez des enfants hospitalisés à Saranda pendant les années 1972-1974.
Cette affection concerne de 5.8 à 7.6 pour cent de tous les enfants âgés de 0 à 14 ans.
Cet état que les infections urinaires ne couvrent que 4.8 pour cent des cas.

On relève une fréquence plus grande de la maladie chez le sexe féminin et
surtout parmi les enfants des centres urbains.

Dans l'infection du système urinaire, les meilleurs résultats thérapeutiques ont
été obtenus avec le Chloramphénicol.

La plupart des enfants, ayant une infection urinaire, étaient âgés de 4 à 7 ans

HIGJIENË DHE EPIDEMIOLOGJI

MBI DIFERENCIMIN BIOKIMIK TË SHIGELAVE PËRJ GJINIVE TË AFERTA NË PUNËN E PËRDITSHME

— Esat Duraku —

(Instituti Kërkimor i Mjekësisë Ushtarakë)

Në qoftë se në fushën e kërkimeve shkencore, metodika të shumta biokimike kanë gjetur një përdorim të gjithë për identifikimin e Enterobakteriaceve, në laboratorët e zakonshëm të bakteriologjisë klinike, të ngarkuar nga një punë voluminoze, ato përfloren rrallë ose pjesërisht. Edhe sot e kësaj ditë vazhdonin përpjekjet për hartimin e skemave identifikuase sa më të përshtatshme, duke përdorur vetëm disa teste biokimike kryesore, që kanë një vlerë të vegantë konfirmuese ose përashtuese. Shpesh për të lehtësuar ngarkesën përdoren terrenet e gërmëshëtuara si Hajna, Kliger, ure-indoli, manit-lëvizja etj.

Zgjedhja ose zbatimi i një skeme diagnostikuese nuk bëhet lehtë sepse jo vetëm që autorë të ndryshëm propozojnë skema të ndryshme (3, 4, 5, 6, 8, 9, 10), por edhe për arsyen e kuqshët e laboratoreve të veganta nuk janë të njëjlojta.

Pas rije pune shumëvjeçare në lëmin e identifikimit të shigelave dhenë bazë të përvjoses së fituar nga gabimet diagnostike (1, 2, 3), ne harputum dhe eksperimentum një skemë që na u duk e përshtatshme përkëtë qëllim. Ajo përbëhet nga 9 teste biokimike dhe nga prova e lëvizjes. Në zgjedhjen e këtyre testeve u nisëm kryesish nga nevoja e diferençimit të atyre gjinive të familjes së Enterobakteriaceve, të cilat, në terrenet Hajna ose Kligler, mund të kenë pamjen e shigelave dhe mund të aglutinojnë me serumet antishigela.

Qellimi i këtij punimi eshtë që në bazë të analizës të një materiali të gjithë, të nxirret vlera e kësaj skemë në identifikimin e shigelave dhenë dallimin e tyre prej gjinive të aferta. Analiza do të përqendrohet kryesisht në shtamet që aglutinuan me serumet antishigela, por që u përashtuan nga gjinia e shigelave për sjelljen e tyre biokimike.

MATERIALI DHE METODAT

Gjatë vjetëve 1974-1977, në bazë të skemës së lartpërmëndur, kemi ekzaminuar 1.546 shtame, të cilët, në terrenin Kligler, kanë pasur paramjen e shigelave dhe kanë aglutinuar me serumet antishigela. Janë përdorur të njëjtat teknika biokimike që janë përshtatuar në punimet tona të mëparshme (2, 3); vrojtimi për fermentimin e sheqernave ka zgjatur vetëm dy javë.

REZULTATET

Nga 1.546 shtame të ekzaminuar si të dyshimtë për shigela, 1.470 (95,5%) patën një sjellje biokimike karakteristike për shigelat. Resultatet jepen në pasqyrën nr. 1.

Pasqyra nr. 1

Pasqyra Nr. 1: Sjellja biokimike e 1476 shtameve
Shigella në bazë të 40 testeve.

Nëngrupet Shigelave	Numri i shtameve ekzamin. Gaz nga	Glykosa Laktosa	Maniti	Dulciti	Ksiloza	Galicini	Indoli	Fenilalanina	Lizina	Lëvizja
Sh. flexneri	1243 (84,2%)	-	+	-	-	-	+	-	-	-
Sh. sonnei	112 (7,6%)	-	(+)	+	-	-	-	-	-	-
Sh. schmitzi	90 (6,2%)	-	-	-	-	-	+	-	-	-
Sh. boydi	31 (2,1%)	-	-	+	-	+	+	-	-	-

Legjenda:

(+) rezultat pozitiv brenda ditës; - rezultat negativ

x . vëtëm 3 shtame boyd fermentuan dulcitin me vonesë

Astrejë prej 1.476 shtameve nuk prodhoi gaz nga fermentimi i glukozës, nuk zbertheu salicinin, nuk dekarboksiloi lizinë dhe nuk dezaminoi deri në të 9-tën, vëtëm nga Sh. sonnei; të 90-t shtamet e Sh. schmitzi qenë manitnegativë, ndërsa të gjithë pjesëtarët e nëngrupave të tjerë e fermentuan manitin brenda ditës; dulciti u fermentua me vonesë nga 3 shtame të Sh. boydi; ksiloza u fermentua brenda ditës vëtëm nga 19 Schmitz prodhuat indol, ndërsa asnjë shtam e nëngrupit Sonne nuk qe rëngrupet përkates të shigelave, prandaj këto shtame u konsideruan shigela.

70 shtame (4,5%), në bazë të njërit ose disa testeve, u përijashtuan nga gjinia e shigelave pavarësish nga afersa e tyre serologjike me shigelat. Resultatet biokimike të fitura janë përmblehdur në pasqyrën nr. 2.

Pasqyrë Nr 2: Sjellja biokimike e 20 shtameve që aglutiunon
në serumet antishigela, por që u përjashtuan nga
gjinia e shigelave.

Coz aglukozor	Laktosaz	Maniti	Dulciti	Ksiloza	Salicini	Indoli	Fenilalanina	Lizina	Lëvizja
+	-	+	(+)	-	+	(+)	-	(+)	-
52	18	4	26	40	59	0	11	13	6
							51	51	1
							18	17	6
							47	30	40
							43	43	47
							57	27	18
							25	39	31

Sikur të analizojmë vetëm rezultatet e fituara pas një inkubimi prej 24 orësh del se 39 shtame qenë të lëvizshëm, 13 dezaminuan fenilalaninën, 27 – dekarboksilan lizinën, fermentuan salicinin 17 shtame, laktozën – 4, dulcitin – 13 dhe ksilozën 51; 52 shtame e zbërthyen glukozën duke prodhuar gaz.

Në skemat e mëposhtme del më mirë në pah gërshtëtimi i këtyre testeve ndërmjet tyre si dhe vlera përjashtuese e testeve të vegantë. Për bazë janë marrë vetëm rezultatet pas 24 orëve inkubimi.

Shih Skemat I-VI

Rezultatet e pasqyrura në këto skema tregojnë se vetëm 2 shtame me prej të 70-vë janë përjashtuar nga gjinia e Shigelave, duke u bazuar në një test të vetëm: në dezaminimin e fenilalaninës ose në fermentimin e salicinit; të 68 shtamet e tjerrë janë përjashtuar nga gjinia e Shigelave, duke u mbështetur në rezultatet e 2 ose mië shumë prave.

Gjithash tu vërehet se 62 shtame prej të 70-vë, pra afër 90% e tyre, do të mund të përjashtohen nga shigelat, pas 24 orëve inkubimi, vejnë në bazë të provave të lëvizjes, lizinës, fenilalaninës dhe salicinit; 5 shtame të tjerrë u përjashtuan si shtame gazogjene që fermentonin laktozën, ksilozën, manitin ose prodhonin indol; 3 shtamet e fundit u përjashtuan nga gjinia e Shigelave si shtame që aglutinonin me serumin e për Sh. schmitzi, por që fermentonin manitin dhe ksilozën.

Sipas tëresisë së vëtive biokimike që kanë paragjitur këta 70 shtame, 60 pre tyre (85.7%) ka qenë e mundur të inkudrohen në disa nga gjinjtë e tjera të familjes së Enterobakteriaceve, ndërsa për 10 të tjerrë (14.3%), përcaktimi i pozitës taksonomike ishte i pamundur. Shpërndarja e këtyre 70 shtameve sipas illoj dhe shkallës së aglutinimit me serumet antishigela jepet në pasqyrën nr. 4.

Kjo pasqyrë tregon se shumica e shtameve (74.3%) kanë aglutiunuar me serumin polivalent për Sh. flexneri, ndërsa vetëm një pakicë e tyre (5.7%) – me serumin për Sh. Sonnei; aglutinimet me serumet për Sh. Schmitzi dihe Sh. boydi janë hasur përkatesisht në 8.6% dhe 11.4% të

Pasqyra Nr3: Shpërndarja e 70 shtameve sipas gjinive të ndryshme të familles së Enterobacteriacee

	Numri i shtameve	Gaz nga glukozë	Laktaza	Maniti	Dulciti	Ksiloza	Salicini	Indoli	Fenilanina	Lizina	Lévizja
Escherichia coli	17(24,3%)	+	v	+	v	v	v	+	-	v	+
Alkalescens-Dispar	6(8,6%)	-	-	+	-	+	-	+	-	+	-
Hafnia-Enterobacter	24(34,3%)	v	+	-	+	v	-	-	v	v	+
Providencia-Morganella	13(18,5%)	+	-	-	-	-	-	-	+	-	+
Të pa identifikuar	10(14,3%)										

Legjenda: v = + (+) dhe -
+/- = shumica pozitive

Pasqyra Nr4: Shpërndarja e 40 shtameve sipas illojt dhe shkallës së aglutinimit

Numri shtameve	Aglutinuan me serumet anti:					Shkalla e aglutinimit në xham	
	Flexner (1-6)	Sonne (SR)	Schmitz	Boyd (1-12)	(++)		
40	52 (74,3%)	4 (5,7%)	6 (8,6%)	8 (11,4%)	25 (35,7%)	35 (50%)	10 (14,3%)

- Legjenda: (++) - aglutinim i plotë e i shpejtë
- (+) - aglutinim i mirë, me pak vonesë
- (+) - aglutinim i dobët, me vonesë

rasteve. Shkalla e aglutinimit në xham ka qënë e mirë në shumicën e rasteve; vetëm 10 shtame (14,3%) aglutinuan dobët dhe me vonesë.

DISKUTIM

Përaktimi i familjes së Enterobakteriaceve dhe i gjinive të saj mbështetet vetëm në kriteret metabolike, ndërsa përaktimi i serotipave brenda gjinisë bazohet në përbërjen antigenike të tyre (4, 7, 9, 10). Vlerështës theksohen se ndërmjet serotipave të një gjinie, madje dhe ndërmjet serotipave që u përkasin gjinive të ndryshme, ekzistojnë lidhje të shumta serologjike (4, 7, 9).

Ky studim tregon se frekuencë e shtameve që kanë afërsi antijeni-ke me shigelat, por që u përkasin gjiniive të tjera, është përkrahësish jo e lartë; në 1546 shtame që në Kliger patën pamjen e shigelave dhe që aglutinuan me serumet anti shigela, vërem 4,5% e tyre nuk qenë të tillë. Në një studim të mëparshëm të bërë prej nesh gjatë periudhës 1965-1970, kjo shpeshtësi ka rezultuar ende më e ulët – 1,8% (3). Disa autorë (5), pasi ekzaminuan 2,420 shtame të diagnostikuar si shigela, vërejtën se 170 prej tyre (7,1%) nuk qenë të tillë.

Lidhje më të theksuara serologjike me shigelat ka gjinia *Escherichia coli*, dhe sidomos biotipat anaerogjene të palëvzihënë të *Escherichia coli*, që i përkasin Alkalescens-Dispar (4, 7). Këto janë lidhjet që njihen dhë që janë përshtakuar më me hollësi. Lidhje serologjike me shigelat kanë dhei gjimi të tjera të familjes së Enterobakteriaceve si *Hafnia* dhe *Providencia* (5, 6, 7, 8). Materiali ynë (pasqyra nr. 3) tregon si më të shpeshtë në këtë drejtim shtamet *Hafnia*-Enterobacter (34,3%), por ky rezultat duhet marrë me rezervë, sepse 14 shtame nga 24 janë izoluar gjatë një shpërthimi epidemik më persona me çrrëgullime intestinale akute; në vend të dytë për nga shpeshtësia renditet *Escherichia coli* që së bashku me *Alkalescens-Dispar* përbëjnë 32,9% të këtyre shtameve; një peshë jo të vogël kanë dhei të shtamet *Providencia*-*Morganella* (18,5%). Duhet theksuar se ky kompleks prej 10 testesh nuk lejon diferençimin e *Hafnia* nga *Enterobacter* dhe as të *Providencia* nga *Morganella*; po ashtu ky kompleks që i pamjaftueshëm për përcaktimin e pozitës taksonomike të 10 shtameve të tillë (14,3%).

Pikësyrimi i këtij studimi, sic u tha më lart, ka qënë vlerësimi i këtij kompleksi prej 10 testesh në identifikimin e shigelave dhe në differencimin e tyre prej gjinive të afërtë. Po të analizohen rezultatet e paraditura në skemat 1-6 del në pah se 62 shtame prej të 70-ve, pra afro 90% e tyre, do të mund të përfashoheshin nga shigelat pas 24 orëve inkubimi, vërem në bazë të 4 provave: lëvizjes, lizinës, fenilalanines dhe salicinit.


Në një studim të bërë prej nesh gjatë periudhës 1965-1970 mbi 616 shtame shigelash (2), vërem njëri prej tyre prodhoi gaz; po ashtu, asnjë nga 1476 shtamet që u provuan në këto 10 teste dhe që u sollien si shigelë tipike nuk prodhoi gaz. Kjo gjë tregon se shtamet gazogjene të Sh. flexneri serotip 6, që është i vetmi që mund të prodhojë gaz, janë jashtëzakonisht të rrallë në vendin tonë. Në rast se do të bazoheshim në provat e rëndësishme të larëpermëndura dhe në prodhimin e gazit nga glukoza, nga 70 shtamet do të ishin përijashtuar 67 dhe mundësia e gabinimeve diagnostike do të reduktohet në 0,2% të rasteve; vërem 3 shtame, në 1,546 do të ishin konsideruar gabimisht si shigela. Mendoj se këto pesë teste mund të konsiderohen si të mjaftueshëm për qëllime diagnostike në laboratorët e ngarkuar me një punë voluminoze të përditshme që përballohet me vështirësi.

Pesë testet e tjerë që përfshihen më këtë kompleks patën rëndësi për dallimin e nëngruupeve dhe të serotipave të shigelave ndërmjet tyre; deri në një farë mase ato ndihmuant gjithashu në përcaktimin e pozitës taksonomike të shtameve që kishin ngashmëri biokimike dhe afersi antigenike me shigelat.

Pasqyra nr. 5


Skemat 1-VI: Resultatet e kombinimit të disa testeve që kanë një rëndësi të veçantë në përjashtimin e Shigelave, pas një inkubimi prej 24 orësh.

I Të lëvizshëm: 39 shtame




Lejenda: Lys = Lizinë; Phenyl = fenilalaninë; Lac = Laktozë; Sal = Salicin. Shpjegat tregon rezultatin pozitiv krahas lëvizjes.

II Fenilalanin pozitive 6 shtame*




* = 7 shtame të tjere, fenilalaninë pozitive, kombinuar me lëvizjen.

III Lizinë pozitive 14 shtame*



Xyl = Xilitoxa; * = 13 shtame të tjere lizine pozitive kombinuar me lëvizjen.


IV Salicin pozitive 3 shtame*



Man = Maniti x - 14 shtame të tjera sa këtij pozitive kombinuar me lëvizjen dhe lizinen e aglutinojnë me serum anti sh. schmitzi


xx - shtam që aglutinojnë me serum anti sh. schmitzi

V Gas nga glukoxa 5 shtame*



Ind = Indol x - 47 shtame të tjere gazojnë kombinuar me lëvizjen, fenilalaninë, lizinen e salicinin. xx - shtam që aglutinojnë me serum anti sh. boydi polivalent.

VI + man, + xyl 3 shtame



Aglutinuan me serum per sh. schmitzi

KONKLUSIONE:

1. — Kompleksi prej 10 testesh i propozuar nga autori është i vlefshëm për identifikimin e shigelave dhe për dallimin e tyre prej gjini-vje që kanë afërsi antigenike me to.

2. — Testet e gazit nga glukoza, të lëvizjes, fenilalaninës dhe të salicinit janë testet kryesore për përjashtimin e shtameve që kanë afërsi antigenike me shigelat. Ky kompleks prej 5 testesh mund të konsiderohet si i mjaftueshmëri në laboratoret e ngarkuar me një punë voluminoze të përditshme.

3. — Shpeshtësia e shtameve, që në Kligler kanë pamjen e shigelave, që aglutinojnë me shtumet antishigela, por që nuk janë shigela, është përkrahësht e ulët (4.5%); 3/4 e këtyre shtameve aglutinuan me serumin polivalent të Sh. flexneri.

4. — Nga të 70-të shtamet që paraqitën afërsi antigenike me shigelat, u përcaktuun si *Escherichia coli* — 24.3%, si *Alkalalescens-Dispar* — 8.6%, si *Hafnia-Enterobacter* — 34.3%, si *Providencia-Morgella* — 18.5% dhe si të pa identifikuar — 14.3%.

Dorëzuar në Redaksi më 25.VII.1978

BIBLIOGRAFIA

- 1) Duraku E. : Mbi diferençimin e gjinisë së shigelave. Buletini i Mjekësisë Ushtarakë 1970, 1, 56.
- 2) Duraku E. : Studim mbi shigelat gjatë periudhës 1965-1970. II. Veoritë blokimi të 616 shtameve shigela. Buletini i UT — Seria shkencat Mjekësore 1974, 2, 73.
- 3) Duraku E. : Një studim mbi shigelat dhe disa të dhëna kliniko-epidemiologjike mbri shigellozat (1965-1970). Dizertacion i paraqitur për marrjen e gradës shkençore të Kandidatit të Shkencave. Tiranë 1976.
- 4) Edwards P. R., Ewing W. H. : Identification of Enterobacteriaceae: 2-nd ed. Minnesota 1962.
- 5) Emeljanov P. I. : Racionalizacia shemini identifikacii shigell. Zhurnal Mikrobiol. 1974, 2, 44.
- 6) Honenko N. A., Kisileva B. S. : Diagnoscheskija oshibki pri bakteriologičeskom issledovanii disenterii. Zhurnal Mikrobiol. 1971, 1, 31.
- 7) Kauffman F. : Enterobacteriaceae. E. Munksgaard. Copenhagen 1954. (Botim rusisht 1959).
- 8) Krjukov J.M. dhe Dr. : O biohimiqeskoj identifikaciji bakterij semejstva *Klebsiell*. Soobshchenie I: Identifikasi, acta tek nazivajemih atipiqnih kultur shigell. Labor. Dello 1974, 2, 92.
- 9) Le Minor L. : Le diagnostic de laboratoire des Enterobactéries 3-ème Edit. de la Tourelle 1969.
- 10) Martin W. J. : «Enterobacteriase»: Në manual of Clinical Microbiology» të American Society for Microbiology, Bethesda md. 1970, 151.

Summary

BIOCHEMICAL DIFFERENTIATION OF SHIGELAE FROM OTHER RELATED GENERA IN THE ROUTINE LABORATORY PRACTICE

A set of 10 tests was studied with the purpose of assessing its value in the routine identification of shigellae and their differentiation from other related genera. The tests were tried on 1546 strains which on the Kligler medium had the aspect

of shigellae and agglutinated with shigella antiseraums. Of these, 1476 (95.5%) reacted biochemically as shigellae and were identified as such, while 70 (4.5%) were excluded from the genus on the grounds of their behaviour in one or more of these tests.

The analysis of these 70 strains and their reactions after 24 hours of incubation indicated that of the complete set of 10 tests 5 were essential to confirm a strain as shigella or to exclude it from the genus: the tests were: motility, phenylalanine deamination, lysin decarboxylation, fermentation of salisin and production of gas from glucose.

The remaining five tests are useful for the differentiation of the shigella sub-groups among them. They also help, to a certain extent, to determine the taxonomic position of strains that appear similar to shigellae, but not to distinguish Hafnia from Enterobacter Providencia from Morganella.

Of the 70 strains that had antigenic relationships with the shigellae but were excluded from the genus, 24.3% were identified as Escherichia coli, 8.6% as Alkalescens-Dispar, 34.3% as Hafnia-Enterobacter, and 18.5% as Providencia-Morganella; 14.3% could not be identified. Most of these strains (74.4%) agglutinated with Flexner polivalent shigella antiserum.

Résumé

DIFFERENTIATION BIOCHIMIQUE DES SHIGELLAES DES AUTRES GENRES PROCHES DANS LA PRATIQUE QUOTIDIENNE

Un complexe de dix tests ont été étudiés afin de déterminer leur valeur dans la pratique courante d'identification des Shigellae et leur différenciation des genres, qui leur sont proches. Les tests ont été expérimentés sur 1546 souches, qui, dans un milieu Kligler, ont revêtu l'aspect de Shigellae et se sont agglutinées avec les antisérum Shigellae. De leur nombre, 1476 (95.5%) présentaient une réaction biochimique caractéristique aux Shigellae, tandis que 70 (4.5%) d'entre eux furent exclus du genre en raison de leur comportement dans un ou plusieurs tests.

L'analyse des 70 souches, et leur réaction après 24 heures d'incubation, ont indiqué que 5 tests seulement furent en mesure d'attribuer la qualité de Shigellae à une souche ou de déterminer son exclusion du genre. A cette fin furent employés les tests de motilité, de déamination de la phénilananine, de décarboxylation de la lysine, de fermentation de la salicine et de production de gaz du glucosé.

Quant aux autres cinq tests, ils sont utiles pour différencier entre eux les sous-groupements de Shigellae. Ils servent aussi, jusqu'à un certain point, à déterminer la position taxonomique des souches qui ressemblent à des Shigellae, mais non pas à distinguer Hafnia de Enterobacter et Providencia de Morganella.

Dès 70 souches ayant des rapports antigéniques avec les Shigellae, mais qui furent exclus du genre, 24.3% ont été identifiés comme Escherichia coli, 0.6% comme Askalescens-Dispar, 34.3% comme Hafnia-Enterobacter et 18.5% comme Providencia-Morganella. 14.3% d'entre eux ne furent pas identifiés. La plupart des souches (74.4%) ont agglutinées avec l'antisérum polyvalent Flexner (1 - 6).

K U M T E S A

NJË RAST ME HIPERPARATIROIDIZËM PRIMAR

— FATOS HARITO, RIFAT SHAHI, ALI A. SULA —

(Institucionet e mjekimit të rrethit Durvës)

Hiperparatiroidizëm quhet prodhimi i tepërt i hormonit paratiroidian (HPT), që passohet me çrrëgullim të metabolizmit të kalciumit dhe fosforit dhe demineralizim të kockave. HPT është një polipeptid me 3 vepri me kryesore: së pari, në kockat fuqizon rezorbimin lakuar, duke gjuar kalciumin, fosfatet etj.; së dyti, në tubulat e veshkave, ku shkakton irritjen e ekskretimit të potasit, natriumit e fosfateve dhe uljen e ekskretimit të kalciumit, magniezit dhe joneve të hidrogjenit (1, 4); së treti, në mukozën e zorrës, duke shtruar thithjen e kalciumit dhe fosforit (10). Për pasojë rritet përqëndrimi i kalciumit në plazëm (hiperkalciemi) dhe shtohet eliminimi i tij në urinë (hiperkalcuri). Kjo e fundit mund të shqerohet me kalcifikime në veshka (nefrokalcinozë) dhe në organe të tjera, me gurë në aparatin urinar etj.

Sipas mbizotërimit të diëntimeve dhe simptomave dallohen këto forma kryesore: forma litiazike, osteotike, digestive, hipertensive, artikulare, e përzjerë, asimptomatike etj. (8).

Po paraqesim një rast hiperparatiroidizmi primar, të shkaktuar nga adenoma e paratiroides. Ne kemi diagnostikuar histopatologjikisht edhe një rast tjeter me adenomë të paratiroides gjatë një biopsie të marrë tek një grua e shtruar në klinikën I të spitalit nr. 2 Tiranë, e cila parashitë fraktura të shumta të kockave.

Paraqitja e rastit

I sëmuri S. S., vjet 17, me profesion murator, u shtrua në repartin e patologjisë të spitalit të Durrësit më 19.XI.1975 me kartellë klinike nr. 9211. Ne shtrrim paraqiste keto anksa: dobësi, mungesë oreksi, të viella, etje, dhembje barku, konstipacion, dhembje trupi dhe koke prej disa muajsh. Objektivisht subfebril, me nutricion mesatar por i zbehtë, mjaft adinamik dhe psikikisht i deprimuar. Të ecurit e tij ishte i vështirësuar jo vetëm nga dobesia e përgjithshme, por edhe nga dhembjet kockore në anësi dhe trung. Klinikisht nuk vëreheshin ndryshime të apparatit të qarkullimit dhe të frysniemarrjes. Në të dy lozhat renale gjendej Giordano-Pasterнаки i lehtë. Artikulacionet ishin të lira. Presioni mbi eshtit acaronte dhembjet. Gjitha ish e thatë, barku i butë. Nga ana paraklinike, të dhënat dhembjet. Gjitha ish e thatë, barku i butë. Nga ana paraklinike, të dhënat urinare nuk ishin të pasura (gjurmë albumine dhe

disa elemente eritro-leukociare nē sediment). Dureza ishte disi e shtuar (1600 ml. nē 24 orë me hipostenuri), azotemia 1 gr $\frac{1}{100}$, kreatinemia 2,6 mgr $\%$, fosfataza alkaline 8,6 ut. Kacemija pa ndryshime (9,8 mgr $\%$). Fundus i syrit pa ndryshime. Duke marrë për bazë këto të dhëna, kuadri i të sëmurit u vlerësua si një hiperparatiroidizem, por nuk u zbuluan ndryshime patologjike të dukshme ose të prekshme nē regionin e përparshem të qafes. Për këtë arsyje u kërkuan të dhëna të tjera ndihmëse, si kontrolla radiologjik i skeletit, dhe ekvilibrimi i plotë elektrolitik. Në ditën e pestë, i sëmuri vdes me shenjat e një insuficience të nprehet kardiovaskulare. Nga të dhënat e kërkuar u arrit të plotësohen kraniografia, ku rezultoi osteoporozë e përhapur, si dhe radiografia e rrugëve urinare, ku vijë nē dukje një hije e vogël radio-opake nē ureterin e majtë.

I sëmuri përcillet nē nekrotomi me diagnozë «Pielonefrit kronik sekondar. Hiperparatiroidizem. Insuficiencë kardio-cirkulatorë, edemë akutë pulmonare».

Nga shqyrtimi i kartelës klinike të një shtrimi të mëparshëm u mblodhën këto të dhëna laboratorike: kalcemi e rritur (12 mgr $\%$) nē tre analizat e para dhe normalizohet miëejshëm; fosfataza alkaline vazhdimi mësht e rritur (9,7-12 ut), fosforemia e ulur (2,4 mgr $\%$), eliminimi urinar i kalciumit i shtuar (5,2 gr/24 orë), natriuria e potasuria pak të rritura, fosforuria nē norme. Elektrolitet e tjera, lipidograma, kreatinemia, aldolaza e glicemja nē vlera normale. Në radiografië e kockave të gjata nuk u zbuluan dëmtimë kockore.

Në nekrotomi (protokoll nr. 206/75) u konstatua: kafka simetrike, gjatë prerjes, të bëjn përshtypie, se sharrohet mjaft lehtë. Trashësia e kockave 0,4-0,7 cm., substancia kompakte paraqitej mjaft e hollë, ndërsa substanca spongjoze e gjëjë. Kockat e kafkës priteshin lehtësish me gërsheërë, ndërsa nē prekje mund të lakoreshin ose të shtypeshin. Edhe brinjet e klavikula ishin mjaft të brishta dhe, nën një presion mjaft të vogël, thyheshin. Mushekëritë ishin edematoze. Paratiroidja e poshtme e majtë ishte e zmadhuar sa një kokë qershje e rrumbullakët, e kufizuar. Në seksion kish ngjyrë bezhë homogjene; nē prekje paraqitej e fortë, kurse nē qendër ishte si e qullët. Paratiroidet e tjera pa ndryshime. Zemra me përmasa dhe formë të zakonshme, hapësirat e majta pak të zgjeruara, endokardi parietal nē atriumin e majtë ishte i trashur dhe kish ngjyrë të bardhë. Mioardi i ventrikulit të majte kish trashësi 1,5 cm., nē të dukeshin pika dhe vija të vogla me ngjyrë të verdhë në të bardhë, sidomos nē septumin ventrikular dhe murin e përparshem. Arteriet koronare dhe aorta nuk kishin ndryshime. Veshkat paraqiteshin pak të zmadhuara, të buta, dekapsuloheshin me lehti, sipërfaqja ishte e lëmuar, me ngjyrë kafe të zbehtë, me disa njolla të kuge të vogla. Në prerje, shtresa kortikale ishte e zbehtë, ndërsa piramidet mjaft hipermike. Shiheshin vijëzime të shumta dhe pikëza fare të vogla, veçanërisht në shtyllat e Bertinit. Në kalicet renale kish disa hemorrhagi të vogla në formë pikash. Në ureterin e majtë gjendej një gur me madhësinë e një kokre misri, me ngjyrë gri të çelët, me sipërfaqje të lëmuar. Organet e tjera nuk kishin ndryshime të rendashme.

Në ekzaminimin histopatologjik u panë këto dëmtime, zemra me strukturë histologjike të lateruar, fibrat muskulare paraqisin distrofi




Foto 1



Foto 2




Foto 3




Foto 4





Foto 5

Foto 6



granulare e në shumë vende ndërprisnin vazhdimesinë e tyre, duke u zëvëndësuar nga fusha indi lidhor të shkrirjet. Në këto fusha kish pllaka të vogla bazofile, me ngjyrë violcë në blu, të cilat kishin formën e fubreave muskulare, por nuk kishin bërhama dhe paraqisnin ndërtim homojen ose mikrogranular. Vërehej një pripje e tyre për tu vendosur në po atë drejtum si dhe tufat muskulare (fig. 1). Në disa prej këtyre plakave, ngjyra ishte shumë e thellë dhe në to shihet pluhur i imët bazofil.

Në ndonjë prej këtyre vatrave kish enë gjaku, në parejet e të cilave gjendesnin depozitimet të imta bazofile granulare, por jo me atë dendësi si në fijet muskulare. Stroma ishte edematoze, me celularizim të zakonshëm, në të shihet distrofi mukoide e indit lidhor dhe e enëve të gjakut. Endokardi ishte i trashur, në të vëreheshin gjithashiu depozitimet të shumta bazofile dhe vendosje subendoteliale, sidomos në atriumin e majte (fig. 2). Në mushkëri, alveolat ishin të mbushura pjesërisht ose tërësisht me lëng oksifil homogjen, qeliza epiteliale të dieskuanuara, makrofage dhe pak eritrocite e leukocite polimorfonukleare. Bronket me mukozë të deskuamuar. Septet paraqiteshin hiperemike, me depozitimet e imta kokrizore bazofile, veganërisht në paritet bronkiale (fig. 3). Në veshkat, glomerulat ishin pjesërisht të lira, por disa prej tyre ishin të zvogëluara dhe me sklerohillanëzë të plotë ose sklerozë periglomerulare. Në qender të tyre vëreheshin depozitimet bazofike, por nganjëherë ato ishin krejtësisht të kalcifikuara (fig. 4). Në këto zona, ku glomerulat ishin të dëmtuara, stroma paraqitej fibroze dhe kish infiltrat të dendura limfocitare, monocitare dhe plazmocitare. Kanalet rreale kishin hapësirë të lirë ose të mbushur me masa mikrogranulare oksifile. Në shumë prej tyre kish masa amorfë bazofile, mikrogranulare ose në formë konglomeratesh të vegjël, ndërsa epitelii kish distrofi të shprehur granulare ose ishte i zhdukur. Shpesh depozitimet kalcike të lartpërmënduna kishin vendosje karakteristike në formë unaze.

Në kocka (pjese nga kafka dhe brinja), struktura histologjike ishte shumë e alteruar. Binte në sy pakësimi dhe zvogëlimi i pilakave kockore si dhe shtimi i indit osteoid, i cili ngjante shumë me indin lidhor të shkriftë. Në këtë ind të shkriftët dhe në afërsi me pilakat kockore shishin qeliza të mëdha, me shumë bërhama, që të kujtojnë osteoklastë (fig. 5). Në këto qeliza, bëthama vendosej në grup, më tepër në qendë të citoplazmës së tyre. Në paratiroiden e majte të poshtme, strukturë histologjike paraqitej e alteruar, shiheshin qeliza të dendura, të vendosura në grupe ose shirita, me citoplazmë në përgjithësi oksifile, me vakuola të pakte në të, pa kufij të qartë me njera tjetrën. Bërhama ishin të rrumbullakta, të ngjyrosura mirë, me kromatinë të imët. Rrekt qelizat ishin vendosur në formë të tillë që të kujtojnë gjendrat. Rrekt qelizave kish disa sinusode të mbushura me gjak. Në një sektor, qeliza paraqisnin fenomene anizokarioze dhe hiperkromazie, por mitozat ishin shumë të rralla (fig. 6). Stroma ishte fare e pakët dhe përbëhej nga shirita të hollë. Në organet e tjera nuk u panë ndryshime të rendësive.

Diagnoza anatomiopathologjike: Adenoma e gjëndrës paratiroide. Hi perparatiroidizëm primar. Osteodistrofi fibrose e gjeneralizuar. Nefrokalcinozë me pielonefrit kronik sekondar. Kalkuli i ureterit të majte Kacinozë e miokardit dhe pulmoneve. Bronkopneumonia katarrale laterale.

D i s k u t i m

Dallohen katër forma hiperparatiroidizmi:

- 1) Hiperparatiroidizmi primar, shkaktohet më shpesh nga adenomat aratiroidiane (60-70%). Ato mund të jenë të vetme ose të shumta, imth të gjenden më shumë se një adenomë, në disa prej paratiroideve poliadenomat). Shpeshtësia e poliadenomave lëkundet shumë në autorë ë ndryshëm nga 3-6% (7) në 60% (8). Në gjetëm vetëm një adenomë ë paratiroiden e majtë të poshtme. Ka të dhëna se hiperplazitë e paratiroideve janë shtuar kohët e fundit dhe përbëjnë afro 50% të rasteve (8). Karcinomat janë më të rralla dhe zënë një përqindje nga 0.7% ë 5%.

- 2) Hiperparatiroidizmi sekondar takohet gjatë insuficencës kronike enale ose malabsorbimeve, që gjinë në hipokalcemi. Hipokalcemia ngacnon gjendrat paratiroide dhe sjell hiperplazinë e tyre, për pasoje, rindoset niveli i kalciumit në gjak (1, 2, 5, 6).

- 3) Hipertiroidizmi i tretë (terciar) është shndërrimi i hiperparatiroidit të shtuar dhe të qëndrueshëm paratiroidian (4, 9).

- 4) Hiperparatiroidizmi kuaternar (apo pseudohiperparatiroidizmi) vjen nga tumore jo të paratiroides, më shpesh nga karcinoma bronkiale, të cilat prodhojnë një substance mjaff të ngjashme me HPT (4, 6, 9). Diagnoza e hiperparatiroidizmit u shtrua klinikisht jo vëtëm mbi bazën e dëmtimeve osteoporotike dhe infiltrimeve kalcike të përhapura në organet, por edhe nga prania e adenomës në njëren nga gjendrat paratiroide. Gjetja e tumorit nga ana klinike është e vështirë dhe shumë e rrallë dhe kjo është një nga shkaqet kryesore që vështirëson diagnozën (10). Edhe në rastin e paraqitur, me gjithë orientimin e drejtë klinik nga prania e shenjave kockore dhe renale, si dhe ndryshimet biokimike, tumori i nuk u zhbulua klinikisht. Nga pikëpamja biologjike paraqet interes forma normokalcemike, e cila e vështirëson diagnozën dhe shtron probleme fiziopatologjike ende të pagjishura (7). Rasti ynë ka pasur vlefshim hiperkalcemikë, që më vonë u normalizuan si dhe pasojat e kësaj ngarkese kalcike: nefrokalcinöz, urolitazën dhe pielonefritin. U gjenden dhe trazime digestive, por ato mund të vihen në lidhje edhe me gjendetjen azotemike, së paku në ditët e fundit. Në rastin tonë, mungon hiper-tonia arteriale, që haset në rreth gjysmën e rasteve si dhe ulcera e stomakut që takohen nga 10 në 27% (8, 9, 10).

Nga pikëpamja diagnozë është e rendësishme të dallohet klinikisht karakteri primar ose sekondar i sëmundjes. Në këtë drejtim kanë vlerë disa kriterë orientuese: së pari, rendësia dhe herëshmëria e shenjave kockore flet për hiperparatiroidizem primar (si në rastin tonë). Një anamneze e gjatë kolikash renale ose vuajtjeje renale do të anonte drejt hiperparatiroidizmit sekondar. Së dyti, kalcemia mund të jetë normale ose e rititur (si në rastin tonë). Në rastet e sëmundjeve renale kronike disi e rritur (si në rastin tonë). Në rastet e sëmundjeve renale kritike zakonisht ka hipokalcemi pranë një azotemie shumë të rritur (4, 6, 10). Hiperparatiroidizmi është sëmundja më e shpeshë e paratiroideve dhe duhet kërkuar në shumë gjendje patologjike si urolitaza, sëmundja ulceroze, hipertonia etj. Kështu kalkulozat renale hasen shpesh, në 60%

të rastevë me hiperparatiroidizëm. Në qdo litiazë renale, sidomos në rast e kërkimin e një etiologjje paratiroidiane, që ka rezultuar e tillë në 10% ndërlidhet me nefrokalcinozë në 50% të rastevë dhe me plionefrite 120%. Këto dëmtime mund të jenë të shoqëruara me njëra tjetërën (tij) (3). Dëmtimet kockore në formë të osteodistrofisë fibroze të gjeralizuar hasen në një përqindje që lëkundet nga 45% në 60% (9).

Dorëzuar në Redaksi mi 15 qershori 1978.

B I B L I O G R A F I A

- 1) Abraham E. P.: Pathological calcification. Në librin e Florey L. «General Pathology», Philadelphia and London 1970, 435.
- 2) Bitri P.: Patologjia morfollogjike. Tiranë 1966, 618.
- 3) Brunner H., Rathmund M.: Primärer hyperparathyreoidismus, Pancereatitis und Cholelithiasis. Deutsche Medizinische Wochenschrift. Stuttgart 1973, 98, 9, 46.
- 4) Chamberlain M. J.: Calcium metabolism. Në librin e Curran R.C. dhe Harndt D.G. «Pathological Basis of Medicine», London 1972, 535.
- 5) Dogi S.: Traktati i sëmundjeve të brendshme. Tiranë 1974, vol. II, 489.
- 6) Dustin P.: Troubles de métabolisme du calcium. Në librin «Legons d'Anatomie Pathologique générale». Bruxelles 1969, 307.
- 7) Hecht A. dhe Dr.: Primary hyperparathyroidism. Laboratory and clinical. Data in 73 cases. JAMA 1975, 233, 6, 519.
- 8) Linquette M. e bp.: Formes insolites de l'hyperparathyroïdisme primaire. Rev. Française Endocr. Clin. 1975, 16, 2-3, 177.
- 9) Oeriel J. E., Anderson W.A.D.: Parathyroid glands. Në librin e Anderson W.A.I. «Pathology», St. Louis 1971, 1452.
- 10) Williams R.: Textbook of Endocrinology. Philadelphia 1972, Vol. II, 934.

S u m m a r y

A CASE OF PRIMARY HYPERPARATHYROIDISM

A case is presented of primary hyperparathyroidism in a boy aged 17, which characteristically combined the bone and the kidney form with typical electrolytic changes (but with inconsistent hypercalcemia) and radiologic bone signs (osteoporosis).

The necropsy revealed an adenoma of the left lower parathyroid gland and a pronounced softening of the bones, with changes characteristic for a fibrous osteodystrophy. The microscopic examination showed nephrocalcinosis and deposits of calcium in the myocardium, endocardium and the lungs.

Résumé

UN CAS D'HYPERRATHYROÏDE PRIMAIRE

Cet article traite d'un cas d'hyperparathyroïde primaire chez un jeune homme de 17 ans, se présentant dans sa forme osseuse et avec des modifications électrolytiques (mais avec une hypercalcémie non persistante) et des signes radiologiques indiquant une ostéoporose. La nécropsie a montré un adénome de la glande parathyroïdienne inférieure gauche et un amoûissement des os, le tout accompagné par des modifications caractéristiques de l'ostéodystrophie fibreuse. L'examen microscopique a indiqué une néphro-calcinose et des dépôts de calcium dans le myocarde, l'endocardie et les poumons.

NJË RAST I IDENTIFIKIMIT TË PERSONIT ME ANËN E ESHTRAVE TË SKELETTIT

— BARDHYL ÇIPI — ESTREF MYFTARI —

(Katedra e Anatomisë Normale)

Njohja e bazave shkencore të metodave të identifikimit kriminalistikë rëndësi praktike për organet e hetuesisë dhe të gjykatës në luftënkundër kriminalitetit. Ndërmjet këtyre metodave bën pjesë edhe identifikimi i personave më anën e eshtrave të gjetura si prova materiale përvlerasuar sa më drejt rezultatet e ekzaminimit të tyre në lidhje me përcaktimin e identitetit të një personi të dhënë.

Rasti oë po baraqsim tregon përdorimin e metodave të identifikimit me anën e eshtrave të gjetura të skeletit të një personi të zhdukur disa vjet më parë.

Më 4.IX.197.. në B. të M. në një përrua të ndodhur në vendin e qajtur M. u gjetën të mbiliara në tokë shumica e eshtrave të një skeleti rrei njeriu të rritur, të cilat, sipas joqimit të të pandehurit A.B. nga fshati R. i rrëthit të D., dyshohet se i përkisnin qytetarit R. SH. i datë-jindies 1933. edhe ky nga fshati R. i rrëthit D. Nga të dhënat varaprake ditte se viktima në fjalë ishte parë për herë të fundit në gusht të vitit 197.. në B. të rrëthit M. ku kish shkuar për të punuar dhe ovsh atëherë ishte zhdukur pa lënë gjurmë. Plikërisht në atë kohë, ky duhej të ishte vrare për motive të docta nga i pandehuri A.B., i cili, sic e pranoi dhe vete më pas, pasi e kishte vrarë, kuqomën e tij e kishte shpënë në përruin atje atë, duke e mbuluar me qurë dhe trungje drurësh.

Në vendin e gjetjes, në shumicën e tyre, eshtrat ishin pa inde të buta dhe të ndara niëra nga tifra, kurse disa ishin të bashkuara midis tyre dhe ruanin pjesërisht inde të buta shumë të quillëta, që hiqeshin me lehti si nga vendet e tyre.

Eshtrat u kontrolluan me kuides që të sigurohej marria e tyre sa më e plotë. Për më tepër u bënë kërkime edhe në zonën përqark vendit ku u gjetën eshtrat, sidomos në të dy kahet e rrjedhjes së përroit.

Pas gjithë këtvje veprimeve u grumbulluan eshtrat e rrije skeleti të një personi të rritur (të kafkës, të trungut, të gjymtyrëve të sipërmë dhetë gjymtyrës së poshtme të diatitë), por nuk u gjetën ato të koishës dhetë kërcirët të martë si dha disa të tjera nga ato të voglat, kryesisht të duarve dhe të këmbëve (fig. 1 — Eshtrat e gjetura në vendin e ngjarjes).

Që në shikim të parë të binte në sy se kafka kishte dëmtimë të mëdha kryesisht në gjysmën e sai të majtë në trajtë thyerjesh, plasjesh dhe optimisht kockore të çrrëgullta, kurse gjithë eshtrat e tjera ishin krejt të paprekura.




Fig. 1 Eshtrat e gjetura në vendin e ngjarjes

Gjithë eshtrat u transportuan në laboratorin qëndor të kriminallistikës për ekzaminimet mjekoligjore e kriminalistike të rastit.

Në lidhje me këtë ngjarje, prokuroria e rrëthit D. kërkoi kryerjen e eksperimentit kompleks mjecko-ligjor e kriminalistik të eshtreve me qëllim që të përcaktoheshin raca, seksi, mosha dhe shtati i personit që i takonin këto eshtra; të përcaktohej në se mund të vëreheshin dëmtime në këto eshtra dhe në rast se po, lloji i njëjtë me të cilin ishin shkakuar dhe karakteri i tyre vdekje-prurës ose jo; të përcaktohej koha e vdekjes së personit që i përkisnin këto eshtra dhe, më në fund, në se kafika e skeletit të gjetur i takonte personit të zhdukur R. Sh.

Nga prokuroria e rrëthit D u dërgua një relacion mbi ngjarjen bashkë me gjeneralitetet dhe fotografinë e viktimës për të pasur mundësi përcaktimi të identitetit në mënyrë sa më të plotë të personit të zhdukur.

I. – PËRSHKIMI I ESHTRAVE DHE MATJET E TYRE

Së bashku me nofullën e poshtme, kafka ishte e thyer, e plasur dhe e cotouar, kryesisht në pjesën anësore të majtë (në vendin e eshtreve maksilare, zigmatikë, temporale, sfenoidale dhe parietale të kësaj ane) dhe pak në pjesën anësore të djathë (në eshtren parietale ku vazhdon të një plasje që vjen nga parietalja e majtë). Në qendër të këtyre dëmtimeve, në përshtatje me skumërtemporale dhe pjesërisht parietale të majtë ndodhjej një mungesë indi kockor me formë shumë shumë shumë këndshësi të rrëgulltë, me buzë të dhëmbezuara dhe me përmasa $6 \times 5,5$ cm. Për shkak të këtij deformimi, matja e diametrave ka qenë pak e vështire. Në të dy nofullat ndodheshin në vendet e tyre 27 dhëmbë dhe dhëmballë (pas vdekjes kanë rënë; prerasi anësor i majtë i nofullës së sipërme dhe të dy premolarët e majjë të nofullës së poshtme; prej së gjalli mungonte premolari i dyte i majjtë i nofullës së sipërme). Në dhëmbët e dhëmballët ekzistuese, si përfqatjet përtypëse ishin pak të ngrëna dhe, afér rrënjeve, sidomos nga anjet e brendshme kish njët depozitime gurë dhëmbash.

Nga eshtrat e gjymtyrëve të sipërme ishin të plota: të dy klavikulat, të dy shpatulat, të dy humeruset, të dy radiuset, të dy ulnat dhe disa metakarpe dhe falangje.

Nga eshtrat e gjymtyrëve të poshtme ishin të plota: femuri tibia dhe fibula të anës së djathtë, si dhe disa metatarsë, ndërsa eshtrat e kofshës dhe të kërcirrit të majjtë mungonin.

Shylla kurriore përbante: nga pjesa cervikale vertebrën e parë, të dytë dhe katër të tjera (një vertebër cervikalë mungonte); nga pjesa torakale të 12 vertebrat, nga pjesa lumbare katër vertebra (mungonte njëra).

Brinjët ishin 11 çifte të plota dhe një tekë (mungonte një brinjë), ndodhej pjesa e sipërme e sternumit dhe eshtrat hioide.

Eshtrat e legnit (pelvis) ishin të plota së bashku me sakrumin. Me përijashtim të kafkës, në eshtrat e tjera nuk vihen re dëmtime. Për kryerjen e identifikimit grupor në fillim u bënnë matjet antropometrike të eshtreve të skeletit.

Pasqyra nr. 1

MATJET E ESHTRAVE TË GJATA

E s h t r a t	E djathë	E majtë
Humerusi	310 mm.	309 mm.
Radiusi	231 mm.	230 mm.
Uina	254 mm.	250 mm.
Femuri	456 mm.	mungon
Tibia	368 mm.	mungon
Fibula	361 mm.	mungon

K R A N I O M E T R I A

Diametri transvers maksimal	147 mm.
Diametri antero-posterior maksimal	175 mm.
Lartësia e kafkës	137 mm.
Lartësia e hundës	56 mm.
Gjëresia nazo—alveolare	25 mm.
Lartësia nazo—alveolare	70 mm.
Diametri bizigomatik	128 mm.
Gjëresia e orbitës	35 mm.
Lartësia e orbitës	36 mm.

Indekset kranialë dhe facialë

Indeksi kranial horizontal

$$\text{Diametri transvers maksimal} \quad x 100 = \frac{147 \times 100}{175} = 84$$

Kafka ishte brakikrane

Indeksi kranial vertikal

$$\text{Lartësia e kafkës} \quad x 100 = \frac{137 \times 100}{175} = 78,28$$

Diametri antero-posterior maksimal

$$\text{Kafka ishte hipsikrane}$$

Indeksi kranial transversal

$$\text{Lartësia e kafkës} \quad x 100 = \frac{137 \times 100}{147} = 93,2$$

Kafka ishte metriokrane

Indeksi facial superior:

$$\text{Lartësia nazo — alveolare} \quad x 100 = \frac{70 \times 100}{122} = 57,45$$

Ftyra ishte e ngushtë, leptene

Indeksi nazal:

$$\frac{\text{Gjëresia e hundës}}{\text{Lartësia e hundës}} \times 100 = \frac{25 \times 100}{56} = 44,64$$

Hunda ishte e ngushtë leptonine.

Indeksi orbital:

$$\frac{\text{Lartësia e orbitës}}{\text{Gjëresia e orbitës}} \times 100 = \frac{36 \times 100}{35} = 102,8$$

Orbitat ishin të larta ose megazeme.

II. – IDENTIFIKIMI GRUPOR

a) Përcaktimi i racor

Në bazë të rezultateve të llogaritjeve të indekseve, kafka e ekzamjnuar ishte: brakikrane, hipskrane, metriokrane, leptene, leptonine dhe megazeme, karakteristika këto që takohen në racat e bardha evropiane, ku bën pjesë dhe populli ynë. Këtë gjë e vërteton edhe fakti se këto të dhëna përkonjnë me ato të punimit të kryera në kafka shqiptare (9, 10).

b) Përcaktimi i sekst

Në bazë të studimit të eshtave të legenit, personi të cilil i takojnë eshtrat e gjetura ka qënë i sekxit mashkull sepse (6).

Indeksi i hapjes së *incisura ischiatica major* ishte 25

$$\frac{\text{CP}}{\text{CO}} \times 100 = \frac{10}{40} \times 100 = 25$$

(mesatarja për meshkuj është 20,8, kurse për femra është 35,4).

– Këndi subpublik është i ngushtë 67° ($65^\circ - 70^\circ$ tek meshkujt, 110° tek femrat).

– Vrima abdutore është vezake (tek gratë është më e gjërë dhe trekëndshe).

– Diametri e acetabulit është 55 mm (tek femrat është më i ngushtë – 46 mm).

– Brazda preaurikulare është pak e shprehur (tek femrat e gjërë dhe e thellë).

Ejhe kafka zoteron gjithashu karakteristika mashkullore: balli i pjerët, këndi frontonal i shprehur, buzet orbitale të trasha, proceset mastoidë të zhvilluara, nufulla e poshtme e trashë me ashpërsitë e kafjes së muskujve të supradentaria (9).

c) Përcaktimi i shtatit

Bazohet në ekzistencën e një raporti konstant ndërmjet gjatësisë së ashtave të gjata dhe shtatit. Kështu nga pasqyrat e ndryshme antropo-

metrike, në këtë rast, u përdorën dy nga më të njohurat të Rollet dhe Manouvrer, në bazë të të cilave u arriën këto rezultate:

Pasqyra nr. 2

Përcaktimi i shtatit

Eshtrat e gjata	Gjatësia	Shtati sipas	
		Rollet	Manouvrer
Femuri i dhatitë	456 mm.	1.66 m.	1.68 m.
Fibula e dhatitë	361 mm.	1.64 m.	1.66 m.
Tibia e dhatitë	354 mm.	1.61 m.	1.64 m.
Humerusi i dhatitë	310 mm.	1.58 m.	1.62 m.
Humerusi i majtë	309 mm.	1.58 m.	1.62 m.
Radiusi i dhatitë	231 mm.	1.60 m.	1.63 m.

Radiusi i majtë	230 mm.	1.60 m	1.63 m.
Ulna e dhatitë	254 mm.	1.62 m	1.65 m.
Ulna e majtë	250 mm.	1.60 m	1.64 m.
Gjatë sia mesatare	1.61 m.	1.64 m.	
	1.625 m.		

Rrijedhimisht, gjatësia e shtatit të personit, të cilit i takojnë eshtrat e gjetura ka qenë afersisht 1,625 m. (4).

d) Përcaktimi i moshës

Kockëzimi i plotë i eshtrave dhe gjatësia e shtatit të subjektit flasin për moshë të rritur. Për një moshë të tillë dëshmojnë edhe këndi i nosullës së poshtme prej 110°, vendosja e foramen mentale në pozicion mesatar, dalja e të gjithë dhëmbëve dhe dhëmballave (duke përfshirë qfhe ato të pjequrise) me sipërfaqjet përtypëse pak të ngjëra dhe me njëtë depozitime gurdhëmbësh.

Studimi i shkallës së sinostozës (ngjitet) të suturave ekzokranike të kapakut dha këto rezultate:

<i>Sutura coronare</i>	<i>Sutura sagittale</i>	<i>Sutura lambdoïdale</i>
Segmenti $C_1 = 0$	Segmenti $S_1 = 0$	Segmenti $L_4 = 1$
» $C_2 = 0$	» $S_2 = 3$	Segmenti $L_2 = 2$
» $C_3 = 0$	» $S_3 = 3$	» $L_3 = 0$
»	$S_4 = 2$	

Shifrat shprehin shkallën e sinostozës për çdo segment të suturave

0 – Sutura e hapur

1 – sinostozë fillestare

2 – sinostozë e më pak se gjysmës së suturës

3 – sinostozë e më shumë se gjysmës së suturës

4 – sinostozë pothuajse e plotë

Në bazë të pasqyrës këtyre të dhënave u përkon mosha rreth 35 vjeç

(3, 8).

III. – IDENTIFIKIMI INDIVIDUAL ME ANËN E SUPERPOZIMIT FOTOGRAFIK

Rrethanat e gështjes në shqyrtim e bëjnë të nevojshnë identifikimin e plotë të personit të zhdukur me anën e eshtave të gjetura.

Për këtë qëllim u përdor metoda e njohur e superpozimit fotografik, që, siç dihet, bazohet në krasasinë e një kafkë të dhënë me fotografinë e personit që dyshohet, duke shfrytëzuar ato shenja të vega të jashtëm të individualizojne kafkën dhe që shprehin konfiguracionin e jashtëm të kafkës (1, 2, 7).

Për aplikimin e kësaj metode, në rastin tonë, nga të dy fotografitë e të zhdukurt R. Sh. që na u dërguan për krasasin, u zgjodh ajo më e përshtatshmja, ku viktima e prezumuar paraqitet në mes të një grupi personash të fotografuar në natyrë.

Kjo fotografi është realizuar në distancë mbi 5 m. dhe në përgjithësi paraqitet e qartë. Personat në të janë të fokusuar mirë.

Teknikist i veprua si, vijon:

Nga fotografa që disponohenj në filim u nxuarr një negativ me format 9×12 cm., ku pasqyrohej vetëm ftyra e R.Sh. Me kontakt direkt nga ky negativ u bënë disa pozitiva po të formatit 9×12 cm. dhe nga njëri prej tyre në një copë celuloidi transparent u shënuan pikat dhe vijat kryesore anatomo-topografike orientuese.

Në fazën e dytë, kafka u vendos mbi mbajtësen e lëvzishme të një stativi me një bosht që hyn në ményrë të putnitur në vrimën e madhe okspipiale që lejon për t'i dhënë kafkës pozicionin e duhur përfotografim. Pas kësaj, kafka u ndriçua me anën e tri llampave, dy anash dhe një sipër për të qartësuar konturet e saj dne për t'i bërë të errëta, gropat e syve.

Në një stativ të dytë përparrë, majtas kafkës u vendos aparati fotografik, në xhamin mat të të cilët ish vënë copa e celuloidit me shenjat e bëra më pare të indeksave anatomo-topografike. Aparati fotografik u vu në ményrë të tillë që nga largësia dhe pozicioni i tij, kafka të fotografohej po në atë rakurs që ka qënë fotografuar ftyra e personit që identifikohet.

Pasi u korigjuat pozicioni i kafkës në hapësirë, derisa pikat dne vi-jat orientuese të saj u përpunohen në përgjithësi me ato të ftyrës të fiksuar në copën e celuloqidit, u kalua në ekzaminimin krasues.

Fig. 2 Fotografia e qytetarit R. Sh.

Fig. 3 Fotografia e kafkës e gjendetur në vendin e ngjarjes

Fig. 4 Superpozimi fotografik: kafka e gjetur në vendin e ngjarjes përpunhet me fotografinë e R. Sh. Pra kjo kafkë i takon qytetarit R. Sh.

Në këtë fazë të fundit, u krasuan pikat dne vijat anatomo-topografike të shënuara në copën e celuloqidit me ato të kafkës të pasqyrurara





Fig. 2
Fotografia e qytetarit R. Sh.

Fotografia e kafkës e gjendur në vendin e ngjaries.

Fig. 3
Superpozimi fotografik (kafka e gjetur në vendin e ngjaries përpunhet me fotografie e R. Sh.



në xhamin mat të aparatit fotografik dhe vumë re kështu një sërë përputhjesh. Për fiksimin e rezultateve, kafika u fotografua në pozicionin e arritur në pilakë me format 9×12 cm, si të fotografisë së veçantë të R. Sh. Negativi i kafkës i bëre në këtë ményrë dhe ai i fotografisë së zmadhuar të këtij të fundit u bashkuan jhe u ekspozuan njekohësht, duke nxjerrë kështu një pozitiv të përbashkët të kafkës dhe të fytyrës. Duke ekzaminuar këtë pozitiv u vu re se pertytyrimi fotografik i fytyrës së R. Sh. përputhej me pjesën më të madhe me pikat dhe vijat orientuese të kafkës objekt eksperimenti, gjë që trigon se kjo kafkë duhet t'i ta-

sej personit në fjale (5).

K O N K L U Z I O N E

— Identifikimi i personit me anën e eshtave të skeletit jep rezultate të përpikta. Ky lloj identifikimi është një eksperiment kompleks mje-kolgjor dhe kriminalistik, që kërkon një kujdes të veçantë, sepse kemi të bejmë me metodat e kuzminimit të vështira dhe delikate.

— Nga paraqitja e rastit del se për kryerjen e kësaj eksperimenteve në fillim bëhet përcaktimi i shenjave grupore të racës, sekst, moshës, shtatit dhe më pas arritet në identifikimin individual me anën e mes-todës së superpozimit fotografik.

Dorëzuar në redaksi më 20 maj 1978

B I B L I O G R A F I A

- 1) Çipi S., Toraç N.: Përcaktimi i identitetit të personit. Në Shërbim të Popullit 1972, 5, 30.
- 2) Cuberi B.: Mjekësia ligjore. Tiranë 1975, 252.
- 3) Eliakis C., Ennun, Jordandis P.: Détermination de l'âge par l'étude du degré de l'oblitération des sutures crâniennes. Revue Internationale de police criminelle, 1968, 238.
- 4) Pashkova V. I.: Ogarki sudebno-medicinskoy osteologii. Medgiz 1963, 18, 51, 118.
- 5) Poçari F.: Identifikimi i personave (kutonave) në bazë të kafkës. Policia popolare 1962, 26, 25.
- 6) Simonin C.: Médecine légale judiciaire. Paris 1962, 79.
- 7) Sivarap S.: Identification d'un squelette. Revue internationale de police criminelle. Mai 1977, 158.
- 8) Ylli, A., Çipi B.: Percaktimi i moshës në bazë të studimit të suturave ekzokraniale. Buletini i UT-seria shkencat mjekësore 1973, 2, 21.
- 9) Ylli A., Çipi B.: Percaktimi i sekstit me anë të kafkës. Buletini i UT – Seria shkencat mjekësore 1975, 1, 45.
- 10) Ylli A.: Disa të dhëna kraniometrike. Tiranë, 1975, 141.

S u m m a r y

IDENTIFICATION OF THE PERSON BY THE BONES OF THE SKELETON,

A case of identification of the person by the bones is discussed as an example of medico-legal and criminalistic expertise. In this case the signs related to the race, sex, height and age were first taken into account, then the photographs of the skull of the dead person were confronted with photographs of the presumed dead person.

All these data gave positive results.

Résumé**UN CAS D'IDENTIFICATION DE LA PERSONNE PAR LES OS
DU SQUELETTE**

Dans cette étude les auteurs décrivent le cas d'identification d'un homme à par l'examen des os du squelette. Il s'agit d'une expertise complexe médico-légale et criminalistique. En l'occurrence, sur la base des os trouvés et des mensurations anthropométriques effectuées il a été possible au commencement de déterminer les signes relatifs à la race, le sexe, la taille et l'âge, qui correspondaient à eux de la personne disparue. Puis la méthode de superposition photographique, qui consiste dans la confrontation de la photographie du crâne de la personne disparue avec celle de son visage, a donné des résultats positifs.

NJË RAST I RRALLE NË MËNYRËN E DALJES SË TRUNCUS COELIACUS

— KLEMENTINA LLANGA — DRITA OSMANLLI —

(Katedra e Anatomisë)

Në normë, *Truncus coeliacus* është një trung i trashë dhe i shkurtër, të lind nga aorta e barkut në murin e përparshëm të saj në nivelin e vertebrës XII torakale ose të I lumbale, prej të cilit është *a. gastrica sinistra*, a. *hepatica communis* dhe a. *lienalis*.

Variacionet e këtij trungu janë të shumta. Trungu mund të mungojë dhe të tri degët të dalm drejtëpërdrejt nga aorta ose trungu të ndahet vetëm në dy degë: në a. *gastrica sinistra* dhe a. *lienalis* (1).

Në 30 kufoma të ekzaminuar kemi hasur vetëm një rast të rrallë në mënyrën e ndarjes së truncus coeliacus. Në kufonën e sekshit mashkull, aortës së barkut del vetëm një degë, që është a. *lienalis*. Arteria drejtuhet majas sipër trupit të pankreasit. Në një distancë prej 3 mm prej saj dalin dy degë të holla që drejtohen njëra sipër dhe majtas per në *curvatura minor ventriculi* pështë a. *gastrica sinistra* dhe tjetra që drejtohet djathtas nëpër buzën e sipërme të pankreasit dhe që është a. *hepatica communis*.

A. *lienalis* me lumen 1.6 cm, kalon nëpër buzën e sipërme të trupit të pankreasit, duke formuar 5 përdredhje të mëdha dhe 5 cm para se të arrije në *hilus* *lienüs* jep një degë me lumen 5 mm, që drejtohet në *mesocolon transversum* që nga *flexura coli sinistra* deri në mesin e *colon transversum*, të cilën e vaskularizon dhe që është a. *colica media*.


Një variant të tillë kanë përshtkuar dhe autorë të tjera (1), por në këto raste mungon a. *colica media* si degë e a. *mesenterica superior*, kurse në rastin tonë, a. *colica media* del dhe nga a. *mesenterica superior*, por si një degë shumë e hollë.

Mendojmë se përshtkimi i një varianti të tillë është shumë i nevojshtëm kryesishët për kirurgët gjatë ndërhyrjeve në zonën transversale.

Dorëzuar në redaksi më 2.IV.1978

BIBLIOGRAFIA

1) Chiarugi G. : *Institutioni di anatomia dell'uomo A. Axillaris.* Milano 1965. 451.



Summary

A RARE SITE OF EMERGENCE OF TRUNCUS COELIACUS

A case is described in which truncus coeliacus emerged from the abdominal aorta at the level of the 12th thoracic vertebra with only one of its branches (instead of the usual three), the splenic artery, which was directed to the hilus of the spleen. Along its way it gave out two thin branches of which the one goes to curvatura minor ventriculi and is the left gastric artery, and the other goes to the liver and is arteria hepatis communis. In its length the main branch describes a number of sinuosities, and 5 cm before entering the spleen gives out another thin branch with internal diameter 5 mm, which goes to mesocolon transversum and vascularizes it. This branch is the equivalent of a colica media.

Résumé

UN CAS RARE D'ÉMERGENCE DU TRUNCUS COELIACUS

Les auteurs du présent article exposent un cas rare d'émergence du truncus coeliacus. De l'aorte abdominale, au niveau de la XII vertèbre thoracique du davre, sort une seule branche (au lieu des trois habituelles) de l'artère splénique, qui se dirige vers le hile de la rate. Chemin faisant sortent deux branches fines, dont l'une se dirige vers la curvature minor ventriculi et constitue l'artère gastrique gauche, tandis que l'autre se dirige vers la foie et constitue l'artéria hepatica communis. Le long de son parcours, la branche principale décrit des sinuosités et à 5 cm. de la rate, avant d'y pénétrer, elle forme une autre branche d'un diamètre intérieur de 5 mm. qui se dirige vers le mesocolon transversum et procède à sa vascularisation. Cette branche est un équivalent de l'arteria colica media.

APLIKIMI I INTESTINOPALOSJES SIPAS CHILDS-PHILIPS NË NJË RAST ME ILEUS ADERENCIAL TË PËRSËRITUR

— BASHKIM HABIBI —

(Spitali i rrethit të Durrësit)

Ileusi aderencial është sot një nga format më të shpeshta të ileusit akut. Kryesisht ndodh pas operacioneve të përsëritura të barkut. Rrallë zhvillohet pas traumave të rëndë të mbyllura të barkut. Më rrallë akoma vërehen pas infeksioneve specifike, si TBC që tashmë është pakësuar shumë në vendin tonë, si pasojë e masave të marrura nga Partia dhe Qeveria kundër kësaj sëmundjeje.

Duke qënë para një sëmundje të tillë të rëndë, që përsëritet, është menduar vazhdiministh edhe për kurimin e saj, kryesisht për intestino-palosien.

Mëndimi i parë për fiksimin e ansave (laqeve) të zorrëve është dhënë në vitin 1937, ku u përdor qepja e laqeve të zorrëve në shfresën seto-sero-roze me gjatësi të tyre 30-40 cm. Por ky mëndim nuk u përkrah shumë më vonë, sepse jepet mjaft mjerëlikime. Ü deshën disa vjet që të përmirësohej kjo metodë dhe më 1960, Childs e Phillips komunikuan intestino-palosjen mezentriale në zonat pa enë gjaku, me qepje në formë «U». Laqet e zorrëve ndahen në 2 ose 3 paketa, duke lënë të lire 30-40 cm. nga plika e Trajcit dhe po kaq nga këndi ileocekal. Kjo metodë u përkrah dhe u përdor nga shumë autorë. Edhe në vendin tonë janë botuar raste me këtë illoj ndërrhyrje (1).

Më poshtë po paraqesim rastin:

I sëmuri B. M., 40 vjeç, nga Ishati Pat-Milot, rrethi i Durrësit, u shtrua në spital më 21.V.1971, me numër kartelle 7009, me diagnostë *Ileus aderencial*. Në shtrim kishte këto ankesa: dhembje të fortë barku me intervalle qëtësie të shkurtta, të viella, nuk kishte defekuar prej dy ditësh, kish fryrje barku. Sipas të dhënave të anamnezës, i sëmuri është operuar për herë të parë më 1965 për apendicit akut. Më 1967 është operuar për ileus aderencial, i është bërë vetëm lirimi i aderencave.

Obektivisht paraqiste: gjendja e përgjithshme e të sëmurit e rëndë, tip astenik, i zbehtë, me tipare të mprehta (nga humbja e lëngjeve), gjuhja e thatë e veshur. Tonet e zemrës të qarta ritmike, pulsi me rmbushje të vogël i shpeshtë rrëth 120 në minutë, TA maksimali 90-100 mmHg. Në mushkëri asnjë me rëndësi. Gjatë vizitës, i sëmuri vilje vazhdiministh, në fillim përbajtje të stomakut, pastaj me erë të rëndë fekaloidë. Baruku mbi nivelin e kraharorit, mjaft i fyrrë, me tingull timpanik. Kish llokoçitje, pa fenomene peritoneale. Ampula rektale e zbrazur. Në skopinë e barkut vëreheshin nivele hidroairike të shumta. Diagnosa: *Ileus aderencial*.

Operacioni u krye nën anestezinë e përgjithshme. Nga zgava e njëra me tjetri në mënyrë të crregulltë dhe pjesërisht e ngjitur me murin e përparshmëm të barkut, duke penguar kalueshmërinë në zorrë. Zorrët shumë të mbushura, me mure të trashura dhe të plagosëshme lehtë. Bëhet lirimi i aderencave. Për lehtësi veprimi u bë enterostemia e përkohshme zbrazëse.

Për të mënjanuar një ileus aderencial të ardhshëm u vendos të bëhet intestinoplosja sipas Childs – Phillips në tne paketa (sah figura 1). Për shikat të gjendjes së rëndë filastare të të sémurit, periudha pas operacionit nuk që e lehtë, megjithatë në sajë të masave reanimuese gjendja u zotërua. Plaga u mbyll *per primam*. Doli nga spitali në gjendje të mirë.

Në rastin e dhënë u vendos të bëhet intestinoplosja për të parandaluar një përsëritje të sémundjes. Preferohet modifikimi i Childs-Philips për arsy se:

1) Teknikisht paracitet më i lehtë dhe ka më pak ndërlidhje sesa operacioni Nobel (për të mënjanuar muplësinë e mikroperforacioneve immediate në vendin e qepieve sero-seroze).

2) Duke bërë paketa njëra pas tjetrës nuk është nevoja për nxjerrjen e gjithë zorrëve përiashtha.

3) Rivendosja e laqeve në zgavrën e barkut është e lehtë. Në këtë lloj operacioni rikonandohet që të mos bëhet enterostomi zbrazëse.


Deri në ditën e punimit të këtij materiali, i sënuri ka gjëzuar shëndet të plotë dhe nuk ka pasur asnjë lloj ankesë.

U dorëzua në redaksi më 15 maj 1978

B I B L I O G R A F I A

- 1) Hafizi R. : Intestinoplosja sipas Noble dhe Childs – Phillips në ileusin aderzial. Buletini i UT Seria shkencat mjekësore, 1969, 2, 41.

FIG. 1



S u m m a r y

THE CHILDS-PHILLIPS METHOD OF INTESTINOPPLICATION IN A CASE OF RECURRENT ADHERENTIAL ILEUS

A case is described of recurrent adherential ileus on which the operation of intesstinoplication was performed in its Childs-Philip's modification.

The author recommends that this kind of operation should not be accompanied by evacuating enterostomy. The results of the operation was satisfactory.

Résumé

**LA MÉTHODE DE L'APPLICATION D'INTESTINS DE
CHILD'S-PHILLIPS DANS UN CAS D'ILEUS ADHÉRENT RÉCURRENT**

L'auteur du présent article décrit un cas d'ileus adhérent récurrent qui a été traité par l'application d'intestins selon la modification de Childs - Phillips.

Il relève que ce genre d'intervention ne doit pas être accompagné par l'évacuation des intestins et de l'estomac. L'opération a donné des résultats satisfaisants.

NJE RAST I RRALE I ANODONTISE SE PLESSHME TEK TE DY SISTEMET I SHOQERUAR ME POLIDAKTIL

— HAKI BLLACA —

(Klinika Stomatologjike – Durres)

Anodontia bën pjesë në anomalitë e lindura të numrit të dhëmbëve. Ajo është e plotë kur mungojnë si dhëmbët e qumështit, ashtu dhe follikulat e dhëmbëve të përhershëm (7). Kjo forma e anomalisë është shumë e rrallë. Më e përhapur është anodontia e plesshme, kur dhëmbët që mungojnë janë vetëm dhëmbë qumështi (forma e parë), mungojnë dhëmbët permanentë (forma e dytë) dhe forma e tretë, kur mungojnë si dhëmbët e qumështit, ashtu dhe follikulat përkate të dhëmbëve permanentë, ose follikulat e dhëmbëve të tjere jo përkatës.

Anodontia duhet dalluar nga retensioni, me të cilin kuptojmë mungesën e dhëmbëve në gojë, por këta ekzistojnë mbyllur diiku në nofull. Diagnosa diferencale ndërmjet anodontise dhe retensionit zgjidhet përfundimisht pas interpretimit radiologjik të regionit ku dyshohet në ekziston ose jo embrioni i dhëmbit.

Disa autorë (3, 5, 6) nuk e quajnë aspak patologjike mungesën e lateraleve siper, tetave ose premolareve të njytre të nofullës së poshtme, përkundrazi e trajtonjë si fenomen normal të reduktimit filogenetik të numrit të dhëmbëve për tu përgjigjur reduktimit funksional që ato kryejnë në mënyrën e të ushqyerit sot. Kjo shpjegon edhe perspektivën e dhëmbëve në gojë nga 32 dhëmbët:

3	2	1	2		2	1	2	3	—
3	2	1	2		2	1	2	3	—

në 26 dhëmbë 2 2 1 1 | 1 1 2 2 (8)

Mungesa e dhëmbëve të tjere qon në anodontinë e vërtetë (2), e cila trajtohet si patologji e imbarë organizmit, sepse ulja e numrit të dhëmbëve shoqëron ndonjë sëmundje ose sindromë të organeve ose organoideve, që marrin fillim nga shtresa primare ektodermale në zhvillimin filogenetik të embrioneve.

Rasti që po përskrurajmë është ndjekur prej nesh qysh nga viti 1973 gjatë vizitës në shkollë Pacientja A. E. N., lindur më 1965, vazhdon shkollën fillore Durres, me nr. kartele 1/1977. Fëmija është lindur me pesha 2.800 gr. Në muajin e katërtë të barrës, gjatë një udhëtimi, nëna e saj ka rënë nga kali. Në çast nuk pati ndonjë shqetësim, barrën e goi deri në fund duke lindur këtë fëmijë me polidaktili (gjashtë gishta në këmbë dhe gjashtë gishta në duar) (foto 1, 2), kurse në gojë dy preturancë papilare në regjionin ingzive poshtë, që ekzistojnë edhe sot.

Fëmija eshtë ushqyer në gjii deri në muajin e gjashtë, mandej ka kaluar me ushqim artificial me lugë. Në muajin e shtatë pas lindjes, në vendin e ingzimit siper del një dhemb binjak, kurse poshtë nuk del një dhemb qumështi në front. Në moshën tre vjeç, fëmija sëmurret me hepatit viral dhe po në spital kalon pertusin. Në moshën 4 vjeç operon dy gishtat e dorës, kurse në moshën 7 vjeç dy gishtat e këmbës. Vese nuk ka pasur, vetëm se edhe sot shpesh përsërit refleksin e thithjes, duke mbledhur buzët. Nga hunda merr frymë lirish. Në moshën 8 vjeç i del dhëmbi i parë i përhershëm në formën e shishes (6) (foto 5). Dhëmbë të tjera permanentë në front nuk i kanë dale edhe sot.




Foto 1

Prindrit të shëndoshë. Si fëmijë ka ardhur vazhdimisht e dobët, e imët, fytyrë e vogël, e mbuluar me pigmentacione plermodiale, vetulla të holla, floku i hollë dhe i rrallë, një ekzofthalmi e lehtë, qerpiqë të hollë dhe të rralla, lëkura e hollë dhe e thatë, gishtat e duarve dhe të këmbëve të deformuar, thonjtë të mbuluar me deskuamacione dermoidale; nga intelekti nxënëse mesatare, e vëmëndshme, orientohet mirë në hapësirë dhe ikohë, e urtë, e pastër, bën përpjekje për të ecur përrapa, qëndron disi e shmangur dhe e veguar. Sistemi kardiovaskular dhe respirator pa patologji, abdomeni normal, shpesh bën konstipacion primar. Në kontrollin e parë, në shkurt të vitit 1973, paraqet këtë formacion dentar:

V2	IV2	111	2X	1	11	111	IV2	V2
4	4	111	XX	X	X	111	IV	V



Foto 2



Foto 3

Sic shihet karioziteti mbulon molarët e qumështit. Gjashat mungojnë në gojë. Në 1974 iu bënë radiografët dhe nga interpretimi radiologjik doli se mungojnë katër prerësit e përhershëm, pra 22% e dhëmbëve, mungojnë, kurse 6 25% e tyre gjendë të refinuar (kaninat poshtë). Një dhëmb në formë dalte ose shishe në regionin e kaninit të sipërmë, pra

sig shihet një kompleks i tërë patologjik në zgavrën e gojës. Sot ajo paraqet këtë formulë dentare:

6	5	4	3	2	X	\	X	X	111	4	5	6
					X	X	X	X	111	4	5	6

Duke analizuuar rastin që paraqitim theksojmë se ka mundësi që trauma që ka pësuar fetusi në muajt e parë të shtatzënësë ka çuar në ndryshime cilësore të tillë në këtë fëmijë, duke paraqitur këshu të gjithës së impulzive të neuroreceptoreve të dhëmbëve që mungojnë të cilat lozin rol të drejtperdixjetë në formimin e proceseve alveolare (4). Këto difekte të shkaktarata nga anodontia në mastikacion zenë 6.3% të të gjitha difekteve, duke lënë para vetëm kariesin me 57.6% dhe traumat 32.6% (1). Kjo traumë që ka pësuar fetusi në muajin e këtë të shtatzënësë ka sjellur ndryshime cilësore dhe në organet dhe organoidet e tjera që e marrin zanafilën nga shtresa ekfodermale, prarjedhimisht edhe polidaktilinë. Krahas traumes, mendojme, se ka ndikuar edhe sëmundshmëria e herëpas hershme e organizmit, nga verrydhëza, varicela ilje dobësia e përgjithshme me të cilën shpjegohet edhe retensioni ekzistues i kamjnëve.

Detyra jonë kryesore ishte që fëmijës ti rikthenim gjëzimin e jetës, sepse ajo rinte vazdimisht e ndarë nga shokët dhe shqoqet për shkak të difektit. Krahas restaurimit të estetikës, ne do të stabilizonim edhe funksionin përtypës. Në këtë mënyrë do të ndërprisnim atë cikël marrëdhënieš të formulara gjatë kësaj kohë në shkollë, që vazdimisht depromonin fëmijën.

Këtë fëmijë e protezuam me dy proteza të pjesëshme (foto 4), duke pasur parasysh parimin bazë të mjekimit të anodontisë në moshën fëmijore, ndryshimin e herëpas hershëm që merr sistemi dhëmbë-norull gjatë zhvillimit të tij në rapport me zhvillimin e sistemit kokë-fytyrë në përgjithësi. Vëgoria e këtij protobëmi qëndron në faktin që proteza të mbështetet në ekuatorin e dhëmbëve, për të mos penguar këto të funktit të arrinjë rrashin horizontal drejt normo-okluzionit, sepse vetëm këshu ndihmojmë formimin normal të artikulacionit temporo-mandibular.

PERMBLEDHE

1) Anodontia paraqitet si anomali e lindur e numrit të dhëmbëve, e shoqëruar me të gjitha simptomat e patologjisë ektodermale, duke përfshirë edhe polidaktilinë, sigë është rasti yne i përshtkuar.

2) Protobëmi i pjesëshëm është mënyra më e efektshme për rindërtimin e funksionit përtypës, estetikës dhe formimin e plotë të sistemit kranio-facial.




Foto 4

B I B L I O G R A F I A

- 1) **Betelman A. J. e bp.** : Anomalijasllazubov. Ortopedigeskaja Stomatologija detkovo vozrast. 1972, 67.
- 2) **Bilaca H.** : Një rast i rrallë i anodontisë me polidakili në të dy sistemet. Referat i mbajtur në sesionin shkencor në Elbasan 1976, – dorëshkrim pranë autorit.
- 3) **Hina-Markosian** : Anodontia. Zëdno çelijstno prezirane pritecata. 1956, 37.
- 4) **Lira Dh.** : Anomali në numrin e dhëmbëve. Ortodonzia. Tiranë, 1972, 214.
- 5) **Pegechiev J.** : Edin Silqaj S. Anodontia inkompleta v mlegje i postojane sëzëbie. Stomatologja 1966, 2, 265.
- 6) **Popinistov P.** : Projavi v ustata na njakoi i nevustni bolesti. Bolesni nagaviliga-vica na ustata 1958, 267.
- 7) **Rihakov A. J.** : Anodontia – spravocnik po stomatologiji 1966, 248.
- 8) **Svrakov D.** : Anomali v broja na zebite. Terapevtiqëska. Stomatologja 1958, 66.
- 9) **Stranski D.** : Hypodontija terapeutiqëska stomatologija detskovo vëzrat 1956, 93.

S u m m a r y

A RARE CASE OF PARTIAL ANODONTIA OF THE TWO SYSTEMS ASSOCIATED WITH POLYDACTILY

